

## INTERVISTË ME TEUTA BEKTESHIN

Kumanovë | Data: 25 shkurt, 2023

Kohëzgjatja: 193 minuta

Të pranishme:

- Teuta Bekteshi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zonja Teutë, nëse mundeni me prezentu vetën, me tregu datën e lindjes, vendin, diçka për familjen, prejardhjen tuaj?

**Teuta Bekteshi:** Jam Teuta Bekteshi është mbiemri i vajzërisë, Ajeti mbiemri i burrit. Unë kam lindur më 16 nëntor të 1957-tës në ni fshat ktu afërt qytetit, nja katër kilometra në fshatin Llopat. Kam kry shkollën fillore aty, shkollën e mesme në gjimnazin, “Goce Dellçev” edhe sot quhet asisoj, të Kumanovës. Ku kanë qenë krejtësisht mësimi në gjuhën maqedone, përveç historisë edhe gjuhës shqipe. Më vonë edhe biologjia, disa landë na u bashkangjitën, ishin profesorët që i kishim shqiptarë. Domethonë, e kemi kryer kryesisht në gjuhën maqedone.

Fakultetin e kam kryer në Universitetin e Prishtinës dhe kam vazhduar... ka qenë ni kohë pak për shkak të situatës tjetër dhe lëvizjes time që më është vonuar, kam qenë absolvente po që më është vonuar diplomimi pastaj dhe në fund jam kthyer ktu. Punoj që nga ‘97-ta, udhëheq vet ordinancën time bashkë me laboratorin, “Doktor Teuta”, dhe mundësia për të punu në shëndetësinë publike ka qenë e pamundur për mu. Për arsye që unë kam patur ni histori timen që gjithmonë jam status si irredentiste, e rrezikshme për shtetin. Kështu që, asnjëherë nuk kam pasë qasje në shëndetësinë publike. Jam detyru pas ni kohe shumë të gjatë që unë të të filloj vet e pavarur.

Kur është mundësu në Maqedoni që të hapet sektori privat, domethonë ordinancat private në mjekësinë primare që do të kenë një, që kemi pasë një kontratë me Fodin Shëndetësor të Maqedonisë. Po kam pasë një problem serioz se nuk kam pasë shtetësi deri në 2001-shen. E lindur ktu, e shkolluar ktu. Familja ime ka patur, por mua më është mohuar ajo. Domethonë që nga ‘94-ta deri 2001-tën nuk kam pasur mundësi lëvizje askund. Kjo ka qenë problematike edhe për punën time. Kështu që, kjo është... pastaj kam vazhduar ndërkohë me aktivitete edhe joqeveritare edhe kështu. Por, deshta me thanë, kjo është një histori.

Rrjedh nga një familje arsimdashëse, baba im ka qenë mësues. Ne jemi të ardhun ktu nga rrethi i Bujanovcit, po të ardhun nga Shkodra, nga Malësia e Shkodrës, domethonë, nga Malësia e Madhe i bie se fisi Kastrat është edhe andej në Malësinë e Madhe. Ne jemi fis i tillë dhe kemi ardhë shumë gjenerata, domethonë muj me qenë gjenerata e njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë unë në rrethin e

Bujanovcit që janë lshu nga atje. Pastaj, që nga '52-ta, '53-ta janë vendosë, ktu janë. Po baba im ka qenë mësues dhe ka qenë ajo ma e mira e mundshme që, që mu më ka, më ka mësua shumë. Për arsye se në atë kohë vajzat nuk i kanë lanë të shkollohen, ka qenë shumë problematike shkollimi i vajzave.

**Anita Susuri:** Çfarë gjenerate ka qenë baba juj?

**Teuta Bekteshi:** Baba im ka qenë gjeneratë e '28-tës.

**Anita Susuri:** Si osht' shkollu ai në atë kohë?

**Teuta Bekteshi:** Ai ka kryer, baba im ka kryer shkollimet ka qenë ato... ka qenë ushtar dhe pastaj ka vazhduar Shkollën Normale, i kanë kryer si me provime në atë kohë për t'u aftësua mësues për të punu me nxanës shqiptarë. Baba im ashtu e ka kryer. Masnej, Normalen në Gjilan në rrethana të atëhershme i kanë kryer kësisoj. Pastaj, kur ka ardhë ktu ka punuar ni kohë, ka filluar të punoj në ato fshatra andej të Bujanovcit dhe kur ka ardhë ktu ka filluar menjëherë. 30 vjet është në shkollën, sot quhet "Faik Konica", atëherë ka qenë, "Jeta e Re". Në atë fshat kemi jetu edhe ne disa vite, për arsye të lëvizjes se ka qenë ma e vështirë lëvizja.

Baba im deri në penzion ka punuar... pasi ka punuar në fshatin Llapak nja dy vite dhe pastaj është pensionu. Po them që në familjen tonë kemi has të gjitha gati profileve të artit, të profesionalist të shkrimeve, poezisë, domethonë kemi kompozitor, kemi aktor, kemi regjisor. E kemi Kushtrim Bekteshin, e kom djalin e vëllaut që është regjisor mjaft i suksesshëm. Vajza e vëllaut është aktore. Kështu që, në familjen tonë gati është krejt kjo anë që është një e mirë që gjeneratat që janë, janë të suksesshme dhe të vyeshme. Kjo veç të suksesshmem po edhe të dobishme për, për, për vetën dhe për të tjerët.

**Anita Susuri:** Çfarë kujtime keni prej fëmijërisë? Qysh është organizu familja për shembull ose rrethi çfare ka qenë ku keni jetu?

**Teuta Bekteshi:** Unë kam qenë ma e vogla nga vajzat dhe kam qenë ndoshta pak ma e lidhun me babën dhe... po baba im ka qenë mësues dhe unë që pesë vjet kom shku në shkollë. Domethonë më tregojnë ata se unë nuk mbaj mend, po që unë kam fjetë në shkollë po pastaj më kanë pru, në krah më kanë pru se afër ka qenë shkolla me shtëpinë. E kom pasë ni veti që e kom mush çantën shumë me libra, e kom mush aq sa kam mujtë sa s'kam mujtë me çu po kam mendu që duhet të kem shumë libra për të shku në shkollë. Aty ka fillu fëmijëria ime.

Baba im, familja ime në Llopat kemi qenë vetëm ato vllazën, ni familje që ka ardhë prej atjeshit, domethonë në atë fshat nuk ka pasë tjetër familje. Po jam lindë me ni familje ku e kom pasë gjyshën time. Gjyshja ime edhe ajo e ardhun por një gru shumë burrneshë. E ka pasun, ka qenë shumë... ka

pasë nantë fëmi domethonë, pesë vajza e katër djem, tre të vdekun nja dymbëshjetë lindje. Ka qenë shumë, shumë atëdhetare dhe kangtë e para i kom mësu nga gjyshja ime.

Kangtë e para i kom këndu nga baba im edhe nga mixha im. Domethonë dhe ato sekuencat e para të fëmijërisë lënë përshtypje jashtëzakonisht, tek fmitë sidomos, gjatë rritjes të tij, gjatë formimit të identitetit të... thjeshtë të njeriut që ka shumë rëndësi familja e para, e pastaj shkollimi e rrugëtimi e të gjitha ato gjana. Por kjo ka qenë bazë për mua, për unë të pasë për të formu nifarë opinioni që nesër çfarëdo të jetë rrugëtimi im ndoshta, a din, që ka përcaktu thjeshtë e ka përcaktu jetën time edhe rrugëtimin tim. Sa i përket çashtjes së arsimit që ka qenë bazë te ne, po edhe çashtja e situatës vet të popullit...

Ni mixhë i im në atë kohë ka qenë në Ballin Kombëtar, po nuk flitej asnjëherë për arsye se ishte shumë e rrezikshme atëherë të flitej. Por, herë pas here dëgjoja unë që ka qenë në Shqipëri mixha im dhe tregonte ngjarje të ndryshme, por nuk flitej asnjëherë për ata. Pastaj babi im ka qenë edhe në këtë organizatën NDSH-në me Gjon Sereqin, po gjithmonë shumë pak [flitej]. Po kupton si, si të them, e di kur vet ceket diçka por jo që është veprim por që interesin e shtojke tek ne se nuk guxonin se ishim atëherë ne fëmi.

E dëgjojshin Radio Tiranën në atë kohë, nifarë radio të vogël. Unë ma e vogla, babi im më mbate mas vete dhe unë gjithë përbihesha në tërë kto. Më bënte përshtypje çfarë po dëgjojnë, s'e disha ç'po dëgjojnë po kisha përshtypjen që diçka do të jetë e msheftë derisa nuk i lanë fmitë të jenë aty prezentë. Të gjitha janë këto sende që kam plot gjana që kanë formu. Në '68-ën kur është ngritë, kur ishin demonstratat dhe '68-ën dhe ni djalë i mixhës tim ishte, ai lëvizte më shumë në vende të ndryshme dhe ishte në Kosovë. Kur u kthye në Kosovë tregoi për demonstratat që kish qenë edhe ai.

Na tregoi demonstratat edhe kangën e demonstratës '68-ës dhe ishte kjo ni informacion shtesë tek ne. Ne në atë rast ngritëm, që ka qenë shumë problematike, ngritëm flamurin, një flamur ka qenë jo shumë i madh. Unë kom qenë fmi dhjetë vjeç. E ngritëm flamurin tek ne, domethonë shpitë e tona kanë qenë dy shtëpi. Po kjo shtëpia përskej rrugës ka qenë një ahur, si të them, po jo ahur, po një që ka pasë edhe ushqim aty domethonë. E vunë nga rruga e vunë flamurin. Po ishte shumë rrezik i madh për shkak se ishte situatë shumë e rëndume, sidomos në Maqedoni.

Ne fmitë dolëm me rujtë edhe me kqyrë flamurin mos po vijnë policia që t'i lajmërojmë me kohë për ta tërheqë, se e kishim për ni kohë të shkurtë, se ti s'mujshme me majtë se ishte shumë e rrezikshme në atë kohë. Baba im ishte mësus, mixha im ishte ma i ri, mixha tjetër. Kështu që, ajo ka qenë, ajo që sot e kujtoj. Më duket sikur jam aty edhe dal nga dyrtë edhe dal aty në rrugën kryesore edhe e shikoj atë flamurin. Ka qenë, domethonë në rrugtimin tim kam pasë shumë situata që kanë ndiku, kanë ndiku. Kangën për Oso Kukën, për shembull në atë kohë e këndonte mixha im dhe baba im kur mblidheshim.

Unë s'kisha dëgju për Oso Kukën, nuk disha kush është, por kënga si e këndonin këta ishte e jashtëzakonshme. Edhe sot mbaj mend sendet të asaj që janë këndue, e di nga pjesët e asaj kange. Pastaj, zë Halil Garisë, gjyshja ime na pat' mësue. Pastaj këngen e Sali Sylës, "Po thotë mori nanë, ni kangë tjetër". Domethonë krejt kto i këndojnë në familjen tonë, gjithmonë është këndu. Domethonë, gjithmonë është këndu edhe gjithmonë është vallëzu. Ndoshta ajo në familje ka qenë ajo ndjenja e artit dhe kulturës edhe ne edhe sot e bëjmë të njëjtën, të njëjten gja.

Pastaj vinin nipat, nipat, njëri i binte violinës, tjetri... të hallave të mija edhe ne dilshim te oborri edhe këndojsim në atë kohë. Na fmitë si ishim, ishim kureshtar se ata të mdhej krejt. E di, sikur kur dojsh të bojsh si i madhi, ke modele. Në fakt për formimin e personalitetit të njeriut janë shumë të rëndësishme modelet. Jo ajo çfarë thuhet por ajo çka shihet dhe që e merr ti si, një, si nesër formësohesh si personalitet. Mendoj që është shumë e rëndësishme familja.

**Anita Susuri:** Po, deshta me ju pytë gjithashtu për nanën e juj, çfarë familjes i ka taku? Si ka qenë ajo?

**Teuta Bekteshi:** Nana ime ka qenë ni gru shumë e urtë edhe shumë e dashur dhe shumë pozitive. Nëna ime ka kryer vetëm një katër vite shkollë. Baba im... po ka ditë të shkrujë edhe emrin e vet sa për të ditë... ajo ka qenë ni fshat mbi fshatin e prindërve të mi ku kanë ardhën. Por kanë ni familje jashtëzakonisht edhe ata atdhetare. Domethonë, ka qenë një, një, si të them, një njëzim edhe të familjeve në atë kohë, se edhe në atë kohë janë shiku njerëzit që janë marë që... po është martu shumë e re. Nëna ime 14 vjet është martuar, babi im 15 vjet. Kështu që, janë feju të ri po... 18 vjet se kanë shku ushtar pastaj, 18 vjet janë martu. Po dymbëdhjetë vjet e kanë feju nënën time t'u rujtë... thojke, "Kam qenë në mal kur më kanë feju. Më thanë, 'Të kemi feju'. Unë s'kisha ide çka osht' fejesa".

Deshta me thanë, pra ka qenë një gru shumë e mençur që unë e kam pasë përballë. Babai im ka qenë ma energjik, ma temperament si person, ka qenë shumë i drejtë, ka lexu shumë në atë kohë. Se tash kur i analizoj që ai ka lexu shumë se atëherë nuk e kam kap atë gjë. Nëna ime ka qenë një grua që ka mbështetë shumë dhe që ajo me intuitën e saj i ka kuptu gjanat. Ajo kish me na nda neve librat krejt në bazë, e dije secila libri i kujt është. Lajmet me të dëgjume ajo kish me i analizu sendet. Çka osht' e rëndësishme edhe te babai im, gjithmonë e thirrte nënën time Shqipe. Nana ime e ka pasë emrin Selime po babai im gjithmonë i thonte Shqipe edhe gjithmonë më pëlqente si i thonte Shqipe. Disi ajo forma e thanjës më pëlqente, m'ka pëlqyer shumë.

Nëna ime ka jetuar 95 vite. Po ka qenë gjithmonë... ka pasur një energji të jashtëzakonshme pozitive dhe ka qenë e heshtur, nuk ka folë shumë po të ka mbështetë në gjithçka. Kështu që, me kënaqësi e kujtoj edhe edhe... babën tim në aspektin njërin aspekt po në aspektin tim edhe nanën, nanën time. Bile babai im ka qenë shumë korrekt se e kanë deshtë shumë fmitë dhe nxansat, se unë kam shku me të në shkollë, dhe ai i mirrke nxansat ua dhënte krejt lapsat. Kur ishte dimër gjithmonë i veshte mirë, i vishte ato teshat, ato rrobat që kemi pasë atëherë nuk kemi pasë edhe rroba... kanë qenë situata që njerëzit kanë, ka qenë varfëri ma e madhe.

I vishte të gjithë dhe dy nga dy i përcillte mirë në rrugë që ata nuk rrezikohen, se atëherë nuk ka pasë qarkullim shumë, trafik shumë, por megjithatë për shkak se të vegjël ka pasë... domethonë ka qenë klasor deri në katër vite. Dhe më pëlqente shumë ajo te baba im kjo formë e përkushtimit tij edhe me gjithë fmitë, jo veç me ne. Shpesh, bile kish shumë interesante se gjithmonë thonte, “Fmitë janë... si është koka e fmiut?” Na bënte neve, “Si një letër e bardhë”, thojke, “tabullarasë”, thojke, “edhe gjithçka regjistrohet aty dhe është shumë e rëndësishme si regjistrohet, si regjistrohet ajo. Dhe fmitë”, thojke, “nuk guxoni t’i frikësoni në asni mënyrë. Me kurgjo nuk guxoni t’i frikësoni”. Dhe shpesh...

Ish interesant se si lexonte. Ai kish drejtimin e trupit dhe qëndrimin dhe si ecte, kontrollojke, a e mban trupin drejtë. Domethonë, ka qenë gjithë aspektet i, i preokupum jo vetëm me ne po edhe me fmitë që është marrë. E kam pasë idol, e kam pasë idol. Unë kam dashtë të bëhem mësuese, kom pasë shumë dëshirë të jem mësuese. Por më vonë edhe pse kisha tendencë të bëhem mësuese, desha ta vë, veç një gjë ta them kësaj, kam pasë edukatën fizike se e kam dashur shumë sportin. Po vitin e tretë kam ndrru mendim përnjëherit për të marrë mjekësinë, për një shkak shumë... çka unë e kam përjetuar shumë randë.

Nana ime ish e sëmurë dhe kishte një problem gjinekologjik, gjakderdhje. Dhe e dërgova unë në spital në Kumanovë te një gjinekolog, po s’ka pasë shqiptarë domethonë kanë qenë të gjithë maqedonë. Mjeku u soll shumë keq, u soll aq keq sa unë u trondita shumë. Aty ish momenti që unë e ndrrova. Thashë, “Unë mjekësinë do ta marrë, gjithqysh mjekësinë do ta marrë dhe do të kthehem punoj edhe grave do të ju ndihmoj dhe do të kthehem do të punoj dhe do t’i them të njejtin mjek, se ti këso sjellje ke pasë me gra shqiptare”.

Ajo ka qenë shkakun që unë kam ndrru në vitin e tretë dhe e kam marrë mjekësinë. Nuk më vjen aspak keq që e kam marrë mjekësinë se e du shumë profesionin tim dhe i du njerëzit edhe gjithmonë du të ndihmoj sa kam mundësi të jap nga vetja dhe për të ndihmu. Kjo është ajo që mua... ka qenë vendimtare për shumë, shumë, shumë, shumë. Dhe ajo që kam shkuar në Prishtinë dhe ajo që kam vazhduar mjekësi edhe dhe që vazhdoj sot të punoj, dhe për mua njerëzit janë jashtëzakonisht të rëndësishëm.

**Anita Susuri:** E përmendet që keni vendosë flamurin ‘68-ën në rrugë...

**Teuta Bekteshi:** Po. Jo në rrugë po në shpi.

**Anita Susuri:** Po, po. Rruga ku ka qenë...

**Teuta Bekteshi:** Ka qenë për skej rruga kryesore.

**Anita Susuri:** Rruga ku keni jetu, fqinjësia çfare ka qenë? A ka pasë edhe tjerë shqiptarë që kanë qenë të njejtit mendim si ju apo si?

**Teuta Bekteshi:** Thom që jemi të ardhun, domethonë kemi ardhë. Jo ka qenë ni, ni mentalitet, ni injorancë e jashtëzakonshme. Nuk kemi pasë ne përkrahje në atë kohë të rrethit, por, por që me kohë ka ndryshu gjangat për atë kohë që nuk ka qenë, jo, jo nuk ka qenë. Ne kemi qenë shumë ma para në atë kuptim me hapave përpara sesa vet rrethi ku kemi qenë. Fshati jonë ka edhe maqedonë edhe shqiptarë. Domethonë, pjesa dërmuese është shqiptare po ka edhe maqedonë. Por, ajo lagjja që jemi ne aty, jemi gati të gjithë janë të ardhur. Prej fshatit tonë, prej fshatit të prindërve të mi, prej fshatit të nanës time. Domethonë, kanë migru dhe kanë ardhën, janë vendosë në këtë fshat. Afër qytetit, ni fshat i mirë. Është një fshat pjellor, ka ujë në tana anët është jashtëzakonisht i mirë dhe i thojnë fshat i bejlerëve, se ka pasë si duket në atë kohë hamame, ka pasë... po, po. Ka qenë edhe është ni fshat i jashtëzakonshëm edhe sot është fshati im.

**Anita Susuri:** Po ju si fmi por edhe kur jeni rritë çfarë ide keni pasë për vende tjera shqiptare? Për Kosovë për shembull? Për Shqipërinë? Si i keni paramendu këto vende?

**Teuta Bekteshi:** Për Shqipërinë edhe për Shqipërinë edhe për Kosovën është folë në familjen time. Shqipërinë e kemi adhuru. Tash ne të gjithë i adhurojmë, edhe sot e adhurojmë. Në atë kohë e kemi adhuru edhe pse kemi qenë, si të them, të copëzum në gjitha këto viset, domethonë territori shqiptar edhe kufijtë e saj. Kemi pasë shumë, se fliste shumë edhe mixha im që kish qenë në Shqipëri, se unë s’kisha qenë në Shqipëri në atë kohë. Baba im në atë kohë më kujtohet, pat’ iniciativë për të shkuar disa mësues në Shqipëri edhe shkun. Isha unë e re, kam qenë nxanëse e shkollës të mesme ndoshta, po nuk më kujtohet fillore ose mesme...

**Anita Susuri:** Keni qenë në Kumanovë a po?

**Teuta Bekteshi:** Po në fshat në Llopat, po, po.

**Anita Susuri:** Po keni mësu... ku ka qenë shkolla e mesme?

**Teuta Bekteshi:** Në Kumanovë shkolla, unë kom udhëtu. Kom udhëtu në shkollë të mesme tanë kohën kom udhëtu me bicikletë. Kemi qenë nja katër shoqe që kemi udhëtu me bicikletë, po unë kam udhëtu me bicikletë. Patën shku në Shqipëri edhe edhe ma u bonë knej, i lejun me shku. Si mësues në atë kohë ni grup e lejun. Kur u kthy baba im nga atje, prisnim me padurim çka po thotë për, për Shqipërinë. Më kujtohen qito dy sende që më ka thanë atëherë mu. Tha, “Në Shqipëri nuk guxon të ketë vrasje”, tha, “nuk po guxojke të ketë vrasje për arsye se vrasësin po e dënojshin në forma ma të rana. Vrasjet janë të ndalume rreptësisht”, në atë kohë them unë, “dhe vjedhje nuk kishte”, tha, “e lam ne, e harrum”, diçka kishin pasë harru, “dhe jemi kthy e kemi gjetë në qat’ vend. Domethonë vjedhje nuk kishte”, dhe ne, ishte ajo diçka e jashtëzakonshme. “Edhe flitej shqip”, a din si është.

Bile, ne kur vinte ndonjë, kur ndodhte të vinte ndonjë që kanë bajtë mallra, rrallë ka ndodhë ajo prej Shqipërisë, ne dilshim me taku atë gjithqysh. Dilshim me taku atë njeri, shoferin, atë vozitësin se na u doke njeri i jashtëzakonshëm, a din, se është nga Shqipëria. Për Kosovën ka qenë tjetër situatë se ato janë në kufi. Fshati ku është i prindërve të mi është në kufi me Kosovën dhe unë hallat i kam pasë krejt në Gjilan të martume, në Gjilan, në Prishtinë. Dajën e vëllaun e gjyshës time domethonë dajën e babës tim... Kosova nuk ka qenë, Kosova ka qenë shumë e njohur. Vëllau im ka qenë plus dhe student në Prishtinë para meje, nja tri vite para meje dhe të tjerët. Kështu që, për Kosovën kemi pasë shumë ma tepër informacione. Për Shqipërinë kanë qenë shumë të, të pakta informacionet. Po ne kemi hiperbolizu se e kemi dashur, se kemi pasë mbështetje që na ka motivu.

Bile në atë kohë në gjimnaz, po them unë për gjimnazin e Kumanovës, ne kemi qenë dy klasë krejtë në gjeneratë domethonë. Ka fillu me dy klasë dhe ka përfundu me dy klasë gjenerata ime. Po gjeneratat e mahershme nga ni klasë veç kanë qenë domethonë. Ka pasë shumë pak shqiptarë që... bile shumicën e rasteve nja dy herë edhe i kanë pasë rrahë edhe ka qenë ni situatë shumë e randë tek ne në Kumanovë. Se ktu ka... është një qytet me shumë nacionalitete po ka qenë shumë e shprehur shtypja dhe shumë e shprehur urrejtja për shqiptarët, se ka serbë, ka maqedonë, ka vlllehë. Plot prej vlllehëve e ktyne tjerëve, po sidomos prej serbëve. Dhe ka qenë gjithmonë ajo që nuk është leju.

Me emrat kemi pasë problem, të vëhen emrat. Kemi pasë problem gati për t'gjitha. Them që gjimnazin e kam kryer krejt gati në gjuhën maqedone. Në atë kohë ne kemi organizu, domethonë, ka qenë ajo fryma që pat' fillu dhe ne organizohemi në, me nxansat këndonim na. E kemi pasë profesorin e historisë që thashë këtë profesorin tim, doktor Ramiz Abdylin dhe ai na ka motivu shumë. Domethonë, historia e popullit ka qenë e ndalume në gjimnazin, të flitet për historinë e popullit shqiptar. Por profesor Ramizi neve ne ka mësu historinë aq mirë që nuk ka pasë nxanësi ma i dobët që nuk e ka ditë historinë e popullit. Ka qenë ajo e domosdoshme. Ai e ka bo atë jashtë... bile, vitin e dytë kur kemi qenë në gjimnaz ka organizu, ka qenë 500 vjetori i lindjes së Skënderbeut, domethonë '74-ta i bie, '75 ose '76.

Ka organizu ni recital, profesori, i njeiti profesor, domethonë i historisë. Ne kemi mbajtë edhe poezitë e Nolit, "O flamur gjak, o flamur shkamb". E kisha unë me fillu edhe kaq shumë kisha pasë bërtitë unë në mikrofoni, se me mikrofoni s'kemi ditë ne të punojmë aq mirë. Unë kam bërtitë aq shumë sa e kam tejkalu atë... "O flamur", kur kam bërtitë... edhe krejt më thojshin, "Ti shumë mirë ke recitu po shumë ke bërtitë". Unë kom mendu që në atë formë ai emocioni e ka bo të vetën. Domethonë ka qenë një, një profesor që ne na ka motivu shumë. Ne kemi lexu aq shumë në atë kohë sa, "Kalorësi i Skënderbeut", nuk e di a e keni lexu është një roman jashtëzakonisht i mirë. E patëm lexu ne dhe profesori, se na ipte për të lexu histori edhe romane.

Lexojshim shumë. Tha, "Do të dilni", më tha mu, "do të dalësh ti ta vizatosh si ka ardhë kasneci me lajmëru Malet e Dibrës", domethonë nga Dibra, "edhe qysh e ke pa ti, qysh e mendon me vizatu në



drasë të zezë”. Unë s’kisha, nuk disha vizatim mirë. O Zot i madh kurrë në jetë ma zor s’kisha... kam qenë në vitin e dytë gjimnaz, po flas për vitin e dytë. Dola i bona do male, s’disha me vizatu mirë, kalin e kasnecin e krejt. Domethonë aq shumë ka qenë ajo, ajo frymë e historisë e popullit, e shtypjes, e ballafaqimit edhe njohjes të asaj shtypje edhe çka duhet të bëjmë. Çka ne duhet ndoshta të ndryshojmë si të ri. Kemi organizu... organizime të mira kemi bërë në atë kohë në gjimnaz vitin e dytë.

Kemi këndu. Patëm organizu vitin e katërt, paramendo ti, ishin shkolla që e ndalun me këndu në shkollë dhe me lëshu mësimet në shkollë. Kemi qenë klasa e dytë prej maqedonëve për sukses. Kemi qenë shumë kemi pasë, 20 e sa shembullor në klasë. Kemi pasë 40 vet në klasë ne se klasat kanë qenë shumë të ngarkume. Ne e thym, e kishim kujdestarin e klasës maqedon dhe ne e thym ktë. Ne dolëm në koridor edhe shkum poshtë, ka qenë ni furrë buke, e blejtëm ni bukë se s’kishim. Atë bukën e ndamë krejt copa-copa edhe u ulëm në shkallë. Në katin e dytë ishim ne dhe në shkallë. U alarmu shkolla.

Na ia nisëm me këndu edhe e këndojsim, “Trim i madh o Skënderbe”, e kemi pasë shumë qef këtë kangën. E kemi këndu shumë. “Fryn murlani me stuhi, trim o Skënderbe”, është një kangë jashtëzakonisht e mirë. U alarmu shkolla. Na e lëshum shkollën edhe shkolla dolëm në rrugë edhe him nëpërmes qytetit, nga katër jemi rënditë, klasa jonë. Edhe shkum te ni vend përmendore, domethonë e luftës edhe kemi shku në kambë. Policia na ka shoqëru anash. Paramendo, na kemi bo atë hap që ka qenë e pakapshme një hap i tillë. Por nuk është përdorë dhunë në atë kohë, nuk është përdorë dhunë. Kanë qenë kto kangë por nuk është përdorë ndonjë dhunë e caktume në atë kohë.

Neve për atë arsye na thyn sjelljen nga pesë në njësh. Klasa jonë e dyta në shkollë me sjelljen në njësh. Ne fundin e kemi pasë domethonë klasa e katërta shatë me sjelljen njësh për shkak të ktyne aktiviteteve. Po ne nuk mërzitëshim shumë për atë. Ne e bom atë që donim në qytet e kangë e valle, ksisoj. Pastaj ka vazhdu ajo çashtja, çashtja e tjetër jetës time. Them, them, po nuk ka qenë ajo rastësi. Them që familja, familja është shumë e rëndësishme për formimin e identitetit të personit, qoftë identitet personal apo edhe identitetit kombëtar. Se ti duhesh, si të them, mbjell, të frymosh, frymon në bazë të asaj dhe si është familja dhe pastaj rrethi shoqnor është ajo jashta shpisë që dalësh, shkollimi e... ajo është faza formimi i identitetit. Edhe identitetit femëror besa.

Për mu ka ndiku jashtëzakonisht familja në formimin e identitetit tim femëror, femëror. Për arsye se gjithmonë është folë se femra duhet të jetë shumë e rëndësishme, femra duhet ta ketë vendimin e vet, të dëgjohet fjala e femrës. Është dëgju në familjen time fjala e femrës, e grusë edhe e femrës, domethonë është çmu. Babai im gjithmonë na thoshte, “Do të krysh diçka nga shkollimi që të mos ta kesh kërkond përmi vete, po ti të vendosësh vet për lëvizjen tane. Jo të të shtypi dikush po ti të kesh, vet të kesh atë lirinë tane edhe të punës edhe të lëvizjes edhe gjithçka”. Kështu që, ajo ka qenë për mua, për mua e jashtëzakonshme. Edhe sot i falënderoj shumë, diqysh kanë një respekt se kanë qenë kohë shumë të vështira seriozisht për, aq më tepër për femra.

**Anita Susuri:** Po kur ka ndodhë, për shembull kjo rasti që e përmendet me shokët e shoqet e shkollës a i kanë njoftu edhe prindërit? Qysh ka qenë reagimi i prindërve të juj për shembull për këtë?

**Teuta Bekteshi:** Ne e kemi bërë atë pavarësisht prej prindërve. Ne gjithmonë të ritë jo gjithmonë pyten prindërit. Po ta ndërlidhi këtë me një rast. Djali im, unë i kam dy djem, po ta ndërlidhi me këtë që s'pyten prindërit. Dhe i kam dy djem, njëri është informatikën, tjetri e ka ekonominë por kanë fmi e kanë familje. Kam tre nipa edhe një mbesë edhe është knaqësi të kesh edhe fmi se është shumë me rëndësi fmitë si do t'i kesh nesër. Unë kam insistu që fmitë e mi ma s'pari të kenë njerëzoren. Gjithmonë kam insistu që ata të jenë të njerëzishëm, me virtyte të atilla që të ndihmojnë me aq sa kanë mundësi, por që të dëgjojnë fjalë të mira për ty që janë të sjellshëm, janë të...

Po desha me thanë me këtë çashtjen ta ndërlidhi me çashtjen që s'pytet familja. Unë... djali donte të shkonte në Afganistan me punu për arsye se tek ne për punë shumë e vështirë ka qenë. Edhe pse student shumë i mirë por nuk i kanë pranuar në punë ose kanë marrë studenta që... tash po dihet edhe si është edhe politizimi i të gjitha gjanave. Ai kërkoi me shku në Afganistan me shku me punu, po unë isha kundër shumë se ishte e pakapshme për mu çashtja e shkuarjes në Afganistan dhe isha kundër. Tash unë nuk mundem, unë kam bo aq shumë, aq shumë. Jom mundu me ba, se mos të them aq shumë, se nuk është shumë kurrë, po gjithmonë është pak. Po jom mundu që gjeneratat...

Nuk kam mendu që do të formoj familje, se ne kemi mendu se jeta jonë do të jetë krejtësisht ndryshe, se kemi mendu që do të vritemi, do... domethonë nuk kemi mendu bile për fmi, [për] të familjes, por kemi mendu për gjeneratat pas nesh. As nuk e kemi ditë që do ta presim këtë kohë, por për gjeneratat pas nesh që ata ta kenë një jetë më dinjitoze, të jenë të lirë, të vendosin për jetën e tyre, të vendosin për punën e tyre, të vendosin për aktivitetet e tyre por të jenë të lirë si personalitete. Ka qenë shumë e rëndësishme edhe kjo si ka qenë baza e shumë gjanave që çashtja e lirisë, e kauzës lirisë, qoftë për lirinë personale, qoftë lirinë e popullit tandë, qoftë lirinë e njerëzimit, është një kauzë e çdo njeriut, se lindë me lirinë, çdo kauzë lindë me lirinë dhe i lirë lindë, po rrethanat pastaj janë tjera.

Dhe isha kundër kësaj. Djali më tha... njëherësh thashë, "Unë jam kundër dhe nuk kisha dashtë që ti të shkosh atje", tha, "A bon me të bo ni pytje", tha, "nanë ty", thashë, tha, "Ti", tha, "kur ke qenë në lëvizje", tha, "i ke pytë ndonjëherë prindtë e tu, i ke pytë për atë lëvizje prindtë e tu?" Thashë, "Jo, ajo ka qenë çashtje e rëndësishme, çashtje e popullit". Na s'e kemi marrë parasysh as familjen as kurgjë, s'ka ekzistuar kurgjë. Ka qenë vetëm ajo para nesh. Çka po i ndodhë familjes? Gjithë ato persekutime në familje tona që kanë, që kanë kalu nëpër gjithë ato vështirësi, ne nuk i kemi menduar, se i riu nuk e mendon. I riu mendon atë jetë prioritet dhe ai nuk ka ma, te ai domethonë nuk ka ma te ai.

Thashë, "Ajo ka qenë çashtje shumë e rëndësishme, çashtje e popullit", thashë, "çashtje", tha, "edhe e burgjeve", tha, "Po ti nanë mirë që ke qenë burgjeve", tha, "unë jam për ty se nanë të kam edhe krejt, po çka prej burgjeve nanë? Pozita jote", tha, "ti me gjithë këto halle, me gjithë këto derte, me gjithë këto mospranime, domethonë vend as atje, as atje", do të thotë ai në atë kuptimin, jo a ia ka vlej të?

Por, çka? “Unë do të shkoj”, tha, “atje do të punoj dy vjet siguroj jetën time kthehem përsëri. Ky”, tha, “është vendimi im”. Dhe unë atëherë u dorëzoza. Po dy vjet dhe unë kam insistu që të kthehet, të kthehet se kam pasë ni periudhë shumë të ranë të asaj periudhe. Se s’ka mujtë kurqysh me u pajtu fmitë... po kjo është. Dashta me thanë që vendimet i riu i merr, nuk i sfidon rreziqet. Domethonë nuk i merr parasysh rreziqet.

**Anita Susuri:** Po du me thanë që ju kanë dhanë përkrahje edhe familja në këtë drejtim?

**Teuta Bekteshi:** Po, po. Familja ime ka qenë jashtëzakonisht përkrahëse e madhe e imja. Pse? Baba im më ka marrë mu vet, mu më ka marrë në koncerte kur vishin në Gjilan. Ai më ka frymëzu në atë. Baba im, po nuk e ka ditë baba im, kërkush s’e ka ditë familjes time. Ne e kemi pasë qëllim që të familjes të mos i inkuadrojmë në rrethin e ngushtë tonin, në asni mënyrë për shkak të rreziqeve të mëdha. Ne kemi vepru veçmas. Domethonë ka vepru vëllai im, po ka vepru me tjerë. Domethonë, jo ne direkt në ato celulat në asni mënyrë. Me asni anëtar të familjes nuk jemi fut në celula. Ata i kanë pasë celulat e tyne, po na s’kemi pasë njohuri as për të atij as s’ka pasë... në rast arrestimit të dhanunat mbeten aty. Varet qysh i qëndron burgut, torturave, po me mbetë në atë vend.

Unë kam shku në këtë drejtim. Baba im, kur jam arrestu bile herën e parë në izolim kur kam qenë. Nana ime s’e ka ditë fare që unë jam në izolim. Ka pytë për mu, pse s’po vi, pse s’po vi, “Ka provime”. Nuk i kanë tregu nanës time fare që kam qenë në izolim. Unë u lëshova në izolim pas ni muji për shkak se nuk kishin fakte tjera dhe më lshunë në përcjellje. Tash ata kanë përcjellë. Po unë mas, ajo ishte qershori unë në tetor rash përsëri, u arrestova për së dyti në Suharekë dhe atëherit veç u pa që edhe nana ime, e kanë informu nanën time që kjo është krejtësisht diçka tjetër. Do të thotë, që duhet ta lajmërojmë. Po kam pasë mbështetjen jashtëzakonisht të familjes time, të gjithëve, të babës, të nanës, të vllazënve.

Ndërkohë që kam qenë unë në burg, ka qenë edhe vëllai im tjetri në burg. Domethonë ne kemi qenë ndërkohë dy veta, dy veta në burg. Bile, vëllai im i madhi punonte në Televizionin e Prishtinës edhe kur kam qenë në izolim ka ardhë me pytë, se s’e kanë leju me më pa. Po ka pasë edhe mrena burgut ka pasë gardianë të mirë që kanë qenë të sensibilizum, anipse nuk janë shfaqë. Po ka pasë momente e momente edhe kur e kanë shfaqë atë, atë simpatinë ndaj nesh. Dhe i ka thënë njëri gardian i ka thënë, i ka dhënë, ni faculetë ia ka dhënë vëllai im edhe diçka tjetër ka qenë e vogël, “Veç çoja dërgoja motrës ta dijë që kam ardhë deri te burgu se ajo nuk është vet”. Domethonë, aty ishte një tjetër mbështetje që veç ta dijë që domethonë.

Kështu që, unë kam pasë plotësisht... bile herën e dytë kur jam dalë, se herën e fundit jam arrestu në Kumanovë domethonë. Edhe dy, ka pasë dy javë që u lirova prej burgut, domethonë prej arrestimit të dytë me dy vjet që kisha. Kishte dy javë, ne kishim caktu martesën, dasmën. Unë isha e fejume që nga viti, domethonë vitin e katërt në fakultet jam feju dhe ishte ni lidhje imja e shkollës të mesme, kishim fillu na si fmi, si nshanës të ni klase me me shokun tim. Ishim feju shumë vonë. Ishte ni lidhje shumë e

gjatë. Bonëm... për arsye se u lshova dy vjet, hajt ta bëjmë martesën që, se ishte shumë gjatë. E kishin ni djalë familja e burrit edhe... dhe e bom. I bom me fustana me... mua bile më qepshin.

Qitu është qitu është ni osht' ni podrum këtu afër edhe hyn poshtë, ishte verë, jo ishte verë, nëntori ishte po këtu punonin ato. Më bonë mu krejt gati edhe në kry të dy jave unë u arrestova përsëri. Domethonë, dasma dështoi. Deshta me thanë që nuk ish çashtja e dasmës, po du me thanë që në atë rast mu më arrestunë në fshat dhe e rrethunë shkollën tonë, atë shpinë tonë. Shkolla është afër dhe nusja e vëllaut dhe baba im ishin mësus aty dhe i kanë vetë, edhe në shkollë kanë shku i kanë thanë, “Ne kemi ardhë për vajzën tande”. Po ishte problemi se ni natë përpara unë isha në Prishtinë dhe shkova se desha të takoj disa, sa kisha dalë prej burgut. Shkova në Prishtinë.

Në Prishtinë u takova me ni motër të ni shoqes time, shkova atje dhe e takova. Dhe shkova në ni familje që kishin qenë, kanë qenë mbështetës jashtëzakonisht të mëdhej të mi gjatë kohës, lëvizjes dhe time. Edhe shkova dhe t'i takoj ata. Aty unë mora informacion se ka ra ni grup i të rive, i Naimes dhe i grupit të saj. Po ishin 15 ditë, thanë që kanë ra dhe unë isha e sigurtë se nuk kanë mujtë me bo ndonjë lëshim. Masi 15 ditë kanë kalu. Unë u ktheva. Ndërkohë ata kanë ardhë, kanë bastisë tek ne qat' natë, domethonë që kam shku unë qat' natë kanë bastisë në shtëpi tonë, kanë kërku materiale. Ma e kanë bastisë me shpi e me krejt po që unë s'kisha informacione.

Ju ka thanë baba im, [ata kanë pyet] kanë thanë, “Ku është?” Ju ka thënë, “Ka shku në Prishtinë”. Unë vërtetë kisha shku në Prishtinë. “Ku ka shku në Prishtinë?” Po ne e kishim që thashë ni dajë, ni dajë mësus, dajë të babës tim. Ka thanë ka shku, se baba im s'ka ditë as ku kam shku unë, ka thanë, “Ka shku te ai daja sigurisht”. Paramendo çka ka ndodhë, ka bo bastisje te na ktu krejt, kanë shku në Prishtinë te ky daja. Ai ka qenë në Dragodan, ajo pjesa, se di tash qysh thirret. A thirret...

**Anita Susuri:** Dragodan.

**Teuta Bekteshi:** E kanë pasë shpinë. E kanë pasë, ai nanën e ka pasë të smutë plakë në krevat. E kanë tërheqë edhe nanën e vet e kanë nxjerrë e kanë kërku, s'kanë lanë sen. Njeriu pa pasë ide çka po ndodhë, e kanë bastisë. Po unë jam kthy të nesërmen, se s'kanë ditë atëherë lëvizjen time kah po shkoj unë. Jam kthy po jam kthy në mramje në Kumanovë dhe kam marrë me hy te shpija e... kjo shpi që është ta shoh shokun tim të fejumim po ai s'kish qenë këtu. Ndërkohë, na telefonin e patëm vu n'atë kohë, sa patën fillu telefonat fiks dhe kemi pasë edhe në shpi edhe këtu. Baba im, unë lajmërohna që kam mrrri. Thashë, “Jom këtu”, po tregoj. Baba im tha, “Jo rri aty, mos lëviz”. Nuk disha çka ka ndodhë veç tha, “Rri aty mos lëviz”.

Ai u ngrit, në kamë ka ardhë katër kilometra e ka prej këtu. Në kambë edhe tha baba, “Kanë bastisë”. Unë e kapa, e kuptova se nuk ishte hera e parë që ka ndodhë ni gja e tillë. Domethonë, ishte hera e tretë kjo. Shkum na në shtëpi, “Po ja më thanë që veç një kontrollë rutinë”. Unë e disha që nuk është kontrollë, e disha se këtu do të dali diçka. Po të nesërmen në mëngjes kanë shku në shkollë. Kanë shku

në shkollë edhe babës tim i kishin bo presion. E kishin rrethu shpinë tonë edhe babës tim i kanë thanë, “Ti duhesh me dorëzu vajzën se e kemi urdhër prej Prishtinës”, domethonë Sekretari i Punëve të Brendshme, “që me arrestu edhe me çu në Prishtinë”.

Babi im u ndodhë shumë keq. Paramendo tash fëminë sapo ka dalë nga burgu edhe përsëri ta arrestojnë edhe e ka ditë çka ndodhë masanej. I kanë thanë babës tim, “Nuk është problem”, i kanë thanë, “ne e marrim po edhe ty të marrim deri në Prishtinë”. Babi im erdh në shpi edhe ish nxi, e di si është për prindin. Nana ime ma kish bo një mëngjes herët, isha shumë e dobët unë. Edhe burgu edhe mos ushqyerja isha shumë e dobët, kam qenë shumë e dobët. Nana ime m’kish bo diçka për mëngjes, jo që më hahej mua po ende s’un e ktheja... po megjithatë u ula unë.

Baba im në qat’ moment erdhi edhe i erdhi shumë keq që unë... tha, “Shiko”, tha, “çika jeme, mu, kanë ardhë na kanë rrethu”, tha, “edhe presioni për me të arrestu”. Mendimi i parë i imi thashë, “Unë nuk dorëzohem”, se e disha çka më pret. Thashë, “Unë nuk do të dorëzohem”. Dhe baba im po më lutë mu, po më thotë, “Ti”, po thotë, “nuk dorëzohesh po të mysin dikund edhe s’mund ta gjejmë as as trupin as kurgjo s’do të gjejmë”, edhe atëherit i thashë, “Jo, nuk dorëzohem”. Po mendoj unë kah të dalë, thashë kah të iki, kah të shkoj? Motra ime ishte nja ni pjesë të asaj lagje, po pak ma larg. Po thashë nëpër mure, kah mixha im e te motra ime.

Baba im tha, “E rrethume është shpija, nuk ka shansë”, tha, “ti me po”, tha, “edhe me ikë kanë me të mytë dikund”, tha, “në burg bile e dijmë që je gjallë dikund edhe të kërkojmë, e dijmë që je dikund. Kështu s’un të gjejmë as trup as kurgjo”. Më lutë baba im, më lutë e bjer, “Edhe kësaj here dëgjom”, unë jo t’i them e disha çka më gjen, “Jo”. Lutë e bjer baba jem dhe unë më erdhi shumë randë prej prindërve edhe unë qashtu jam dorëzu. Nana ime kur dola prej oborrit, te dyrtë e oborrit tha, “E”, tha, “bija ime”, tha, “qysh ke qëndru nanës”, tha, “qëndro përsëri”, tha, “hiç”, tha, “mos u mërzit”. Edhe diqysh dolëm ne. Kur erdhëm ktu në, na prunë te Sekretariati këtu ku është policia.

Më hypën me ni dhomë... s’e disha ku se s’kisha qenë asnjëherë në pytje në Kumanovë unë të gjitha i kom mbajtë gati në Kosovë, në Prishtinë edhe në Mitrovicë e në Suharekë. E nejtse, por po du me thonë që në Kumanovë jo. Ai pyetësi ni shqiptar tha, se s’kisha pa kurrë, s’i njifsha. Mue më tha, “Ti”, tha, “çka ke ba?” Mue bash qisijoj me ashpërsi. Edhe unë kemi pasë atë pak a din atë s’po di qysh me thanë...

**Anita Susuri:** Krenarinë.

**Teuta Bekteshi:** Krenarinë edhe disi thashë, “A çka kam mujtë me ba”, po ia boj atij. Ai e pa që s’më kish pa asniherë as ai. Kur dola unë tha, “Për Prishtinë do të çojmë”, tha, “kemi urdhër me të çu në Prishtinë”, edhe tha, t’u dalë ma bëri mu, tha, “Dikush”, tha, “ka folë”, qita ma bëri mua. Asgjë tjetër s’më tha veç tha, “Dikush ka folë”. Unë... përskitazi më tha t’u ecë po mu, po unë e disha që diçka ka ndodhë se nuk mujnë me të arrestu pa pasë ni... Megjithatë, unë isha tri herë recidiviste dhe atë për mu për pak edhe pa thënë kërkush kishin me më arrestu. Ni dyshim ma i vogël kishin me më arrestu.

Më çunë për Prishtinë me katër policë me një Zastavë<sup>1</sup>. Dy policë [në ulësën] pas, unë në mes. Një polic përpara, tjetri vozitësi. Babës tim, baba im kur po dal po përshëndetët me mu tha, “O bre, shumë randë”. Pastaj i kishte thanë nanës, “Shumë randë kur ia dorëzova, shumë”, i ka ardhë vështirë. Edhe në Prishtinë edhe vazhdoj masandej radha e tretë e hetimeve edhe dënimeve dhe ja kështu.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Po du pak me u kthy te, qysh ka fillu krejt kjo me na rrëfy. Ndoshta kur keni ardhë në Prishtinë me studime apo si keni hy në këto rrjedha?

**Teuta Bekteshi:** Faktikisht hyrja në rrjedhje në lëvizje kam hy si student domethonë në ‘77-ta, ‘78-ta, ka qenë viti. Kam qenë studente e vitit të tretë me sa e di unë. ‘74- ‘75, qishtë i bie, gati tretit kam mujt me qenë kur unë kom fillu me... ne kemi pasën, ka qenë ni koicidencë shumë e madhe është me mua. [Teuta Hadri](#) me shoqën time, po, te dy Teutat. Se edhe kur na kanë dënu neve ka qenë një gazetë, një artikull, “Dy emnaket”, si sot... e patëm lexu ne në burg, “Dy emnaket janë dënu me nga...” herën e fundit që jemi dënu.

Mbahej një, Fakulteti i Mjekësisë kishte një seminar që mbante, 15 ditësh. Unë nuk dojsa këtu në Shkup [të studioja] se edhe kisha edhe për në Shkup, por nuk dojsa në gjuhën maqedone, dojsa në gjuhën shqipe dojsa të studioj. Edhe vëllau ishte në Prishtinë edhe ishin ato frymat, profesorët po vinin, po ligjërohet shqip, po vinin nga Shqipëria. Ishte ajo ndjenja për të shku për të studiu në Prishtinë. Po ka qenë shumë interesant se u deshke me u vendosë në konvikt. 15 ditë për me i mbajtë na kimi, biologji, fizikë landët.

Teuta Hadri... ka kthehna kah vi me vëllaun tim, erdha, hera e parë që në Prishtinë që kisha ardhë edhe ish ni pasdite se ne udhëtum herët. Ka shkojmë nga [Hotel] Grandi janë këto ndërtesa që janë tani, tash ka ndryshu Prishtina po ka qenë edhe Televizioni atëherë ka qenë, jo Radioja ka qenë përpara, ni ndërtesë afër që janë që të qesin te dekanati, që është dekanati edhe që janë fakultetet tjera që janë filozofiki e ato, ni rrugicë përpara jo sikur tash, po ka qenë ni rrugicë atëherë e pa asfaltume.

Teuta Hadri e ka pasë dajën aty me banesë edhe Teuta Hadri ka qenë, koicidencë shumë interesante është, ajo ka qenë në ballkon. Unë s’e kam njoftë Teuta Hadrin, as ajo s’më ka njoftë mue. Por më ka pa mu të re, rastësisht ka dalë në ballkon, më ka pa mu të re ka thanë, “Qikjo sigurisht ka ardhë për ndonjë me këta...” e ka pa që unë e hujë e krejt, “ka ardhë sigurisht ndoshta edhe kjo për Fakultet të Mjekësisë”, ajo ka mendu për momentin.

<sup>1</sup> Veturë jugosllave bazuar në dizajnin e FIAT. Këto vetura kryesisht përdorehin nga policia e asaj kohe.

Po ma bon prej larg, “Mirëdita, mirëdita”, po thotë, ka qenë shumë interesant. Ne u kthym, nuk ditëm çfarë është. “Ku po shkoni”, tha, “ju?” Na thashë, po i thotë vëllau jem, tha, “Motrën time”, tha, “po në konvikt”, tha, “për shkak se ka për të regjistru”, tha, “seminarin e fakultetit”, tha, “A sa mirë”, tha, “shikoni”, tha, “a e bojmë kështu”, tha, “unë e kom marrë konviktin”, e kish marrë konviktin, “po për shkak se unë po rri te daja edhe emrin e kam Teuta edhe kështu që automatikisht hyn në konvikt me emrin e njejtë veç mbiemrin që mund ta...” Dhe unë aty e kam pa për s’pari herë emrin e Teutës, jemi pa.

Ka qenë hera e parë në Prishtinë dhe hera e parë që ne kemi komunikuar dhe që pastaj që ka vazhdu me Teutën gjitha aktivitetet tjera. Masnej me Teutën kemi qenë gjeneratë. Kemi fillu të lidhemi pak më tepër. Ka fillu atëherit fryma, këto arrestimet që u bonë ‘74-ten, dënimet. Kishim me familjet e tyre ne njohje me të Rexhep Malës, se domethonë motra, gruaja e Rexhep Malës e kishte motër ni shoqe timen që ne e njohim në Prishtinë, dhe vëllau vet ishte jurist që ishte në Prishtinë dhe ne fillum këto lëvizjet e para për njohje pak më tepër dhe për... që masanej u organizum me vëllaun e Rexhep Malës, të heroit, me Teuta Hadrin dhe me Remzie Limanin dhe unë. E bom celulen e parë, e formum. E bomë.

Masanej kanë vazhdu lëvizja pastaj. Futja në lëvizje në LMKSh në atë kohë, domethënë kishe plot grupe tjera po ne nuk njiheshim mes vete domethënë, që kishim. Po që më vonë fillum të njifemi edhe kur u bo bashkimi i të gjitha grupeve atëherë edhe njiheshim shumë më tepër dhe aty ka fillu domethënë paraprakisht përgatitja. Ne kemi shku në Gjilan jemi taku, kemi bisedu derisa jemi njoftë pak. Atë frymën tonë, gatishmërinë tonë, se ishte rrezikshmëri shumë e lartë në atë kohë, ishin tabu gjanat në atë kohë. Ne bile, bile, ne në atë kohë nuk flitej për Kosovë, flitej për bashkim. Domethënë, ne kemi fillu për bashkim.

Lëvizja jonë ka qenë për bashkim të trojeve. Unë kam qenë për të Maqedonisë. Ka pasë të Malit të Zi, ka pasë të Preshevës. Domethënë, lëvizja ka fillu për bashkim. Po sa i përket Kosovës Republikë ka qenë situata që kanë determinu domethënë të dalim me këtë kërkesë për shkak çfarë u, ka lypset, mundësi për më vonë në jetë një bashkim. Se kishim drejtë në ni republikë, që kishin kërku më herët një republikë të gjashtë në ish Jugosllavi dhe kjo ishte. Atëherë ne u lokalizum këtë që një urë një rrugëtim i yni për bashkim. Aty kemi fillu ne.

Pastaj jemi zgjeru me radhë. Tani kemi detektu vajza të reja dhe djem. Domethënë, kemi pasë faza të edukimit tonë, përgatitjes tonë, trajnimit tonë, situata të jashtëzakonshme, si do të reagojmë si do të aktivizohemi, si do t’i marrim aksionet. Ka qenë masa, futja në masa, sidomos masat ma të varfëra kemi shku. Unë kam hy në shtëpitë ma të varfëra me preteks se po kërkoj banesë. Gjithmonë se ne student. Po që e kemi detektu pastaj frymën e vet njerëzve ku kemi nejtë, kemi bo bisedë. Edhe ti i ke bo bazat, për shembull në një mundësi të ni luftë, ku njerëzit, mobilizimin e njerëzve edhe kë do ta kesh me atë.

Kemi mendu që edhe në polici duhet të hyhet edhe në spital edhe aty të gjinden njerëzit. Domethënë, të hyhet prej brenda. Të mos flasim për fakultetet, për profesorët, për student atë që kanë qenë ma, që kanë qenë diçka e ditur që kemi punu. Dhe kemi punu shumë pasi i kemi formu celulat tjera. Kemi pasë shumë kujdes në formimin e celulave tjera se ka qenë betimi osht' bo me marrë çdo celulë që është formu është ba betimi. Por betimi është ba pas një aksioni. Domethënë kur e ke vërtetu ti që personi është i gatshëm atëherë është bërë betimi me flamur domethënë që do t'jesh konsikuent në lëvizje, që jetën do ta japim për flamurin për bashkim do të thotë.

Ka qenë ajo që pastaj kanë vazhdu në përmasa të mëdha. Ne kemi formu jashtëzakonisht shumë celula. Por që ka qenë shumë interesante se të gjitha celulat masi që janë formu, domethënë ai njëri prej celulës që ne kemi pasë besim më së shumti ka raportu tek ne që osht' formu celula. Por ata nuk na kanë njoft, domethënë kemi pasë konspiracion mos të na njohin ne kush jemi. Domethënë, që të mos njihen mes vete dhe që nesër në një arrestim të mundshëm të mos... asnjëherë bashkë nuk kemi ecë rrugës kurrë njëherë.

Kurrë njëherë me asni person ne që kemi vepru nuk kemi qenë në rrugë, se ajo ka qenë dëshmi se nesër nëse të arreston të identifikon shumë më lehtë dhe ne asniherë... veç rrugicave kemi qenë shumë herë msheftas, rrugicave, në shpi që kemi zanë, që kemi pagu ku kemi bërë shtypin e trakteve, ku kemi bërë shkrimin e parollave të mëdha me materiale. Domethënë, e kemi bërë nëpër shtëpi të caktume që i kemi marrë për ni kohë të shkurtë për ni muj. Domethënë, kemi ndrru vend, kemi pasë lokacione, vazhdimisht i kemi ndrru lokacionet për mundësi për mos me ra në gjurmë edhe për mos me u dekonspiru.

**Anita Susuri:** E në këtë kohë ju kur, para se me u angazhu, a keni ditë paraprakisht që ekzistojnë grupe të tilla...

**Teuta Bekteshi:** Po, po, po, po. Ne e kemi ditë se pikërisht kur jemi formu, ne e kemi ditë se grupet që kanë ra, për shembull me Adem Demaçin, duke fillu nga Adem Demaçi '68-ës edhe grupet e tjera, '74-tën ishin dënu njerëzit me të madhe. Ne, njerëzit kanë qenë jashtë që nuk janë arrestu në atë kohë po që janë arrestu disa prej tyne po që ka vazhdu lëvizja. Domethënë, ka vazhdu komunikimi, ka vazhdu aktiviteti. Nuk ka qenë ajo diçka që ka fillu prej nesh. Po ne kemi vazhdu në atë aktivitet, ne i kemi pasë të gjitha këto informacionet. Bile, qaq kemi pasë, jemi mundu të kemi informacione edhe çashtjen e dhunës seksuale që mund të përdoret brenda burgjeve.

Ne kishim dëgju për Marie Shllakun që ajo është dhunu. E kemi pasë këtë pikën dhe ta them të drejtën ka qenë pika ma e ndjeshme e gjithë asaj që ne jemi pregatitë. Këtë e kemi pasë frikën ma të madhe. Unë e kam pasë frikën ma të madhe, se torturat normale që pa e provu ti nuk e din, por kam mendu që gjithçka mund të duroj po këtë si do të kaloj në këtë. Jo që do të dorëzohem, jo që do të japë, por çka do të jetë jeta ime pas kësaj? Si do të jetë jeta ime pas kësaj, as një gjëje të tillë? Ajo ka qenë, do të



thotë, si të them pikëpytja ma e madhe ose frika. Si të them, frika ma e madhe e gjithë asaj punës që arrestimet mos... edhe na çojnë po si do të jetë pastaj pas gjithë kësaj.

Përndryshe, torturat njeriu kalon nëpër ato edhe e sheh sa mund se janë shumë të vështira dhe nuk e di ti sa mund të qëndrosh. Kemi përgatitur, kemi lexuar shumë literaturë, kemi marrë modele të ndryshme, për shembull prej luftës, prej qëndrimit të femrave të tjera nëpër burgje. Bule e kemi pasë edhe Persefoni Kokdhimën<sup>2</sup>, e kena pasë Bule Naipin<sup>3</sup> e kemi pasë model. Domethonë, ata i kanë çu në pushkatim edhe ata nuk kanë tregu asgja. Edhe diqysh e kemi pasë atë, domethënë që mund të qëndroje, mund të qëndrosh edhe të pushkatohesh po të mos ipesh. Ganimete Tërbeshi njikohësisht. Kemi pasë modele që kanë qëndruar jashtëzakonisht mirë në tortura. Edhe i kanë vra, po që nuk kanë dhanë.

Diqysh ke pasën ti edhe [modele] te meshkujt po se po, por te femrave që ka qenë për ne shumë të rëndësishme, domethënë modeli femër. Çka ka mund, si mund të përballojë dhe si do ta menaxhojnë gjithë atë situatë shumë të vështirë që jemi ballafaqu ne gjatë arrestimeve, gjatë torturave sidomos po edhe burgu. Se ne kemi vazhdu edhe brenda burgut lëvizjen edhe aty kemi punu... edhe ato që s'kanë qenë të aktivizime politikisht po edhe me vepra tjera, na edhe me ata kemi punu. Në një formë, në një tjetër që të lajnë një sjellje të mirë që njerëzit t'i ofrojmë një jetë normale.

Deshta me thanë që nuk ka qenë aty për aty, po ka qenë, ka qenë patjetër se ndryshe nuk mund të bish në kontakt me, me të hish në lëvizje. Ti nuk mundësh pa njoftë, pa pasë paraprakisht pa pasë njerëz që kanë punu edhe ma herët që ty të ofrojnë edhe që ti je e gatshme normale për t'i, për të hy atij rrugëtimi të vështirë.

**Anita Susuri:** Po du me ju pytë pak për aktivitetin e grupit, po edhe për rregullat që i keni pasë...

**Teuta Bekteshi:** E qartë.

**Anita Susuri:** Edhe pseudonimet për shembull. Pse janë bo ato? Po mendoj, e di që mos me u...

**Teuta Bekteshi:** E qartë.

**Anita Susuri:** Po nëse mundeni me spjegu.

**Teuta Bekteshi:** Ka pasë rregulla grupi, ka pasë jashtëzakonisht shumë rregulla grupi. Për shembull, rregullat kanë qenë takim, ato që thashë unë betime e këto krejt, ka qenë takimi me qenë shumë

<sup>2</sup> Persefoni Kokdhima (1928 - 1944) e lindur në Qeparo, Shqipëri, ka qenë veprimtare e Frontit Nacional-Çlirimtar gjatë rezistencës shqiptare. Ajo ishte shpallur Heroinë e Popullit nga regjimi komunist i Shqipërisë.

<sup>3</sup> Bule Naipi (1922 - 1944) ka qenë veprimtare e Frontit Nacional-Çlirimtar gjatë rezistencës shqiptare. U vra nga nazistët më 17 korrik, 1944 në sheshin "Çerçiz Topulli", në Gjirokastër.

konspirativ. Takimi, dalja në takime ka qenë 15 minuta përpara dhe ma së shumti 15 minuta me pritë, ma tepër s'ke mujtë. Gjatë shkumjes në takim, për shembull, ne gjithmonë kemi pasë një rregull, një kujdes. Për shembull, uleshim i lidhshim këpucat dhe shikonim mos po na përcjellë dikush. A po kupton? Për të gjetë mundësinë që ti nuk je në përcjellje dhe që të shkosh në atë takim.

Ka qenë shumë e rëndësishme, zakonisht kemi qenë persona shumë të zgjutë, domethonë kanë qenë studentë të jashtëzakonshëm. Seriozisht po them. Edhe nana... edhe masën... femrat që kanë qenë jo të shkollume, dhe që kemi hi në masë edhe me atë kemi pasë. Me atë na është deshtë punë ma shumë, normale se ka qenë shumë më e vështirë për të depërtu aty dhe për të marrë besimin se ka qenë tabu. Shiko, njerëzit janë frikësu shumë. Veç tabusë që ka qenë, janë frikësu shumë se ka qenë ni pushtet shumë i ligë, një pushtet shumë shtypës. Është ditë pastaj pasojat çka janë prej saj dhe njerëzit e thjeshtë janë frikësu.

Për të bo ti ni hap para, ajo është rrezikshmëri e lartë. Domethonë, gjithmonë është dashtë ti të bosh diçka para të tjerët për t'i pri të tjerëve që të vijnë pas teje. Po ai hapi para është me shumë, me shumë pasoja, domethënë që herë pas here ato qfaqen po që duhet ta bësh atë hap. Ajo ka qenë te ne. Domethënë, kemi kujdes me njerëzit, kemi kujdes mos me dhanë kurrënfare informacioni. Do të thotë, unë ato s'i kam ditë, ato të grupit andej. As Teuta s'ma ka thanë, po as unë s'ia kom thanë ato të radhës time, celulave të mija. Do të thotë, ka qenë gjithçka në konspiracion, veç ato të domosdoshmet që është dashtë të thuhet.

Kemi punu, kemi punu, kemi mbledhë të holla për të ble makinë shkrimi me studentë, se studentë kemi qenë. Domethënë, jemi mundu me bo vet. Po ka qenë entuziazëm i jashtëzakonshëm. Në atë kohë i riu bon hapa, domethonë vet. Nganjëherë shumë të rrezikshëm që mund të kenë, të dëmtojnë po entuziasmi e bën të vetën. Ti të bëjsh diçka patjetër, të bësh diçka. Domethënë, ne kemi vu në atë kohë, prioritet i kemi vu krejtësisht lëvizjen. Unë kom pasë periudha, bile edhe mësimin i kom lonë anash për arsye se ka qenë ma prioritet se vet, vet studimi im. Domethënë, ke pasë, ti je dashtë kohë, është dashtë kohë të takohesh me njerëz, është dashtë kohë të hysh nëpër shtëpi, është dashtë kohë. Deshta me thanë, në këtë relacion kemi pasë shumë, shumë kujdes. Që deshta me thanë, formimi i celulës ka qenë gjithmonë tresh.

Ka qenë tresh për shkak ma pak njerëz dhe ma pak informacione që mujnë me depërtu dhe ma pak njohje. Prandaj, është bo ky treshi. Se çdo tresh që është formësu, po them, unë e kom formu treshin domethënë me një person që unë e kom njoftë, ajo e ka formu treshin po ata persona nuk më kanë njoftë mu fare po kjo më ka dhanë informacion për treshin. Ai treshi tjetër informacion i ka dhanë asaj që unë e kom marrë. S'ka ditë ajo ma anej hiç. Domethënë, ka shku larg e ma larg po që nuk u ditë rrjedha. Gjithmonë duke u rrujtë rrjedha e, e, e lëvizjes. Domethënë, ai rrujtëzimi gjithmonë t'u u rrujtë ajo për arsye që në rast të arrestimeve edhe funksionimi është shumë i mirë po edhe në rast të arrestimeve mos të rrezikohen...

**Anita Susuri:** E për aktivitetet e tresheve të tjera, a keni ditë? Ju kanë lajmëru po nuk e keni ditë kush janë personat?

**Teuta Bekteshi:** Jo. Për shembull, unë e kom ditë personin, për shembull, ty të marrë në tresh. Unë ty të njof dhe ti e formon treshin tënd...

**Anita Susuri:** Po mendoj prej...

**Teuta Bekteshi:** Po. Ti më jep informacione për treshen. Unë kam pasë ma shumë informacione për shumë treshe, a po kupton? Se ata kanë qenë persona që janë tri. Po ata informacionet kanë qenë veç te unë. Ka qenë rreziku i madh, për shembull që ti gjatë një arrestimi e në tortura ti me bo lëshime të mëdha. Se torturat vetëm ata që kanë kalu e dijnë si është, kanë qenë të pa skrupullta torturat. T'u fillu prej shuplakave që ka qenë ajo e para që koka është ajo që nuk guxon të preket, me të gjitha konventat ndërkombëtare të dhunës, kundër dhunës, se ti nuk guxon me i ra në kokë, se koka është ajo ndjeshmëria ma e madhe është e kokës. Ti për shembull kur të rrahësh, ti me orë të tana në ftyrë të mshon, të mshon, të mshon edhe me kërbaç<sup>4</sup> e gjithçka, përjashto pjesët e tjera të trupit dhe ti ke konfuzion se ti ki komucion të trunit. Dhe ti kur ke komucion të trunit, fillon ajo kokëdhimbja e madhe, ajo vjellja e jashtëzakonshme dhe ti nuk je edhe, nuk je edhe... humb edhe koncentrimin, humb edhe nuk din ti edhe çka mundësh me folë edhe ma vonë se ndoshta ato fillojnë veç është një gjendje, ndjenjë shumë e randë e vet mendjes së njeriut. Ka qenë e rrezikshme gjitha kto të kalohen. Por, edhe ato mund të kalohen them unë se kam kalu nëpër ato them edhe unë që mund të kalohen.

**Anita Susuri:** Po për aktivitetet e di kom lexu dikund që i keni shkru dikund 200 trakte...

**Teuta Bekteshi:** Ah po, ajo është një nga aktivitetet. Ne kemi fillu me parolla të shkrujmë, do të them, ne kemi bërë në konvikte, do të them, ende pa u bo demonstratat. Ne kemi shkrujtë nëpër konvikte. "Poshtë Titizmi", "Ja vdekje, ja liri", "Lironi shokët". S'ka qenë ende... masanej kanë fillu me, "Kosova Republikë". Masanej mas ngjarjes, mas demonstratave kanë fillu këto tjerat, tjerat parulla them. Po në atë kohë kemi pasë këto, "Bashkim", e të gjitha këto kanë qenë parulla që kanë qenë të kohës, them, para '81-tës. Po flas unë periudhën para '81-tës. Kemi shkru na në të gjitha konviktet e mundshme në grupet tona. Traktet i kemi bo, kemi bo, dy herë i kemi bo traktet. Trakti i fundit ka qenë me 7 mars para demonstratave. Ka qenë ni trakt thirrës, domethënë thirrje. I kemi shkrujtë, i kemi pasë nuanë ni, ka qenë ni shtëpi andej tashi nuk di si i thonë asaj lagje po ku është rryma, në Taslixhe. A e di ku është ajo pjesa e...

**Anita Susuri:** Trafoja?

---

<sup>4</sup> Shkop i fortë për të rrahur.

**Teuta Bekteshi:** Trafoja, po. Po shkolla, gjimnazi që është është ni rrugicë që të qet te shkolla fillore, ni shkollë fillore është aty. Ia kom harru tash emrin se atëherë ia kom ditë emrin edhe të qet' te trafa qatje.

**Anita Susuri:** Mos "Gjergj Fishta"?

**Teuta Bekteshi:** Te "Gjergj Fishta"? S'e di, nuk e di. A e ka pasë edhe atëherë "Gjergj Fishta", s'ma, nuk e di, ndoshta.

**Anita Susuri:** Jo, jo...

**Teuta Bekteshi:** Nuk e di qysh kam harru tani si. Aty ka qenë ni rrugë poshtë saj ka qenë nifarë rruge me njëfarë lumi, njëfarë prrocke e vogël, ujë pak. Po ka qenë ca familje aty që kanë banu dhe ne na u deshke një shtëpi e vogël për disa ditë. Po ti s'mun merrshe për disa ditë se u deshke me marrë për ni mujë se kërkush s'ta jipke për disa ditë. Na si student e gjetëm aty ni shtëpi me, me çimento, me begato, e çimentos e vogël veç ni dhomë, domethënë hyrja, dalja, për skej rrugës. E gjetëm qato. E pagujtëm atë me Teutën edhe me shokun tim Samiun dhe vendosëm aty m'i shkrujtë traktet. Po ishte ftohtë, ishte ftohtë se marsi. Prishtina është e ftohtë si qytet, shumë. Pa nxemje, pa kurgjo.

Po ditën na me Teutën shkrujtëm. Teuta më ndihmoi me shkrujtë. Unë kom shkrujtë me makinë për arsye se vëllau, ne kemi pasë makinë shkrimi qysh në shkollë të mesme vëllau ka pasë, [ai] është marrë me shkrime dhe unë kam ditë të shkruj me makinë. Mbeta une me shkrujtë krejt atë pjesën tjetër të trakteve me dorë, një nga një në makinë. Po e morëm këtë shpi, nuk ish problemi ne që e morëm po ish rreziku se ajo shtëpia, domethënë hyrja, çimentoja dhe u nijte përjashtë *tak* {onomotope} a din, kah shtypej makina dëgjohej. Ishte rreziku që ne po na përcjellë tash dikush edhe...

**Anita Susuri:** Mos po dëgjon.

**Teuta Bekteshi:** Po, mos po dëgjon. Na atë shtëpinë ku e morëm ne kishin qenë disa studentë dhe tregojnë ma vonë që kanë ardhë deri aty, ata studentë kanë tregu se ju ka bo përshtypje kjo. Çka po bojnë tonë natën në atë dhomën e, veç unë kam qenë natën. Kishin pasë ardhë, kishin pasë dëgju po studentë si studentë edhe ata të aktivizum, edhe ata të aktivizum masandej. Që diçka po ndodhë në këtë dhomë. Unë atë natë kam shtypë deri në mëngjes pa fjetë hiç. I shtypëm nja 200-300 trakte kanë qenë, 300 ndoshta kanë qenë. Mbetëm gjithë ditën e gjithë natën domethënë kemi shtypë ne trakte.

Nga mëngjesi, ftohtë shumë, unë u ngrina. As nxemje aty, as kurgjo. Ni reshovë e kishin pasë lanë aty ata të shpisë, ni çaj me maru qaty. Ama edhe ni krevet aty edhe tavolina. Ai kreveti i ftohtë, as s'u nxejsha unë as kurqysh. Shkova niherë natën, kah ora 10:00 qishtu, thashë hajt po shkoj po nxejna, po shkoj po lypi do ujë edhe po e shfrytëzoj për m'u nxe pak. Sado marrë atë ngrohtësinë edhe ta shoh ktu a mos kanë marrë ndonjë... se ishte e rrezikshme. Shkova aty, ato më dhanë ujë po shumë pak

nejta edhe u ktheva, po s'thanë asgjë. Unë sikur u qetësova se e kishim frikën se po më arrestojnë aty t'u i bo traktet. U ktheva deri në mëngjes. Në mëngjes, kambët s'e dijsa që i kam të mijat hiç, s'i dijsa kambët, domethënë gishtat nuk ishin të mi.

Prej aty prej asaj rrugicës e kisha një shoqe time të lëvizjes, ajo është në Amerikë tani, Flora Mustafa, është në Amerikë. Ajo banonte te mixha i vet dhe edhe në shkollë të mesme të mjekësisë unë e pata aktivizu edhe i runte fëmitë. Ajo punonte në gjygj nusja e mixhës t'vet. Ky Hetem Ramadani, ky që merret me meditim, domethënë mixhë, te ky. Ky e ka pasë banesën qaty te gjimnazi, shpi, jo banesë, po bash shpi. Edhe unë kom shku, thashë shkoj të nxehna te ajo se s'i ndijsa kambët. Shkova te ajo edhe ajo tha, thashë, "Jo, kom punë", s'i tregova as asaj se edhe ajo nuk dinte se edhe ajo ishte në lëvizje aktive, po nuk e dinte çka kisha bo unë tanë natën e lume.

Uh, hyna te ajo u nxeha bile, ajo më boni edhe bukë. Bile edhe më boni, po e tregoj kta mes kësaj se kjo nuk thuhet aty, po ma boni do mish, se ata kishin se ishin si familje se punonte në gjygj edhe kishin të ardhuna. Më boni do mish, më tha, "Jo", tha, "do ta boj do mish". Edhe ma boni do mish, po unë s'mujsha as me hangër se isha shumë e lodhun edhe shumë e mërdhitë. E hangra ni copë edhe dola unë, u nxeva për me shku në banesën time. E kisha unë në Aktash banesën time, në Aktash dy e kom pasë numër gjashtë bile banesa ka qenë. Isha me vëllaun, me të dy vllaznit e mi. Masanej edhe vëllau tjetër na u bashkangjitë, i vogli. E kryjtëm.

Të nesërmen mrama, atë ditë i shtypëm, të nesërmen e vazhdum me shpërndarje. Atëherë tanë natën Teuta, ky shoku Samiu edhe unë. Domethënë, në pjesë të ndryshme kemi marrë qytetin për me i shpërnda, m'i futë nëpër shtëpija, veç i futshim nëpër shtëpija. Hishim brenda shikojshim a ka dikund... po ka qenë përparësi e jona se përpara nuk ka pasë kaq shumë drita, kanë qenë rrugët e errëta. Pastaj te Parku i Qytetit që është në qendër, te Fakulteti Teknik i mahershëm ai parku që është aty lartë. Tash isha bile e pashë e m'kish marrë malli ta shoh, po tash ish rregullu, atëherë nuk ka qenë asisoji. Ka qenë, ato rrugë kanë qenë me kalldrëm në atë kohë dhe s'ka pasë drita, shumë pak drita ka pasë. Ti ke mujtë me lëvizë natën se nuk ke mujtë m'u vërejtë shumë.

Ato nëpër shpija na i shikojshim, hapnim dyrtë, shikonim s'osht' kërkush veç ia futshim traktin qashtu aty aty. Ka qenë trakti pa... thirrje për demonstrata. Para demonstratave ka qenë ajo. Domethënë demonstratat fillun me 11 mars [1981] masanej vazhdun ma andej. Dhe kemi bërë trakte jo ni herë, po dy herë kemi shtypë trakte. Bile makinën që kemi ble, që e blejtëm ne... vëllai im punonte në Televizion të Prishtinës dhe më jipte mu gjithmonë të holla se thojke, "Ti s'po han". E gjithmonë më jipte të holla. Unë ato të holla nuk i harxhojsa se më thojke, "Dil ha në qytet se je e dobët e mjekësi". Unë i shtisha nëpër libra dhe i mbledhshim ato të holla që edhe makinën e blejtëm edhe në rast ni lufte na me pasë, me mbledhë të holla me ble...

Qaty makinën edhe atë makinë masanej ky shoku im kur kam ra unë në burg ai masanej e ka largu prej aty, e ka çu në fshat me ni vend dhe ende jemi duke e kërkun me atë shokun, se jemi taku. "A mund ta

gjejmë atë makinë apo jo?” Nuk di a mund ta gjejmë ma. Po po du të them që me ato trakte... e mos të flas për masanej që janë shkru nëpër rrugë, e është shkru gjithkrah, u shkru nëpër shkolla kemi shkrujtë parulla. Nëpër shkollë, nëpër rrugë, konviktet ato cimentet kanë qenë gjithmonë... me Teutën te shkolla atje naltë, e te konviktet e studentëve, nuk e di si thirren aty, kemi shkru në mur një natë; që ni kanal ka qenë aty, mendum që na nxunë policia kemi ra në kanal.

Po du të them kemi bo në shumë vende. Jo veç na, të gjitha grupet, të gjitha se nuk bëhet me... po kanë punu jashtëzakonisht shumë nëpër shkolla. Në Suharekë për shembull panotë kemi lshu tetë metërshe e kuqe me shkronja të zeza, “Kosova Republikë”, edhe, “Ja vdekje, ja liri”. Midis qytetit në 12:00 të ditës e kemi bo këtë, pastaj aty jemi arrestu.

**Anita Susuri:** A është hera e parë që jeni arrestu aty?

**Teuta Bekteshi:** Jo, hera e dytë kjo. Pastaj hera e tretë kjo me Teuta Hadrin që jemi arrestu edhe që jemi dënu pastaj nga një vit. Po pastaj që hapën procedurë për me na bo neve më tepër, ato s’murën të dhana. Po dënimi i vogël se kto kanë bo shumë ma tepër po edhe pse s’kanë dhanë, domethënë edhe pse s’kemi zbulu, këto kanë vepru ma shumë edhe dënimi është shumë i vogël ni vjet për ta hapë procedurën tjetër për grup. Po s’mundën me nxjerrë atë edhe mbeti qashtu qysh mbeti edhe... po grupi jonë nuk është zbulu asnjëherë, jo asnjëherë. Unë kam qenë e para që jam arrestu prej grupit, po nuk jemi zbulu, kjo është e rëndësishmja.

**Anita Susuri:** Përmendet traktet edhe që janë bo dikund 200-300 trakte, çfarë përmbajtje kanë pasë konkretisht këto, po edhe traktet në përgjithësi?

**Teuta Bekteshi:** Traktet kanë pasë, kanë pasë si të them, qëllimin kryesor sensibilizimin e masës. Se trakti, vet përmbajtja e traktit njihet për masë ma të mëdha sensibilizon. Se ti nuk ke qenë e lirë për të hapur për të folë. Kur t’i sensibilizon njerëzit... për shembull, qysh është tash, organizon tubime e sene. Domethënë, njerëzit i sensibilizon, një masë ma e madhe e njerëzve. Po mundesh drejt për së drejti të sensibilizosh edhe të flasësh për problemet. Po atëherë nuk ke mund ti të dalësh haptazi, po e ke bo në forma të ndryshme. Parolla, për shembull ka qenë ni thirrje ose diçka që është, që është theksu. Traktet kanë pasë përmbajtje.

Traktet, për shembull, situata e randume është shkru, situata e randume, shtypjet e vazhdueshme, arrestimet e mëdha, vrasjet. Atëherë i bijshin në arkivole ushtarët, domethënë nanat nuk kanë guxu as m’i çelë arkivolet. Domethënë, ishin çka po na bën do të thotë shtypja, shkojke gjithmonë e ma shumë t’u u shtu, domethënë egërsia ishte gjithmonë në rritje e pushtetit. Dhe aq ma tepër, jo veç ndaj nesh por edhe ndaj studentëve. Se ti kishe një student, një elitë që masanej do të jetë edhe një elitë politike që ka vazhdu masanena edhe që kanë dalë prej burgjeve në pajtim të gjaqeve, por edhe në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; që ka pasë nga këta, nga kjo elitë e studentëve, nga kjo elitë studentore.

Ke pasë edhe intelektualë, ke pasë edhe njerëz të masave normale që ajo ka qenë krejt në bashkëveprim. Po po du me thanë që ka qenë një masë që ka, ka lëvizë, ka lëvizë gjanat. Domethënë, ka qenë një katalizator i shumë proceseve që do të jenë ma vonë. Traktet e kanë pasë një edhe një si të them, një anë të saj të mirën, se ti, për shembull, kur e ke qit' ti traktin dhe ke shkrujtë traktin, "Qikjo shtypje është po na kthejnë kështu, do të ngrisim zanin e duhet të ngrisim zanin. Ne duhet të protestojmë, ne duhet të reagojmë gjithë këto që po na ndodhë". Atë trakt, për shembull, atë trakt e ka lexu një familje e tanë se e ka gjetë edhe e ka lexu ose atë trakt e ka rujtë, ka shku ia ka dhanë edhe tjetrit. Dikujt ku ka pasë besim, familje ma të gjanë.

Ti e ke mundësinë e informimit edhe thirrjes edhe sensibilizimit shumë ma të madhe me formë të trakteve. Pastaj kanë qenë gazetatat, të mos harrojmë, kanë qenë gazetatat ilegale. Ka qenë, "Zëri i Kosovës", ka qenë, "Lajmëtari i Lirisë", domethënë edhe ato janë shpërnda. Përpos trakteve janë shpërnda edhe ato. Domethënë, ka qenë shpërndarja e tyre shumë e rrezikshme në atë kohë. Atje ka pasë poezi, ka pasë thirrje, të gjitha gjanat në ato gazeta që janë bo jashtë. Shumica janë shtypë jashtë, se brenda kanë qenë shumë vështirë për t'u shtypë ni revistë në atë kohë.

**Anita Susuri:** A keni punu ju për shtypjen e revistave?

**Teuta Bekteshi:** Jo, në shtypin e revistave jo. Unë kom punu në trakte po në revista ka punu, kanë punu... ajo është bo ma tepër jashtë në Zvicërr e në Gjermani sesa që është bo brenda Kosovës, se në Kosovë s'ke pasë mundësi ti me shtypë se s'kanë qenë, rrethanat kanë qenë të atilla. Ti për të pasë një shtypshkronjë në Kosovë, në ato kohna... dhe deshta me thanë, efekti i traktit ka qenë kjo: jo rastësisht janë organizu demonstratat e, e '81-shit. Na në '78-ën kemi pasë ni protestë tjetër. Fakulteti i Mjekësisë ka qenë baza e studentëve aktivë, nuk di pse ka qenë Fakulteti i Mjekësisë ni gja e tillë, por ka qenë shumë ka pasë studentë aktivë. Na në '78-ën kemi bo ni protestë, kemi protestu dhe në kambë kemi ardhë prej Fakultetit të Mjekësisë deri te dekanati këtu që është qendra, që është ndërtesa...

**Anita Susuri:** Po.

**Teuta Bekteshi:** Kemi ardhë aty. Kemi pasë preteks... ne kemi pasë në Fakultetin e Mjekësisë kemi pasë gjithë profesorët e Beogradit, profesorë eminent të Beogradit që kanë libra sot që njerëzit mësojnë nga librat e tyre. Ne kemi pasë profesorë se nuk ka pasë kuadër Fakulteti i Mjekësisë kuadër shqiptare ende, se kanë qenë fillimet e Fakultetit të Mjekësisë. Ne i kemi dhanë të gjitha provimet serbisht. Pastaj ka ardhë prej Shqipnisë... epidemiologjinë e kemi pasë dhanë me doktor ka qenë Gojart Cerga, pastaj kanë ardhë profesorët e farmakologjisë. Domethënë, ma vonë kanë fillu të vijnë kuadro që ne ka qenë ajo kënaqësia ma e madhe. Bile, ka qenë ajo që unë domethënë e kom pritë me padurim edhe kom ardhë në Prishtinë pikërisht shqip të studioj.

Deshta me thanë këtë në këtë relacion se mos te hupi mendimin, Fakulteti i Mjekësisë atëherë organizoi '78-ën ishte dhjetë vjetori i demonstratave 1968-ës dhe ne ishim ni grup që ishim aktiv. Veç patëm fillu ne, se në '78-ën ne veç u futëm në lëvizje. Teuta e disa, po ne të mjekësisë. Ishin disa shokë tjerë që ishin shumë aktivë, nuk ishin në radhët tona po kishin radhët e tyre po që e dishim ndjeshmërinë e tyre për këto gjëra. Ne e dishim që janë aktivë, po punojnë në forma po ne nuk po njifemi. Secili në anën e vet, se kishim frikë dekonspirimin. E bomë për arsye se kërkuam profesorë shqiptarë neve të na ligjëroj. Insistojshim që profesorë shqiptarë të na ligjërojnë dhe ka qenë, ka qenë kërkesë në fakt në formë kërkesë e tillë, po na e bom protestën për '68-ën ni formë për të pasë ligjerime të profesorëve në gjuhën shqipe. E organizum këtë.

Në dekanat kur e morëm ishte me marrë fjalën. Ishte problematike se kush e merr fjalën. Ne atëherë kemi marrë fjalën, unë kam marrë edhe ni Hasan Bekteshi edhe ai Bekteshi mbiemrin por i Kërçovës. Po koiçidendë kjo çashtja, puna e mbiemrit. Dhe kemi marrë ne fjalën. E ka marrë më duket edhe Arsim Braha, nuk e di tash nuk jam e sigurtë, se kta e mbaj mend që unë e kam marrë edhe Hasani ky kolegu jonë e ka marrë fjalën. Pastaj e kanë marrë të tjerët pasi kemi qitë na kërkesat pse kemi marshu prej Fakultetit të Mjekësisë deri aty, dhe pastaj kanë intervenu policia po nuk është përdorë dhunë.

Na kanë shpërnda me pretekst se Fakulteti i Mjekësisë... jo pretekst, po ato akademikët e kresë, Fakulteti i Mjekësisë i ka studentët ma të mirë e gjoja kanë të drejtë me kërku në gjuhën shqipe. Kështu që ishte, domethënë që protestat nuk kanë fillu me '81-shin. Ajo ishte një... edhe një provë për ne që ne mund të organizojmë dhe mund të organizojmë protesta të tilla. Prandaj, protestat veç kemi gjetë momentin, kemi kërku momentin se edhe ato janë momente të caktume kur ti nganjëherë nuk e pret po është një moment që ti pastaj kanalizon gjanat, po ti e ndihmon atë moment. Prandaj, demonstratat e 1981-shit kanë qenë të organizume. Na kemi punu shumë për këto demonstrata.

Ka ardhë momenti që ne... se ka qenë shtafeta, ne kemi qenë kundër shtafetës. Bile në atë kohë kanë pasë shtafetën me pru na kur e kemi bo atë. E kemi pasë ni shoqe Sanije, ia kom harru qitash mbiemrin, e Fakultetit të Mjekësisë. Atë vjet e zgjodhën Sanijën për t'ia çu...

**Anita Susuri:** Hyseni?

**Teuta Bekteshi:** Hyseni, po. Për t'ia çu atë...

**Anita Susuri:** Shtafetën.

**Teuta Bekteshi:** Shtafetën Titos. Na ishim kundër, na u çumë krejt kundër. Bile, për atëherë s'i kemi folë na Sanisë, s'i kemi folë asnjë. Na u çumë, na u revolumë, "Pse Sanija me ia pru shtafetën?" Edhe ishin se shtafeta edhe bash pikërisht ato ishin edhe reagimet edhe organizimet e tilla pikërisht që ishim kundër qasaj edhe qajo shtafetë mos me iu dorëzu këtij. Por Sanija shkoi, po ne pastaj s'i kemi folë asnjë. Kjo ishte. E deshta me thanë që kanë qenë të organizume, thjeshtë është punu shumë,



është punu shumë për ato organizime. Se pastaj demonstratat e tjera kanë ndodhë... se '89-tes demonstratat unë kom marrë përsëri pjesë në ato.

Kam qenë përsëri në hallën e sporteve e patëm bo bile kam pasë ardhë prej Kumanovës. Shkova atje për të marrë pjesë në ato demonstrata. Kanë vazhdu pastaj, Lëvizja ka vazhdu punën e vet, domethënë. Pastaj pajtimi i gjaqeve, pastaj senet e... gjithë këto domethanë që është ai rrugëtimi që ti... dhe unë e kam thënë gjithmonë, cilën, çka vlerësoj ma së shumti domethënë te njeriu, te ni personalitet, aq më tepër që është i kyçun që punon në kauzën e lirisë. Them i përkulem njerëzve ose dëshmorëve, heronjëve që kanë dhanë jetën, që ata nuk kanë çka jepin më shumëe ajo , sështë më sublimja, ajo është ma... dhe njerëzve që tanë jetën, do të thotë, pa ndërprerë apo në forma të ndryshme japin. Domethënë janë në atë proces dhe atyre i përkulem.

Përndryshe, periudhat kohore që dikush ka dhanë, ka kapë koha ose ke dhanë është jashtëzakonisht e rëndësishme po nëse ka ngecë qaty nuk kish me qenë mirë. Domethënë ajo është ni kontribut që ti tanë jetën duhesh me thanë, duhesh të japësh edhe duhesh të aktivizosh edhe duhesh të veprash me forma të ndryshme. Varet konteksti kohor cilën e kërkon, po kur t'i përkushtohesh kauzës të popullit tënd edhe mirëqenies të popullit tand edhe gjithë popujve jo veç popullit tim por atyne njerëzve që jetojnë në atë kontekst kohor që janë bashk. Gjithëve njerëzve jo veç popullit tim për një mirëqenie, për një liri të veprimit, të lëvizjes, të punës. Ni standardi të mirë jetësor, ni mirëqenie, një si them, një jetë me pasë një, me rujtë integritetin e njeriut. Një jetë, me pasë një dinjitet thjeshtë me pasë jetë. Është gjaja ma e mirë, ma e mirë për një njeri.

Unë mendoj që ajo është një rrugë ime që kam zgjedhur dhe që jam shumë shumë në paqe me vetë vetën që jam në atë dhe megjithë peripecitë po që jam në atë dhe vazhdoj të jem në një formë apo tjetrën që jam pjesë e të gjitha ktyne proceseve që kanë të bëjnë me mua vet dhe me popullin tim dhe me gjithë popujt e tjerë të botës.

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Unë po du pak me me ju pytë edhe për jetën kulturore që është zhvillu në periudhën e shkollimit të juj. Para ramjes në burg ka pasë edhe shumë grupe që kanë ardhë prej Shqipnisë...

**Teuta Bekteshi:** E qartë.

**Anita Susuri:** Qysh po mendoj edhe po më duket që shpesh herë edhe i keni shoqëru.

**Teuta Bekteshi:** E kemi bo. Ne grupet kulturore unë kam qenë edhe vet, unë kam këndu, kam vallëzu edhe kam qenë në ni shoqëri këtu kulturore të kangës, "Bajram Shabani", thirret edhe në shkollë fillore kemi pasë shumë aktive këtë gjë dhe kemi këndu dhe kemi vallëzu. Unë e kam dashur gjithmonë

kangën. Kangën kam këndu por tani nuk e kam atë zë si dikur por me vallëzu e kam edhe çdokund ku shkoj, kudo që shkoj në çfarëdo vendi të botës unë do ta mësoj një valle të atij populli se e kam shumë qef vallen.

Në atë kohë kanë ardhur grupe të ndryshme. Vinte ansambli shtetëror i kangëve edhe valleve, kanë ardhë grupe sportive. Mu më kujtohen patën ardhën, “Teuta”, e Durrësit, është klub futbollistik domethënë ekip. Patën ardhë me lujtë me Prishtinën në atë kohë. Ne si studentë, “Prej Shqipnisë po vijnë”, ne organizum krejt studentët. Ka qenën Stadiumi i Prishtinës atëherë qysh ka qenë përplot, përplot. Po nuk ish problemi që na me fitu, ish problemi që ata lujshin bashkë dhe ish problemi se na anojshim edhe nga Prishtina edhe nga Durrësi. Për ne nuk ishte me randësi kush po fiton, ishte e randësishme që po lujshin bashkë.

Më kujtohet shumë mirë ni rast, ne brohoritëm, brohoritëm dhe ka dolëm ne kemi pasë, unë kam qenë e vogël kështu jo shumë e pashme, jo shumë vizuele, nuk kam ra shumë në sy dhe kam mujtë me depërtu pak ma lehtë. Teuta ka qenë karakteristike se floktë e kuqe edhe bike në sy, po unë nuk bisha në sy edhe mujsha me hy, e kom pasë lehtë me depërtu në shumë gjana. Vëllau jem ka qenë, vëllai im që më ka vdekë edhe ky i vogli ka qenë i madh, i pashëm, i mirë. E diqysh bijke në sy edhe na nalshin policia gjithë e kurrë s’e merrsha me vete. I thojsha, “Ti rri se mu kërkush s’po më ndalë”, se...

Edhe i pashë, shkova të takoj njërin prej lojtarëve unë kur dolën prej stadiumit, se çka po thojnë këta të Shqipërisë tashi si ishte. Ai po ia bon, p’e pytë ky njëri aty s’di çka pyti veç tha, “Na kanë thanë neve në Shqipëri”, tha, “që nëse ndodhë ndonjë incident gjatë lojës”, se mund, loja është lojë edhe nganjëherë, tha, “po t’ja u mshojnë njanën anë, ti ktheja anën tjetër. Por jo me kundërshtu, jo me ia kthy”. Domethënë, po ta mshoj në këtë anë {prek tek faqja e djathtë} ti me ia kthy edhe tjetrën jo me kundërshtu me ia kthy ti, në asni mënyrë. Du me thanë... mu më boni përshtypje. Thashë shiko sa mirë, a din, e di, më boni përshtypje.

Ishte rasti kur kanë ardhë ato, kur kanë ardhë të Ansambilit të Valleve edhe Kangëve, Teuta, na kemi qenë po them, edhe me shoqe po ne kemi ma shumë kemi lëvizë kështu bashkë. Tham, qysh me hy në Teatrin Kombëtar që është sot. Aty u mbajke koncerti. Po qysh me hi na se biletë kërkush s’na jipke, s’ju jipke studentave biletë. I tham, “Teutë, hajt na po shkojmë po njëfemi me këta të Shqipnisë”. Unë gjuhën nuk e kisha problem se mu asnjëherë nuk mujshin me më dallu, se të folurit e kisha shumë të përtafërt, a Teuten po se Teuta gjakovare edhe ajo u dalloke meniherë. Thashë, “Ti mos fol hiç, unë po flas”.

Ajo e mori ni instrument edhe unë ni instrument. Unë në fund. U veshëm na sikur ata. Ata e kanë pasë ni veshje pak si klasike, do farë kaputa, do farë pantollësh. Jo kështu si na, na kemi qenë ma të lirë sa i përket veshjes. Po mu veshë si ata që ma ngja na ma shumë me ata. Kah hypëm shkallëve krejt policë, krejt spihuna ato spihunat të UDB-së t’u rujtë anash. Teutës i thashë, “Ti mos fol hiç, unë po foli. Ti mas meje, ti...” unë, “Si jeni? Tash do të hyjmë”. Unë tashti pak për me kamoflu Teutën, për me rujtë

Teutën. Edhe hinëm na te dyjat, por problemi ndodhi kur hinëm mrena. Tash për me dalë na në publik, qysh me dalë? Ata po thojnë... a unë ambasadorin e Shqipërisë në atë kohë në Beograd kishim komunikuar disa herë me të, atëherë ka qenë posta e vjetër e Prishtinës edhe ne direkt [komunikojshim].

Por ne dojmë me shku në Shqipëri me organizu me studenta në '79-tën për me shku në Shqipëri. Për me shku në Shqipëri u dashke me folë me ambasadorin që me na mundësu neve me shku na diqysh. Unë e bona krejt këtë punën në telefonata për me shku në Shqipëri edhe vendosëm. Ne nuk shkum me Teutën. Kurrë s'e harroj. E bona pasaportën e me të holla, baba im m'i boni gati, ne nuk mujtëm me shku. Për arsye se ishte rrezik që na kur të arrestohemi, kur të kthehemi prej Shqipërisë, kur të arrestohemi e kanë edhe një plus që ju keni qenë në Shqipëri edhe atëherë kish me qenë shumë problematike çashtja jonë. Krejt shkum grupi, na e organizum, unë e organizova ta them të drejtën edhe në fund nuk shkum ne. E unë sa kam vujtë, sa kam qajtë për atë rast që nuk kom mujtë me shku. Krejt shkum. Krejt grupi shkoi, ne nuk shkum.

Hym na brenda. Po kur hym na brenda ky ambasadori kish qenë në radhën e dytë, e para e dyta. Në atë radhën në fund, na dhanë neve kaputat. I kanë pasë do kaputa drap janë konë, ngjyrë të çelun edhe unë e veshja kaputin. Teutën me ni kaput tjetër. Na dhanë kta të Shqipërisë që mos m'u dallu na se rendet e para. U ulëm na. Ai ambasadori po na shikon neve se e dike që na s'jemi, student jemi se s'mujke me... po ia nisi kanga, ia nisëm na po na del zemra prej vendit, kush me mujtë m'u duru pa rreh shuplakë, pa u çu në kambë. Na njiherë fillum ngadale po dikur u çum. Po ishte shumë serioze se kish shumë të UDB-së aty që na, që e përcjellshin situatën. Atëherë kemi pasë, menzi që kemi pasë shpëtu me të kallxu të drejtën, menzi që kemi shpëtu.

Njiherë tjetër kemi hi nër... ka qenë, kanë qenë të basketbollit që patën ardhën [me lujtë] basket, grupi i basketbollit të Shqipërisë. Nuk e di si është thirrë në atë kohë, a ka qenë shtetnor ai edhe në Kosovë edhe na me ata me u shoqnu. Edhe të vrapit, të atletikës, grupit të atletikës. Na me autobus prej Fushë Kosovës atje ma menzi që s'na nxun. Na me atë autobusin ku kanë qenë ata, me atë autobusin e atyne na me u kthy. Bile edhe Bajram Kosumi ka qenë në atë autobus në atë kohë edhe u kthym na në Prishtinë. Po darka ku u shtroke në Hotel Grand poshtë në podrum. Jo për neve s'u shtrojke darka, po na me shku m'i taku apat, kureshtja tash me i pa ende. Edhe neve na kanë diktuar. Kur kemi bo me dalë na kanë ndjekë.

Kanë qenë do kerre para Hotel Grandit, na kemi hy nër kerr. Për mos me na nxanë kemi hy nër kerr, jemi shtri nër kerr. Edhe ata derisa na hupën neve se t'u sha ata, "Ku shkum, ku na hupën?" Edhe na masanej kur janë largu krejt ata, na kena dalë përfundi edhe nuk u nxum. Ka qenë interesant se nuk më kanë njoftë, nuk na kanë njoftë neve, se nuk na kanë nxanë asniherë ma herët edhe kemi qenë ftyra të panjohura për ta. Arrestimet kur kanë qenë kanë qenë... e para ka ndodhë për ata se njerëzit nuk na kanë njoftë. Prandaj, ndoshta ka zgjatë kjo kohë ma të gjatë, domethënë ky '78-a kur jam arrestu në '82-tën. Unë jom arrestu në maj të '82-shës, në izolim kam qenë. Domethënë, kanë qenë vite të tana që ne i kemi shpëtu falë këtij konspiracioni, falë këtij kujdesi të madh që kemi pasën edhe që kemi vepru.

**Anita Susuri:** A mundeni tash me na tregu për '81-tën, demonstratat. Si i keni përjetu ju?

**Teuta Bekteshi:** Shiko, ne kemi fillu prej 11-shit [mars]. Ne kemi qenë në konvikt të studentave bile atë natë kur ka ndodhë 11-tshi që kanë fillu ato tollovitë e para. Ne pritshim në radhë për ushqim edhe unë isha... çka osht' ma së interesanti unë kam pasë shumë qef këtë Menzën e Studentëve, se pasuli më ka pëlqy ma së shumti edhe ata me presh me prasë [purri] që e bojnë nifarë gjelle e bojshin po ka qenë diçka që unë ma së shumti e kom deshtë. Ne pritshim, kishim kartela edhe prisnim me radhë. Atë natë na veç, filloi iniciativa për të ba, për të ndodhë diçka se ishte marsi. Çdo mars e pritshim, prilli që diçka do të ndodhë. Ishin mujtë që gjithmonë kanë dhanë histori, diqysh kanë ndodhë ngjarjet. Aty filloi ajo tollovia me entë e me send.

Ne kemi dalë deri poshtë, por poshtë kur kemi dalë, poshtë policia. Veç e lajmërunë policinë që po ndodhë. Pastaj kemi dalë prej aty, kemi dalë në atë, domethënë konvikti, ku është Menza e Studentëve, pastaj hapësirë aty ka qenë e gjanë ajo pjesë. Naltë ka qenë halla e sporteve, naltë kanë qenë do baraka, pastaj konvikti I-shi, II-shi, III-shi, IV-shi me radhë. Ajo hapësira aty dhe aty masanej kemi fillu me brohoritë dhe aty ka fillu hera e parë që thonë, "Kosova Republikë", në një gur, ka qenë një gur. Bile e hypëm Ali Lajçin e hypëm na, i dham zor me hyp në gur se ishim na për bashkim dhe nuk mujshim ne me kap fort këtë po ish nevoja që me bo. Aty hera e parë është brohoritë, "Kosova Republikë".

Pastaj ka fillu qyteti, kanë shku në qytet edhe aty kemi brohoritë. Pastaj policia ka intervenu, pastaj arrestime e të gjitha ato. Pastaj ka vazhdu faza e 26-shit [mars]. Me 26 kanë qenë protesta tjera, domethënë protestat kanë qenë të organizume përsëri te konvikti. Te konvikti i studentëve bile aty dolën, erdhën kto [Azem Vllasi](#) e për me shpërnda, e kërkesat e tona, kushte ma të mira për jetesë. Aty fillunë edhe, "Lironi shokët", "Burgjet të lirohen", "Kosova..." pastaj filloi ajo parulla, ka fillu edhe ma herët po aty që iu dha për shembull, "Lironi shokët", "Ja vdekjem ja liri", "Kosova punon, Beogradi ndërton", pastaj, "Kosova Republikë, ja me hatër... kushtetutë..."

**Anita Susuri:** "Ja me hatër, ja me luftë".

**Teuta Bekteshi:** Ja, "Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë". Aty fillunë ato. Policia aty kanë reagu aq keq me kësi me gazlotsjellës. Bile shoku im ka qenë në atë kohë ishte në Prishtinë edhe në atë përpjetën ku hyp te Menza e Studentëve, u konë si përpjetë nifarë bregu. Mua më kapi shumë keq se më hyu gazi shumë. Burri im kish kry ushtrinë dhe e dinte se çka do të thotë gazi. Unë s'kisha provu asnjëherë bash gaz me m'hy në hund. Ai tha, "Nuk munësh me lëvizë", se ishte shumë e ranë, me kollitje, me teshtitje, me zanje fryme me krejt. Edhe aty masanej jemi shpërnda naltë edhe kemi hypë naltë. Më kanë marrë përkrahu burri im edhe ni vajzë tjetër, na çoi neve lartë. Aty pastaj vazhdoi i 26-tit.

Me 1 prill ka qenë pasdite. Ne e dishim se do të bohet me 1 prill edhe e organizum. Erdhën nxanësit e shkollave të mesme, i organizum që me ardhë në konvikt. Studentët pi konviktit... pasdite u konë atë

ditë. Nuk di çfarë dite u konë kështu, çfarë dite e javës ka qenë nuk më kujtohet, nuk më kujtohet. Veç ne jemi organizu. Na kemi qenë radhët e para t'u u lshu prej studentëve, prej konviktit të studentëve me u lshu poshtë për me shku atje te Fakulteti Teknik i vjetër. Pastaj për me shku një pjesë kah Fakulteti Filozofik atyne rrugicave me u lshu për qytet, pjesa tjetër me shku kah ajo ku osht' edhe Komiteti Komunal përpara ka qenë, s'e di edhe tash mendoj që është. Jo parlamenti nuk osht', po çfarë është tashti aty? Është përsëri diçka. Atëherë ka qenë Komiteti, qaty rrishin kta pushteti, përfaqësuesit e pushtetit.

Ne kemi fillu radhët e para po kemi qenë shumë pak në fillim, domethënë ka qenë ni rresht ose dy. Po kështu t'u shku m'u mbledhë atje poshtë. Kur kanë fillu m'u mbledhë atje poshtë osht' alarmu policia dhe ka ardhë ka bo barrikadë. Ka dalë krejt përpara aty bash te ajo që është rruga për përpjetë shkon ni rrugë, domethënë rruga drejt, te Hotel, qysh po i thojnë...

**Anita Susuri:** Swiss Diamond ndoshta?

**Teuta Bekteshi:** Ma naltë. Jo bre Fakulteti Teknik i vjetër është qitu në udhëkryq, qitu filozofiku, ajo rrugica, qitu filozofi ka qenë. Qitu ka qenë Fakulteti Teknik. Ktu është një rrugicë përpjetë që të çon në Lagjën e Muhaxherëve, në atë pjesën aty. Pjesa poshtë që të çon për qytet. Rruga kryesore po i ka dy ndamje kësisoj. Po tash është ndërtu aty dhe tash...

**Anita Susuri:** Te Ministria e Arsimit.

**Teuta Bekteshi:** Nuk e di tashti çka ka aty. Ka qenë Fakulteti Teknik në atë kohë...

**Anita Susuri:** Po qaty.

**Teuta Bekteshi:** Poshtë ka qenë Fakulteti Filozofik, Ekonomik dhe ka qenë ni kioskë që shitke libra. Bile ka qenë ni kumanovar që shitke libra në atë kohë aty dhe i qitke përjashtë e ka pasë nifarë tavolinë dhe aty ka pasë edhe flamuj në atë... flamuj jugosllavë ka qenë aty, se e majke ai se ishin rregulla atëherë kësisoj sa i përket çashtjes së flamurit. Dhe aty janë dalë, aty u mblidh masa domethënë. Kanë ardhë krejt prej konvikteve. Ma së pari kanë ardhë krejt prej pjesës së sipërme prej konvikteve. Aty pasdita, ora 5:00-6:00 ka qenë, s'pe di. Aty fillunë problemi kryesor, aty u bo se u bo barrikadë prej policëve. Aty fillunë brohoritjet, "Kosova Republikë", "Ja vdekje, ja liri", "Republikë, Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë". Domethënë thirrje të mëdha. Masa t'u u mbledhë.

Aty kanë fillu xhirimet e para, për shembull, që i kanë arrestu masanej shumë studentë aty. Se aty prej asaj shpije ma naltë, aty ka qenë ni ndërtesë tjetër dhe i kanë bo xhirimet. Ndoshta te Fakulteti Teknik kanë bo xhirimet, ne atë nuk e kemi përcjellë ni gja të tillë. Bile, më kujtohet studentë, ka qenë e jashtëzakonshme, ka qenë ni entuziasëm, ka qenë diçka që nuk përshkruhet. Aq më tepër kur i sheh njerëzit, masa që të grumbullohet, se masa të përpinë. Zakonisht ti bohesh pjesë e masës. Në masë ti

je i fortë, je i fuqishëm, në masë je gjithçka në masë se je masë. Vetëm është vështirë por kur je në masë gjithçka më nuk ke frikë.

Kanë ardhë... bile edhe vëllai... kanë qenë studentët e Kumanovës, kanë qenë nja shokë nja tetë shokë kanë qenë gjeneratë shumë e suksesshme në atë kohë të Fakultetin Ekonomik e dikush arqitekturë. Ata me vëllain i kom pa t'u ardhë edhe u gëzova shumë kur i pashë, se unë s'e thirra vëllain tem por i pashë ata të ri, të bukur, të mdhej krejt ju bashkangjitën masës. Masnej, kemi ça kordonin na të policisë aty dhe një pjesë ka shku kah Fakulteti Filozofik për me ardhë në qendër, pjesa tjetër ka ra qatyne rrugicave. Masa tjera kanë ardhë prej rrugës ku është parlamenti, tash ku është qyteti. Punëtorë kanë ardhë prej Ramiz Sadikut. Domethënë të gjitha antë i ke pasë masë.

Ti nuk munësh me marrë me mend aq ka qenë e ngjeshun, aq ka qenë entuziazëm, nuk ke pasë... ke pasë pleq, ke pasë të ri, ke pasë gra, ke pasë, po du me thanë, ke pasë vajza, ke pasë fëmi, ke pasë meshkuj. Çka të them, ke pasë në tona antë. Qaq u konë e tendosun, si për shembull, kur është ngritë [Hydajet Hyseni](#) në atë që është në fund gati të asaj shëtitores që sot e ka Prishtina, qaty te heroi Zahir Pajaziti pak ma, jo pa mri, domethënë kanë qenë pentë siç janë edhe sot. Kur janë ngritë aty ne kemi qenë shumë afër dhe ni shoqe jona hypi në dru edhe shoqja jonë e grupit hypi, Remzije Limani edhe ajo hypi në dru. Qaty në qat' dru.

Ish problemi se derisa u thirrën kërkesat që i boni Hydajeti, a din, i veshun, i maskum e krejt. Po ka qenë problemi ka qenë shumë serioz, se qaq kanë qenë të ngjeshuna masat sa ka qenë qishtu {bashkon dy duartë} njëni pas tjetrit. Kur kanë fillu me qitë lotësjetllës tash masa qysh ka, për shkak që ka kap atë pjesë ma së pari, të parët ata kanë fillu me pasë probleme serioze. Nuk ke pasë ti mundësi, nuk ke pasë ti m'u kthy, po u shty masa. Ka, mu më nxuni, mu më rrxoi. U rrxova unë, se masa më shty. Ti nuk kishe kah mahësh, se ai iki pas teje.

Unë kom ra për toke në asfalt, domethënë, vëllai im përmi mu. Teuta për toke se kemi qenë aty bashkë edhe mu m'u nxu fryma. Teuta tha, "Mu më ra një njeri shumë i madh përmi", tha, "unë s'mujsha as me marrë frymë përfundi". Edhe vëllai im përmbi aty kur jemi çu na tash që u shpërnda masa, kur jemi ngritë aty, aty ma ishte brohorimë, kërkesat ishin, dolën në pah. Dhe kur jemi ngritë aty, vëllai im e zuri, ai përmi mu po e zuri gazi lotësjetllës dhe ne na nxuni aty. U shpërndanë. Ne mbetëm se nuk kem ba asni hap. Fryma iu nxu edhe na çka me bo tani s'mujtëm me ikë me kohë, se na nxunë poshtë edhe na kemi shku kah Sekretariati i Punëve të Brendshme. U konë nifarë rrugice aty poshtë janë konë disa banesa, ku kanë qenë përpara Armata, ni shpi, e aty mas me hy me ni banesë m'u mshefë.

Kemi hy në atë banesën m'u mshefë, kemi shku të gjitha katet me radhë, kërkush derën s'na ka çelë. Mbetëm na në shkallë, nja dhetë veta, dhetë, dymbëdhetë veta mbetëm në shkallë. "Ku me shku?" Na nxunë derën policia poshtë. "Dilni", po thonë, "dilni!" Na mo e ditëm që na të arrestum na krejt qitashti se s'kish. Na durtë në kokë që mos të na mshojnë nga koka, se knej po na mshojnë se po na mshojnë

po barëm me mbrojtë kokën. Dhe ka qenë ai shqiptari, komandiri sigurisht ka qenë ai. Ai veç na ka bo neve, “Shpejt”, tha, “ikni. Ikni largonu prej ktu!” Na s’e pritëm se na tham na arrestunë krejt. Ai tha, “Shpejt!”

Na vrapim e do andej, do këndej. Kah jemi kthyer me dalë naltë, domethënë rrugëve aty kryesore që është prej menzës, rrugës kryesore që është tashti. Rruga, a këpuca, a patika, a sende të qituna qysh kanë ikë njerëzit edhe na u kthym masanej kadaldale. Deshta me thanë që ajo ishte... e nesërmja ishte 2 prilli që vazhdojshin demonstratat. Domethënë, na u çumë herët edhe e dijsim se aty do të ketë demonstrata patjetër. Ka pasë fëmi ajo Lagjja e Muhaxherëve edhe e Aktashit. Kanë pasë shumë fëmi, ka pasë si gjithmonë te na që ka fëmi, ka rini shumë. Fëmitë, unë i njihsha shumë fëmi prej atyne se vëllai im mirrej me shkrime edhe libra dhe me fëmi ju kishte dhanë libra, kish hi nëpër familje për t’i njoftë dhe kishte njoftë edhe fëmi. Fëmive ju jipsha libra për të lexu, lektyra e sene. Po ata fëmitë më dojshin shumë, ka pasë plot fmi.

Ata të nesërmen, merre ti me mend, janë organizu fëmitë, se fmi. Qaq entuziast edhe fëmitë. Ne kemi dalë, jemi zbritë poshtë në ora 9:00 e mëngjesit. Kur Naimja ishte me mu, shoqja ime, na kemi zbritë te Fakulteti Teknik. Te Fakulteti Teknik është përsëri ajo hapësira si me bari ka qenë te Fakulteti Teknik edhe ne kemi fillu aty me brohoritë përsëri. Pjesët e tjera, tjera pjesë. Po ka qenë qendra përsëri të njejtin vend ku ishim mbledhë ni ditë ma përpara. Edhe kanë fillu me bërtitë, “Kosova Republikë”, e të gjitha ato kërkesat që kishim. T’u ardhë turma, t’u plotësu, t’u plotësu, t’u plotësu, t’u ardhë turmat t’u u shumu. Merre ti me mend qaq ka qenë interesant se Fakulteti i Mjekësisë me ndihmës të shpejtë kta që janë veturat e ndihmës së shpejtë, si vetura...

**Anita Susuri:** Auto-ambulancat.

**Teuta Bekteshi:** Po, auto-ambulancat kanë ardhën me pa a ka për me intervenu. Qaq ka qenë i organizum domethënë edhe spitali. E pamundshme çfarë organizimi. Ata e kanë ba... ka pasë edhe brenda tyre. Po njerëzit kanë qenë të gatshëm, domethënë edhe me ba, me ba gjithçka, me ba gjithçka. Bile, aty më kujtohet, kemi fillu me këndu. E kam pasë shumë dëshirë edhe sot e kam dëshirë, “Kur na ra Kushtrimi në Kosovë”, edhe e kemi këndu. Atë gjithmonë e kam këndu se e kam dashtë shumë atë kangë edhe sot e këndo. Edhe sot në dasma e gjithkund këtë kangë e kërkoj me ma këndu se e du shumë. Ne kemi fillu me këndu, “Kur na ra Kushtrimi në Kosovë”. Edhe në atë kohë kanë fillu me ardhë ushtria, domethënë këtë rrugën kryesore që vjen, këtë rrugën kryesore që po të thom une ku jemi mbledhë na te fakulteti, qajo rruga që lshohet drejtë, te konvikti rruga kryesore që është.

**Anita Susuri:** Po.

**Teuta Bekteshi:** Te konviktet teposhtë që lshohesh edhe sot është edhe tash veç ish zgjanu edhe ma tepër. Kemi fillu na i kemi pa që po vijnë ushtri, domethënë ato, ato veturat e ushtrisë, ato janë konë ma të vogla do, s’e di si ju thojshin atyne. Me, të ushtrisë. Jo tansket, tansket ma vonë erdhën. Po

fillunë kto ma së pari me ushtarakët me ato, s'e di si i thojnë atyne, e kanë ni emër edhe ato po s'e di si thirreshin ato, si kombe të vogla po e di që janë përmas që i kanë veç dy veta edhe nja dy përpara...

**Anita Susuri:** Po, po. Si të blindume janë ato.

**Teuta Bekteshi:** Po si të blindume. Atëherë nuk kanë qenë ndoshta të blindume. Po aty kur ka ardhë e para që na tham ushtria po hyn. Edhe ishte situata shumë e randume domethënë u blloku krejt Prishtina, domethënë në të gjitha antë ka pasën edhe ushtria veç hyni. Aty e para herë para tanskeve, domethënë kanë kërkitën, kanë gjujtën, unë vet e kom pa. Domethënë, ka dalë ushtaraku prej, e ka çelë dritarën edhe kanë gjujtë. Në atë kohë ne kemi qenë shumë afër, se aty është afër. Para meje ka pasë kemi qenë krejt grumbull. Ni djalë e kapi plumbi në kamë. Bash këtë vend e kapi plumbi. Na çka me bo tash që e kapi plumbi. Unë me mjekësi isha pak me e bo atë lidhjen përmbi mos me pasë gjakderdhje. Kemi marrë këtë djalin na për me çu në spital.

Po aty kanë qenë disa shtëpi që ka pasë serbë. E kemi hi te ni shpi e kish pasë kerrin ai edhe na po hyjmë po i thojmë të na jep kerrin, ai me kerr të na nimoj me çu këtë djalin. Kush po pranon ata me çu këtë djalin. Na aty u përllam me ata pse mos me marrë. E morën ata do studentë tjerë e gjetën ni kerr edhe e morën e çunë, e çunë ata se na nuk... unë nuk shkova atje se na u dashke me vazhdu me protestën. Po du me thanë, aty filloi ajo. Aty ka zgjatë shumë kohë sepse aty pastaj ndërhyjnë. Rruga kryesore u bo me njerëz, ndërhyjnë njerëzit, tankset fillunë me ardhë, hypën përmbi tankse e pastaj u nis tanksa. Mendum që po e shkelë tanksi edhe aty u bonë dy vrasjet e para të... ndodhi vëllai i Mehmet Hajrizit u vra edhe pastaj filloi shpërndarja.

Pastaj fillunë me na detektu neve nëpër rrugica t'u na nalën këta të UDB-së t'u na ndalë e t'u na identifiku. Veç ajo atë ditë u shpërnda. Pastaj shkum te Menza e Studentëve ishte grupi tjetër ato kombet që i lshojshin prej lart poshtë, krejtësisht deri poshtë kanë shku komplet. Edhe aty ndodhën vrasjet e para prej aty, shpijes të atij serbit që prej naltë gjujti ai dhe i vrau studentat. Ka vazhdu atë ditë deri në mramje ka vazhdu protesta domethënë. Po flas me të 1-shin [prill] ka qenë masdite edhe ka vazhdu deri vonë a me të 2-in prej mëngjesit ka qenë protesta. Atëherë u blindum, u bo orë policore, u bo, u bo situata shumë e randë. Me 3-in masanej ne inicum përsëri me bo ni protestë po ishte shumë vështirë për të vepru se ma u blloku gjithçka. Domethënë, policia në të gjitha antë, çdo lëvizje ata e ndalojshin, çdo lëvizje e ndalojshin.

Pastaj vazhdum edhe masanej ka vazhdu edhe në forma tjera. Por demonstratat e vitit 1981 janë kanë qenë të jashtëzakonshme, kanë qenë të jashtëzakonshme. Ni përmasë qaq e madhe e masës domethënë me t'u bashkangjitë ajo ka qenë veç kur ta pshtetë për muri se përndryshe sensibilizim i tillë është i vështirë që bëhet. Nuk di që mund të bëhet ndonjëherë një mobilizim i tillë dhe pjesëmarrje, pjesëmarrje. Por Prishtinës, e ka favorizu Prishtinën se ka pasë shumë, shumë moshë rinore. Domethënë, ka pasë studentë, e ka pasë atë elitën, ka pasë njerëz ma aktivë, se të ritë, unë jom e sigurtë se rinia gjithmonë i bon ndryshimet.



Gjithmonë i bon rinia, se rinia nuk njeh frikë, nuk ndalet, don ndryshme. E moshat pak ma ndryshe, mendojnë pak ma ndryshe. Domethënë, ajo mosha jonë që ka ndihmu shumë. Gjeneratat që kanë pru deri aty, që kanë punu, që ka vazhdu gjenerata jonë e atyne viteve që kanë vazhdu gjeneratat pas vitet tjera megjithë ato vështirësi. Dhe që vazhdon, ka vazhdu me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe sot që vazhdon përsëri rinia është ajo që i bën ndryshimet dhe jom e sigurtë që ajo i bon ndryshimet. Ndryshimet e mëdha them, se ndryshimet e vogla krejt i bëjmë ka pak. Po ndryshimet e mëdha i bëjmë. Atëherë pushteti, pushteti serb ka pasë ni, domethënë, pse janë detektu të ritë, pse janë arrestu të ritë se e ka pa frymën.

Dhe prej femrave ka qenë shumë interesant, se ua kanë pasë frikën shumë femrave. Jo vetëm për aktivitetin e saj, po edhe qëndrimin burgjeve. Se femrat, ti kuptoje, kur një nanë, një femër domethënë vetëdijësohet dhe është e ndërgegjeshme për problematikat për të gjitha aq më tepër për lirinë që asaj vet i mungon, aty nuk mund ta ndalësh më. Unë them që bashkarisht, gjithmonë jom për bashkarisht me veprue, por roli i femrës ka qenë rol i patjetërsueshëm në lëvizjen kombëtare për shlibim. I patjetërsueshëm. Vazhdon të jetë i patjetërsueshëm në ndryshime e të gjitha tjera, se nuk ka përfundu gjanat, ka punë e punë e punë e punë për t'u bërë. Ende nuk jemi të lirë, për shumë gjë nuk jemi të lirë.

Prandaj vazhdon ajo kauzë e lirisë edhe në gjeneratat e reja, por femrat duhet të jenë aktive. Femrat duhet të jenë të gatshme ato të bëjnë vet edhe janë të zonjat të bëjnë vet, por për të qenë aktive, për të pasë ti vullnetarizëm edhe për të ndryshu ti duhesh përgatitje për atë, jo gjithë mund ta bëjnë, jo gjithë mund ta bëjnë. Jo të gjithë janë lindur, jo të gjithë udhëheqin, po ke atë punën ma të madhe e bëjnë ata pas teje. Domethënë, ai rendi, ai rendi i dytë e i tretë po dikush duhet t'i udhëheqë. Jo gjithmonë janë në gjendje me udhëheqë. E di, se aftësinë e udhëheqjes për shembull, por është me rëndësi gjithmonë me pasë njerëz që udhëheqin.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Deshta m'u lidhë me këtë pjesë pas demonstratave, ka qenë koha kur numri ma i madh i të burgosurve politikë ka qenë edhe të rinjëve njëkohësisht edhe kom has shpesh në rrëfime që kjo ka qenë periudhë e vështirë se shumica prej grupeve edhe prej liderave edhe janë arrestu...

**Teuta Bekteshi:** E qartë, e qartë.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë për juve? Sa e vështirë ka qenë?

**Teuta Bekteshi:** Ka qenë, jo ka qenë, po ka qenë ni problem serioz prandaj kemi bo punët shumë konspiracion për shkak se mos me u cënu kjo lëvizja a po kupton? Ai zinxhiri mos me u pre. Se është shumë e damshme të nxinen njerëz që udhëheqin, se masa, thashë, përsëri po të them, ka nevojë për

udhëheqës, ka nevojë për njerëz që i prijnë gjanave. Është shumë problematike dhe shumë e damshme ramja burgjeve. Ne kemi pa, ka qenë ni gja shumë e rëndësishme se ne kemi punu shumë në atë drejtim. Domethënë, nëse jam ra unë, domethënë edhe s’kam dhënë [informacion policisë], domethënë ka vazhdu tjetri. Po ai tjetri ka pasë informacione deri dikë me kë duhej të vazhdoje. Jo për punën e tij, jo për aktivitetet e tij kurgjo po që ky, ky, ky, “Nëse unë arrestohem, vazhdo ti me kta të tjerët”. Pa informacione çka kanë punu ata, për mos me rreziku, a po më kupton? Dhe kanë vazhdu.

Për shembull, Teuta ka vazhdu përsëri me grupin e të rinjëve. Se ajo është arrestu herën e fundit, unë jam arrestu dy herë përpara. Domethënë, te unë s’ka shpëtu kurgjo po ka vazhdu Teuta. Domethënë, jemi mundu ta rujmë atë kontinuitetin e lëvizjes. Po edhe në burg ne kemi punu edhe në burg, se për shembull ti në burg i ke detektu edhe njerëzit. Ata njerëz kanë dalë. Dikush u, për kundërvajtje është dënu s’ka pasë informacione tjera. Ti ke gjetë forma për me vazhdu atë. Domethënë edhe nga burgu kemi punu. Megjithatë është dëmtu shumë lëvizja në atë kohë dhe është dashtë kohë për m’u rimarrë se kanë qenë arrestime jashtëzakonisht të mëdha. Ka pasë lëshime, janë dënu grupe të mëdha.

Jo nuk domethanë që ato grupe kanë qenë gjithë të përgatitun, por që ti mundësitë kanë qenë aq sa kanë mujtë të përgatiten. Dikush ka qenë ma shumë i përgatitun, dikush s’ka mujtë me qëndru. Torturat janë, nuk muj me folë asgjë unë për torturat. Tortura secili mund të flasi, po është e vështirë. Atyne torturave ka qenë shumë e vështirë me ju, me ju me i përballu, shumë e vështirë, shumë, shumë. Me tortura me rrymë, me tortura me futje kokën në ujë, me tortura me ditë të tana me të malltretu. Kamtë, s’ke mujtë me u çu as në kamë, shputat t’u bojshin që s’ke mujtë me lëshu kamën në tokë. Durtë, mos të flasim për durtë, se durtë kanë qenë ma... edhe pasojat çka janë të asaj, me lëndime të veshkave.

Unë kam pasë lëndimin e veshkës, gjakderdhje kam pasë masandej për shkak të lëndimit të ramjes. Bile, po ta tregoj veç ni insert, mu atë ditë më torturunë, jo atë ditë, një nga ditët që isha e torturume shumë. Në mramje unë pata qat’ gjakderdhje dhe isha shumë keq me dhimbje me send. Ato të dhomës i kanë mshu për me më çu në mjek se isha keq. Kur më kanë çu naltë, në katin e dytë nuk ka pasë mjek. Nodnji mjek ka kujdestaru ndonjherë, po nuk ka pasë. Po ka pasë mjek që kanë qenë të burgosun që kanë pasë mjekësinë [të kryer], për vepra tjera jo për... po që i kanë shfrytëzu për shembull kur ka qenë një i smutë, një i burgosur me i trajtu në atë formën sa ka mujtë me trajtu, sa ka pasë mundësi.

Mu më kanë çu atë natë naltë dhe ai, unë s’kam folë asgjë, aq më tepër me njerëz që nuk i njeh. Po nuk kam folë, kam pasë heshtje. Unë gjithmonë kam heshtë se nuk kam guxu. E kam zgjedhë heshtjen se për mu ka shumë, shumë më mirë të heshti, veç t’i them të domosdoshmen sesa të flas. Se jam frikësu që prej fjalëve nxjerrin, e lidhë me njëren, e lidhë me tjetrën. Po unë kam heshtë, gjatë krejt torturave, gjatë krejt arrestimeve unë kam heshtë. Pjesën ma të madhe nuk kam folë. Qashtu kam kalu. Kam kalu çka kam kalu po kam heshtë, nuk kam folë thjeshtë.

Aty kur kam shku, ky e pa gjendjen time të randë edhe tha, “Po duhet”, tha, “me të shpu”. Nji injeksion me ma dhanë se kisha dhimbje shumë. Dhe më ka thënë, “Ulu”, me më shpu domethënë në kukë, inflamuskul me më dhanë. Kur e kam shfaqë unë kukën, atë kukë ai u çu në kamë njeriu. Tha, “Çka të ka ndodhë?” Çka me ndodhë? Ajo mavi ka qenë krejt komplet domethënë. Ti aty edhe me dhanë injeksione ato kapilartë mujnë me shpërthy se ishte një... ai osht’ tmerru njeriu. “Kuku”, tha, “s’ muj me ta dhanë, s’kam qysh”. Edhe më kthynë mu poshtë. U ktheva unë poshtë, domethënë qaq, a din.

Deshta me thanë që ka qenë diçka e jashtëzakonshme. Unë bile kisha dëgju me të tregu të drejtën, kisha lexu dikund që dhija me t’i lëpi kamët qenka ni torturë që nuk munësh me duru kurrë, kisha lexu dikund. Haj more Zot thojsha, po ma bojnë edhe qata, që kisha lexu që është shumë e randë edhe nuk mund thojsha po ma bojnë qata. Thojsha, po e gjejnë po ma bojnë edhe qata, e qatëherë ndoshta tregoj se kisha frikë. Ndoshta qata me ma bo, thojsha ku e di, se po thojnë që është e padurueshme, a po kupton? Ia kom pasë firkën po ku iu ka ra në mend atyne. Kisha lexu dikund pa e di ku lexon. Thojsha veç qata të mos të ma bojnë, se tjerat i kaloj se kisha kalu, e kisha kalu nëpër tortura edhe thojsha e tejkaloj këtë gja, e tejkaloj. Se e kishim shumë randë, seriozisht po them megjithatë...

Edhe çashtjes së kësaj të dhunës seksuale po nejse unë personalisht kam shpëtu nga ajo, nuk muj me folë ma andej se nuk di çka ka ndodhë. Ndoshta do të ketë edhe ndonjë rast që ka ndodhë edhe ajo. Por unë po flas për vetën time që nuk, barëm qata. Tana tjerat të zezat, po edhe aty s’kisha bo lëshime po them shpesh herë çka kisha bo me jetën time, a po më kupton? Në atë kuptimin që është ma e randa. Çka deshta me ndërlidhë me atë që më pyte ti, nëse ta dhashë përgjigjen adekuate qysh e kërkove... deshta me thanë që jemi rujtë, jashtëzakonisht kemi pasë kujdes që mos të arrestohemi. Mos të arrestojmë sa të mundemi të mos arrestojmë për shkak të veprimtarisë, për shkak të lëvizjes se hupke, domethënë pësojke shumë.

**Anita Susuri:** Viti ‘83 po më doket ka qenë kur jeni arrestu për herë të parë a?

**Teuta Bekteshi:** Jo, ‘82.

**Anita Susuri:** ‘82.

**Teuta Bekteshi:** Unë jam arrestu në maj ‘82. Domethënë, një muj kam pasën, jam, kam qenë në izolim. Pastaj në tetor të ‘82-shës, me 26 tetor aksionin që kemi bo na në Suharekë me shoqen time Shemsije Elshanin që kemi shkru midis ditës 12:00 ora parollën “Kosova Republikë”, e ka shkrujtë Shemsija. Se ajo e ka pasë shumë shkrimin e bukur dhe e kemi bo me ni banesë që e patëm zanë, e patëm marrë për nja ni muj se ka qenë rrezik. Ajo e ka bo drrasën pastaj për ta ngjitë aty dhe për ta vnu, për ta çu në ndërtesën në Suharekë. Ka qenë banesa e vetme pesë katëshe në Suharekë dhe ka qenë ditë tregu. Na për me bo bujë, ajo ditën e tregut.

Aty pastaj jam arrestu. Kundërvajtje jam në Suharekë. Ata na kanë marrë në Suharekë na kanë, nuk na kanë nuanë në aksion, nuk na kanë nuanë në aksion. Po mu s'më ka njoftë askush, po e kanë njoftë ate kur ka zbritë prej ndërtesës. Unë kam hyp e kam bo këtë, po mu s'më kanë njoftë. Po e kanë njoftë Shemsijen, se kjo e Suharekës edhe Shemsinë e kanë njoftën. Pastaj unë kam shku te ni shtëpi ku e kishim lonë na me u taku, ata s'kishin informacion na çka po bojm, as s'i njifsha unë bash mirë, do i njifsha do s'i njifsha. Kam shku unë deri te ata edhe Shemsija ka ardhë pastaj pas meje, do të thotë e kanë përcjellë. Pastaj, neve na kanë arrestu në atë shtëpi.

Po ka qenë e keqja ma e madhe se jo vetëm na jemi torturu, po janë torturu krejt familja aty. Ato vajza shumë i kanë torturu, a s'kanë pasë ato ide. Ato kanë qenë, kanë shumë të sensibilizume edhe kanë qenë shoqe tona, po nuk kanë qenë në atë aksion. Po janë rrah ato shumë, shumë, a din, pa ditë çka ka ndodhë. Na jemi pastaj, jemi... mu më kanë lonë në Suharekë, atë e kanë çu për Prizren dhe të nesërmen mu mas ni nate që më kanë majtë në Suharekë në atë dhomën mizerje. Është një dhomë aty... ka qenë ni stacion policor në Suharekë, unë kurrë s'kisha hi në stacion policor. Në Suharekë kisha qenë disa herë me atë shoqen time, kam qenë në familje të tyne dhe i kam njoftë mirë Suharekën edhe shoqet e tjera të Suharekës.

Ai stacioni policor ka qenë i vogël në anën e djathtë t'u dalë prej Suharekës, përpara kah hyke te Stacioni i Autobusave edhe ka pasë nifarë ndërtesë si, si përdhe por jo dy katëshe me do kish pasë do shkallë druni. Po në ato shkallë të drunit kish qenë ni dhomë. Ne na torturunë sa na torturunë ma aty, po dikur herë na çojshin poshtë, herë na mirrshin. Ni dhomë pa dritë, pa kurgjo. Ni dhomë e vogël krejt muret kanë qenë, se kur u hapke dera u shifshin muret, se pa dritë. Aty me gjak, me tug, shumë keq ka qenë ajo dhomë. Kurrë s'kam provu dhomë të atillë. Unë kam qenë në arrestime të ndryshme, po dhomë të atillë nuk kam provu në jetën time.

Aty ni derë e drunit bile ka qenë, jo bash, po e drunit. E mbyllshin ata, policët në anën tjetër e kishin atë dhomën e vogël edhe aty më kanë majtë mu natën. Bile ma prunën do bukë, gjoja me hongër do bukë me djathë. Minjë kish pasë plot. Ato minjtë... s'mujsha as me ra se viron, çka të them. Unë kruspull në atë pjesë të natës. Ju thojsha minjëve, nuk më pengojshin minjtë, nuk më pengojshin seriozisht po them thojsha barem kta ta hajnë qat' djathin, barem thojsha, "Ju minjë hani ktë djathë edhe mbaroni ju", (buzëqeshë) se unë nuk kam marrë aty asgja. Të nesërmen masanej, pasdite më kanë çu në gjykatën aty në Suharekë, më kanë dënu dy muj ditë automatikisht edhe më kanë çu për Mitrovicë.

Pastaj, procedura ka vazhdu. Pastaj jam dënu dy vjet bashkë me Shemsijen, në Prizren jemi dënu edhe masanej jam lëshu do të thotë me 26 tetor. Jam arrestu përsëri me 9 nëntor, qat' vjet. Përsëri jemi dënu pastaj nga një vjet me grupin tjetër edhe me grupin, jo me grupin se grupi s'osht' zbulu, po po du me thonë pjesëtarë kështu. Me Teutën edhe me Naimen. Këto janë liru se të ri kanë qenë, të mitur për fat. Na kemi qenë si stupci, s'kanë pasë të dhana kurgjo për kta edhe pse kanë qenë ata shumë aktivë. Unë e Teuta jemi dënu nga një vjet burg. Domethënë, hera e tretë që isha dënume. Hera e tretë, po tre

herë me, me arrestime dhe me... kjo periudha hetimore ka qenë shumë e randë, se pastaj mbajtja e burgut, po periudha hetimore ka qenë shumë e randë.

**Anita Susuri:** Në periudhën hetimore nuk ka pasë kështu vizita prej familjes ose diçka?

**Teuta Bekteshi:** Jo. Në Mitrovicë... në periudhën hetimore jo. Në Mitrovicë ke pasë të drejtë, kanë ardhë prindtë kanë mujtë me ardhë niherë në mujt. Po vizitat kanë qenë të atilla që ke pasë me grila, me hekura do të thotë, veç e ke pa pjesë pjesë fytyrën. Atë me marrë leje prej gjykatës me ta dhënë lejën ata edhe me ardhë njëherë në mujt, ka pasë të drejtë me ardhën të shpisë me të pru diçka që ka leju burgu. Për shembull, ndonjë bukë diçka që ka leju, ndonjë pite. Diçka lejojshin, diçka s'lejojshin. Kishin sene që i kontrollojshin e nuk lejojshin. A në Burg të Lipjanit që është burg korrektues, Burgu i Lipjanit është burg korrektues. Në fakt, në fakt, në Burg të Lipjanit është niherë në mujt se në burg hetues është 15 ditë. Po, 15 ditë nuk... domethonë që ti mund të lanë ty me dalë [në vizitë], mund me t'i pru vetëm rrobet edhe ti me ia kthy të pa lamet. Domethënë, aty është e drejtë e atyne a të lejojnë me pa apo nuk të lejojnë me pa, me i taku [familjarët]. Aty ka qenë ni minut, as ni minut, domethënë kanë qenë shumë të shkurta vizitat. E në burgje korrektuese kanë qenë ma të gjata pak vizitat. Vizitat kanë qenë të tilla. Po ka qenë ni periudhë kur ka qenën, kur ka qenën ai monstrumi ka qenë drejtor...

**Anita Susuri:** Sherafedin...

**Teuta Bekteshi:** Sherafedin Ajeti. Paramendo Sherafedin Ajeti e ka ndalu në atë kohë kur kemi qenë na, se në atë kohë kemi qenë edhe në vetmi na. Patëm organizu kur e patën vra Nuhi Berishën edhe këtë heroin edhe Rexhep Malën, na patëm organizu protestë. Se gazetatat nuk na prunë edhe ne patëm reagu pse s'po na i bijnë në dhomë. Edhe organizum na dhoma jonë, me [Hava Shalën](#) isha në dhomë. Na protestum mos me marrë ushqimin, hapëm grevën e urisë. E ata na çunë në vetmi neve. Po deshta me thanë në atë kohë u konë... ka qenë ky drejtor. E pat' ndalu edhe limanin brenda me hy, paramendo. Limanin nuk ka leju me hy brenda në burg. Për arsye se limani është i fortë, rritë imunitetin edhe limonin na s'kemi pastë të drejtë familjet tona limon me na pru, se i ka ndalu rreptësisht. Qato ekstreme kanë shku, kanë shkue. Mos të flas për ushqim që ka qenë mizerie ajo e send, ujë e send.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë komunikimi në mes juve që thatë...

**Teuta Bekteshi:** Në burg? Aha. Komunikimi në burg hetues ndryshon me komunikimin në burg korrektues. Në burg korrektues është ni liri pak ma e madhe e komunikimit se mund të lejon, të burgosurat kanë qenë me ni pavijon edhe ti ke mujtë me komuniku. Kanë hy në dhoma. Kanë qenë në çelës po kanë qenë... kanë komuniku mes vete. E kanë pasë ni punëtori të rrobaqepësisë, aty kemi shku. Po në burg hetues nuk ki shanca se je në çelës vazhdimisht. Në burg hetues, dhomat e burgut që janë mizerie, Burgu i Mitrovicës ka qenë ni mizerie, ni burg që nuk e di a ekziston dikund si Burgu i Mitrovicës.

Në atë kohë ti ke pasë, për shembull, tualetin, ni tualet që ke pasën. Ai tualet në dhomë e ke pasë ni kantë ku i ke kry nevojat elementare fiziologjike. Na kemi protestu, ka qenë nevoja, për shembull, ni nevojë tjetër për me na çu në tualet. Ndoshta të ka çu, ndoshta s'të ka çu. Domethënë, e ke pasë në dhomë, ni hapësirë të ngushtë pa ajër pa kurgjë, me dritë vazhdimisht. Ti je sjellë qaty. Ne çka kemi bo? Tashti burgu të mëson, se përvoja të mëson si ta bësh, se duhet të kesh kujdes ku, qysh. Për mu ka qenë shumë e lehtë se unë kam qenë tri herë edhe më i kam ditë lëvizjet kur. Nga gjonat vazhdimisht kanë rujtë, po ka pasë ni periudhë kur ndonjëna ka dalë dhe na i kemi ditë hapat, dera kur mbyllet, kur hapet, kur hyn.

Nëpër ato vrimat i kqyrshim të dhomave. Kur shkon atje në dhomën e vet dhe i kemi ditë kur dalim ato. I kemi shfrytëzu kto raste kur ato nuk kanë qenë për ni kohë të shkurtë aty. Atëherë ne kemi komunikim me mur, të parën dorë kemi komunikim me mur {mbledh dorën në formë grushti}. E kemi pasë atë, “Republikë, Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë” {demostron goditjen me grusht} me ramje. Na e kemi ditë menjëherë se në dhomën tjetër mund të jetë... megjithëse i patëm sensibilizu edhe ato tjerat për vrasje. Po e kemi ditë që diçka edhe në dhomën tjetër. Kanë arrestu se e dishim na se hapat, këpucat i shihshim kur na qitshin ndonjëherë në, na qitshin në shëtitore kaniherë ka dy-tre minuta dhe i shihshim këpucet që janë, ka këpucë tjera dhe e dijsim që kanë arrestu dikënd, se ndryshe ti s'kishe qysh.

I gjejshim ato mjetet, i mshojshim murit edhe hypshim në ato dyrtë e hekurit, se kanë qenë shumë naltë xhamat e hapne. Se koridori ka qenë pastaj dhe pastaj muri tjetër me xhama që rrrishin të hapun me na hi ajri neve domethënë. Prej ajrit të këtij muri, ktu koridori, ktu dhoma me hi ti në dhomën tane ajri, që s'kish shansa me të hi ajri. Për Burg të Mitrovicës po flas këtë. Ne e thirrshim, i mshojshim {demostron grushtin me duar}, “Kënd e kanë pru?” A din, “A ka dikush ktu që e kanë pru?” Dhe ajo kish me thanë për shembull që kish pak ma shumë përvojë, se s'guxojke me folë ajo, i rujshim ato të rejat që vishin. “Po e kanë pru nja”. “Prej kahit është?” A po kupton? Shumica e të rejave, na e dishim se të rejat s'kishin për çka tjetër të jenë.

I thojshim, “A ju kanë pru ma shumë veta, a ju kanë pru ma pak, a vetëm ti? Atëherë, qendro”. Kishin me pytë diçka, “Mos folni”. E kishim atë të parën, “Mos flisni, kujdes mos flisni, as në dhomë mos flisni”, se kishte për vrasje dikush mujke me ia përcjellë se kishin fut edhe nëpër dhoma, “Asgjë mos flisni as në dhomë”. Qashtu e kemi bo na komunikimin. Komunikimin, për shembull që ka ardhë një e re me kangë i kemi bo komunikimin. Për shembull, tash i riu, thashë që i riu nuk sheh rreziqe. Mu herën e parë kur më kanë çu në izolim, kanga sapo u pritë e Azem Galicës, kanga e Shotë Galicës këndohej. Kjo për demonstrata këndo, por kjo për Shotë Galicën ishte shumë e fortë në atë kohë edhe unë e mësova.

Ajo gjysha ime gjithë donte me mësu nga një kangë kur shkojsha me ia këndu. Unë atë natë u torturova në 2:00 të natës deri në 4:00, derisa më prunën në Mitrovicë. Unë prej, prej shkak komucionit që më rrehën shumë atë ditë, domethënë fytyrës, unë fillova me vjellë. Kokëdhimbje kisha shumë të

forta edhe fillova me vjellë. S'isha në gjendje unë. Më çunë me një dhomë 3-sh, i thojshim, ajo dhoma ma e madhe. Nuk e njifsha kërkond, s'pari herë në burg u futa unë. Tashti thojshin për vrasje ka ktu, e din si është burgu. Ajo gruja, njëna për vrasje, e re, edhe ajo ishte për vrasje edhe ajo tha, i thashë, "Kokëdhimbje", edhe ajo ju ka mshu dyrve. Tha, "Po i dhem shumë koka edhe po vjellë", edhe ata ma prunën ni tabletë. Paramendo, ti mujshe me pi kumeditë çfarë tablete po njeri kur ka dhimbje të forta edhe nuk zgjedhë tabletë.

Unë e pijta tabletën po kisha shumë dhimbje edhe shumë më ndihmoi ajo. Diqysh, më pritën shumë mirë në dhomë, a din diqysh shumë... e panë si e re, studente. E dishin që studentet... të nesërmen në 5:00 të mëngjesit, ishte se ishte maji, domethënë u dashke me u çu në 5:00 të mëngjesit se dimrit çoheshe në 6:00 të mëngjesit, bijke buria. Ama, në verë në 5:00 të mëngjesit na çojshin prej gjumit, për hiç kurgjo. Në 5:00 të mëngjesit ti u dashke me u çu me u bo gati, me shku m'i la sytë. Me të çu ata, me ta çelë derën me çelës, me të çu në tualet me të kthy me çelës apet ti me ardhën në dhomë.

Unë thashë, qysh t'ju tregoj ktyne që jom ktu. Unë e kom këndu të Shotë Galicës kangën, sa kam pasë fuqi. Po ka qenë problemi se unë sa kam fillu me këndu kangën e Shotë Galicës, u ni. Gardianët e kanë [ndëgju] edhe kanë vrapu menjëherë te dera se e kanë ditë se dikush i ri, se s'u lejojke as kanga. Po kur kanë ardhë ato e kanë çelë derën po ka qenë, ka qenë fati që dhoma ka qenë e gjatë e dera ka qenë qaty e krevat knej. Diqysh s'e kishte qasjen meniherë me të pa gardieni, si do dhoma tjera që krejt qasjen e kishe të dhomës. Ktu nuk e shifke ni pjesë të dhomës. Kjo u ngrit, kjo, qikjo për vrasje edhe ajo tha, "Kush këndoi?" Kjo, se dhoma, "Qajo këndojke", "Jo", tha, "kërkush s'ka këndu", tha. Tha, "Qysh s'ka këndu", tha, "prej jush doli zani. Kush këndoi?" Unë sapo shkova qat' natë. Tha, "Jo", tha, "gabim e keni se kërkush s'ka këndu", edhe ato asnjëra s'tregunë.

Unë kalova mirë domethënë pa ndonjë, pa ndonjë problem në atë rast. Po e kemi bo komunikimin edhe me këtë gjë. Kur ka ardhë ni e re ka këndu diçka ose ka thanë ni formë ose diçka që ka pasë aftësi të sajën. Derisa ka ardhë ta dijë ku është edhe a ka të burgosura, kush është aty ose edhe ndonjë shoqe e saj mos është edhe ajo e arrestume edhe në këtë formë e kemi bo na komunikimet. Sidomos kur s'kanë qenë ato me rrahje. Pastaj qita me folë, "Kini kujdes, kini kujdes që po vjen qikjo gardiene, në këtë kohë kjo është, kjo është ma e rrezikshme". Kështu që, në këtë formë e kemi bërë. Edhe komunikimin e kemi bo domethënë letrave, jo na. Zakonisht na s'kemi guxu se e kanë kontrollu çdo sen në banjo.

Për shembull, kur kemi dalë në shëtitore kanë qenë naltë meshkujt, domethënë katin e dytë edhe ka pasë edhe në podrum kanë qenë meshkuj. Na kemi qenë ni pavion, ni pjesë të pavionit, katër dhoma kanë qenë në katin e parë. Ata na çojshin në shëtitore. Na durtë përmas, po polici naltë me armë rujke. Qysh osht' [burgu i] Mitrovica është rreth edhe është e ndame në katër pjesë është e ndame shëtitorja. Një shëtitore ku ne shëtitshim ktu, shëtitorja tjetër e të burgosurve tjerë dhe dy andej. Domethënë, secili dy shëtitore na ishim, dy shëtitore të burgosurit për vrasje. Po qikjo shëtitorja jonë i kishte dy dalje. Domethënë, njëna për atë tjetrën sikur hapësirë, sikur kur e ndame në katër pjesë.

Aty kemi komunikuar me të burgosur tjetër politikë. Aty na kanë gjujtë ndonjë poezi, ndonjë send. E na mos me na pa ata naltë, kaniherë kemi mujtë me marrë me kamë ndonjëra që kemi pasë të shkuar e kemi ruajtë për me kapë atë letrën. Kaniherë na kanë gjetë, na kanë nxanë, s'na kanë zanë po e kanë kuptu që ne morëm diçka. Diçka kemi bo, e kemi asgjësuar që mos me u gjetë në asni mënyrë edhe kemi këndu. Domethënë, në situata të ndryshme për festa të ndryshme. Na kemi fillu, ata prej naltë na kanë kthy, na kanë kthy brenda. Por kryesore na diçka kemi... në një formë apo në një tjetër, për shembull m'u ditë se ku janë të burgosurit politikë, se zakonisht ata gjithmonë, gjithmonë janë lajmëru kur kanë ndodhë do gjana. Për me ditë se ka edhe naltë, ka edhe të tjerë, kështu që për mos me ndi vetën asniherë vetëm. Domethënë, kjo që ka qenë shumë e rëndësishme për neve.

**Anita Susuri:** Burgosjen e parë qysh ka qenë gjykimi yt? A jeni dënu si grup me dikun apo?

**Teuta Bekteshi:** Jo. Po mendon të parën herë?

**Anita Susuri:** Po.

**Teuta Bekteshi:** Kam qenë në izolim, izolimi nuk...

**Anita Susuri:** Vetëm izolim?

**Teuta Bekteshi:** Jo, izolimi është një muj ditë. Izolim. Të merr, për ditë më kanë marrë mu në pytje, kanë pasë të dhanuna edhe ktu, është e vërtetë. Unë hera e parë as s'më kanë njoftë bile, po kanë pasë të dhanuna, po unë s'kam pranuar asgjë prej të dhanunave. Ata në mungesë të atij mospranimi tim edhe të dhanunave tjera, unë jam liru me kusht. Domethënë, në izolim [kam qenë] nuk jam dënu. Një muj i kam mbajtë veç, po nuk jam dënu. Po ka qenë ajo që në izolim ka qenë, po lëshohet. Masandej, domethënë herën e dytë kur jom arrestu, jam dënu në Gjykatën e Prizrenit bashkë me Shemsije Shalën me nga dy vjet burg edhe ajo edhe unë. Po të dyja nga dy vjet burg...

**Anita Susuri:** Atëherë i keni mbajtë në Lipjan apo? Qat' pjesë apo në...

**Teuta Bekteshi:** Jo, jo krejt hetimet në Mitrovicë. Domethënë, çdo hetim bohet veç në Mitrovicë, është ba. Herën e parë i kam mbajtë një muj ditë në Mitrovicë, herën e dytë i kom mbajtë një gjashtë muj në Mitrovicë, hetimet kanë zgjatë pak si shumë. Herën e tretë e kom mbajtë krejt burgun në Mitrovicë. Domethënë, një vjet e kom mbajtë në Mitrovicë, në burg hetues e kom mbajtë dënimin për arsye se nuk më kanë çu në Burg të Lipjanit se unë po bëj përsëri atje, nuk jom e rehatshme dhe organizoj gratë. Më kanë mbajtë një vjet në burg hetues me dënim.

**Anita Susuri:** Qysh kanë qenë këto gjykimet? Po mendoj, grupet kanë qenë a ka pasë të pranishëm tjerë? A keni pasë avokat? Qysh ka qenë?



**Teuta Bekteshi:** Jo. Hetimet kanë qenë, po faza e hetimeve mo. Ke pasë ti të drejtë me marrë avokat. Ne s’kemi pranë, unë s’kom pranë asniherë avokat. Bile, baba im që ju kam dhimtë shumë e kish pasë nuanë ni avokat edhe unë nuk kisha informacion, po avokati më erdhi në burg. Herën e dytë ka qenë kjo, erdhi në burg edhe ata e lejën takimin me mu, normale se avokat. Më tha, “Kështu, kështu, baba yt më ka caktuar mue për me të mbrojtë”. Thashë, “Baba im është dashtë m’u konsultu me mu, unë nuk kam pse marrë avokat, për çka do të më mbrojtë ti mu? Nuk ki pse me më mbrojtë, s’kam ba asgjë ti me më mbrojtë”, edhe nuk e kam pranë avokatin, e kam kthyer. Ka pasë gjykata, ka vnu avokat të vetin po ajo ka qenë vetëm formë, domethënë ajo ka qenë vetëm për të ekzistuar se gjykimet kanë qenë, gjykimet u ditë si kanë ardhë.

Domethënë, merre ti me mendu në herën e parë jam dënuar, s’jam dënuar po kam majtë... herën e dytë kur jam dënuar dy vjet, pa fakte. Unë s’kam pranë asgjë. Unë s’kam pranë asgjë. Po e pranove, s’e pranove, po ka qenë diçka e dhanun që ti... dhe çka ka qenë arsyetimi i tyre që shkrohet ajo në fund domethënë, “Ne me shopen time”, se kjo e ka mohu në gjykatë. Shemsija ka thanë, “Më kanë detyruar”. Ata e kanë marrë si bazë që na kemi vepruar, pos kësaj që kanë shkruar krejt. Ata që e kishim bo ne e kishim bo, po nuk e kisha pranë. E kanë bo bazë që ne kur i kemi ngre grushtat se ne kemi ato që kemi vepruar vërtetë, se ne i kemi ngre grushtat demok s’kanë çka na bojnë.

Herën e tretë, herën e tretë e kemi pasën përsëri gjykimin në Prishtinë. Herën e tretë ka qenë gjykimi në Prishtinë. Edhe në Prishtinë, ne veç për propagandë. Domethënë, krejt gjykimet nuk na kanë, nuk na kanë mujtë me na nxjerrë grup, se me na pasë nxjerrë si grup atëherë ti 15 vitëshin e kishe pasë minimalen. Por, ne nuk kanë mujtë me na nxjerrë. Po them që grupi jonë kurrë nuk është zbuluar, nuk kanë mujtë me na nxjerrë grup. Po krejt i kemi 133 alinea, domethënë propagandë armiqësore i thojnë kësaj. Unë gjitha rastet jam me këtë propagandë. Edhe i kam shpëtuar ktyne [gjykimeve] grupit edhe që dënimet ishin shumë të randa.

Avokatët e kanë bo atë procedurë të vetën, sa për të qenë aty, përndryshe kurgjo tjetër sen s’kanë pasë rol. Gjykimet kanë qenë krejt të programuar kanë qenë. Është ditë që... janë dënuar njerëzit për hiçgjë. A din, për shembull, ka pasë raste që kemi vepruar, s’e ke pranë po ke vepruar e ke bo atë veprim. Ti s’e ke pranë se me pranë dilshin sene tjera, domethënë me kambëngulje s’e ke pranë se kishin dalë shumë tjera sende që ajo vegza e qet’ tjetrën, e tjetrën edhe masanej kish qenë, kish qenë...

**Anita Susuri:** Po, prandaj pyta se nganjëherë kanë qenë të orkestruar që nuk i kanë takuar atij grupi e kanë bo pjesë të grupit dikond, ka pasë edhe ngjarje të tilla...

**Teuta Bekteshi:** Unë mendoj që, unë mendoj që... shiko, burgjet, hetuesia, unë për vetën time torturat i kanë përdorë. Unë i kam thënë ni inspektor ose ni, qysh t’ju thush ktyne, pyetës, aftësinë e atij unë e kisha vlerësuar vetëm nëse ai kish arritur pa tortura me nxjerrë një mundësi të veprimit. I aftë nëse i lidhë krejt ato mozaiket. Atij i kisha thanë që është vërtetë, se me tortura i kanë detyruar me thanë

njerëzit edhe sene që nuk janë. E kanë detyru njerëzit me pranë diçka që nuk osht' hiç se s'ka mujtë me duru, s'ka mujtë me duru. Ka plot e plot raste të atilla. Domethënë, tortura nuk zgjedhë mjet, nuk zgjedhë mjet. Por, megjithatë them unë që pa pasë të dhanuna pak ndoshta edhe hamendëse të dhanuna që ti, për shembull, kanë bo lëshime në njerëz edhe prej torturës nuk, nuk kanë ka e kapin nëse din me atë se nuk munden, nuk munden, nuk munden.

**Anita Susuri:** Ju më tregutë edhe për torturat me rrymë edhe me ujë...

**Teuta Bekteshi:** Po, po.

**Anita Susuri:** A është përdorë kjo?

**Teuta Bekteshi:** Po është përdorë tortura. Te unë jo. Te unë janë përdorë të gjitha format tjera. Dhunë ma për toke, du të them. Po kjo te unë... është ni gja se, shiko, ata kanë përdorë metoda të ndryshme. Se te personat, për shembull, që kanë pasë të dhanuna që kanë pasë të dhanuna që kanë qenë sidomos te të ritë ata e kanë përdorë forma ma ekstreme, a je t'u më kuptu? Me rrymë e kanë përdorë te Hava, se Hava më ka tregu se në dhomë e kom pasë Havën edhe me kokën në ujë te Hava. Unë jo, mu jo. Mu personalisht këto dy lloj torturash nuk i kom pasë. Të gjitha të tjerat, por këtë torturë me rrymë dhe me ujë jo. Bile, atëherë patën dalë këto detektortë, a din, kto detektorët? E din kur rren e kto...

**Anita Susuri:** Të vërtetën.

**Teuta Bekteshi:** Po, të vërtetën. Ne ushtrojshim se po na e aplikojnë te na me detektor edhe ta majmë atë qetësinë që ti mos me dhanë mundësinë që ti nuk je t'u tregu drejtë. Në atë kohë janë përdorë detektorët edhe në atë kohë janë përdorë detektorët. Dhe janë përdorë të gjitha, po them, të gjitha... po mos të flas për fyerjet, mos të flas për, për senet e tjera, për senet e tjera. Që ti ka ndodhë momente që ke thanë, çka po ndodhë tani? Domethënë, kanë qenë të paparashikueshme situatat, të paparashikueshme situatat.

**Anita Susuri:** Thatë që edhe ni kohë keni qenë bashkë me vëllain e juj në burg, pastaj edhe me Teuta Hadrin. Qysh ka, për vëllaun më tregutë qysh e keni kuptu përmes letrës, po me Teuta Hadrin që është arrestu...

**Teuta Bekteshi:** Jo, vëllau, vëllau ka qenë në Shkup, në Rizovë. Ne kemi pasë një tjetër problem, përpos kësaj ne kemi pasë, kemi pasë një, '81-shin kemi pasë një incident në Shkup, unë me dy vllëzërit e mi. Ka qenë, na udhëtojshim për Prishtinë, kam pasë provim atë ditë. Kemi udhëtu vazhdimisht, çdo dy javë na kemi ardhë në shpi. Gjatë krejt studimeve na një muj asniherë nuk e kemi bo. Njëherë i kam bo edhe jam ndje shumë keq. Kemi ardhë shumë shpesh. Kemi pasë autobusat në

mëngjes. Në 6:00 e kemi pasë autobusin e parë për Prishtinë. Unë u pata feju qat' javë dhe të dillen për me mrrri të hanën kisha provim. Bile, provimin në infektivë e kisha provimin.

Me vëllaun tim dhe me këtë vëllaun tjetër po shkojmë për Prishtinë. Në Shkup kallabllëk i madh për arsye se ni autobus ka qenë ka pasë student e njerëz që kanë udhëtu, po vend s'kishte. Po unë vëllaun, punonte në televizion edhe unë në 8:00 ora nuk mujsha me mrrri provimin në ora 8:00 e kisha. Hypëm ne në autobus, po në autobus nuk kishte vend. Vëllaun po i thotë... ai kondukteri ka qenë vozitësi shqiptar, kondukteri ka qenë serb i Ferizajit. Njëmend që e njëfshim qat' kondukter se qat' relacion kishim udhëtu.

Vëllaun tha, po i thotë vëllaun, "Shiko, na nuk po vijmë. Unë po e humbi punën edhe vëllaun tjetër po merre motrën se ka provim, në kamë le të rrijë për provim", ai tha, "Unë", tha, "s'kom pse me marrë motrën tane", tha, "unë e kam", tha, "njo në shpi, ni gru në shpi", tha, "edhe", tha... vëllaun jem qysh u konë, unë kam qenë poshtë vëllaun jem ka qenë në shkallë edhe vëllaun jem e ka kapë për gjoksi me tërheqë edhe unë poshtë, unë e kam pasë ni ombrellë se binte shi, ishte kohë me shi. Vëllaun jem tjetër ka qenë karatist, ai ka ushtru karate. E ka tërheqë vëllaun jem poshtë edhe vëllaun i jem i ka hi mirë. Po ka qenë shumë e rrezikshme në atë kohë.

Në fakt jo '81-ta se gabova unë, '80-ta, para demonstratave ka ndodhë ky aksident. '80-ta ka qenë. Kur na, kur ramë na poshtë, tashti ky ka alarmu policinë. Krejt janë çu Shkupi, se maqedon, krejt janë çu neve me na sulmu. Kur janë çu krejt me na sulmu neve. Na me vëllaun, vëllavi jem, babi im ka pasë revole me leje në atë kohë. Ky vëllavi jem, unë nuk kam ditë që mban revole me vete, e ka marrë me vete, nuk e disha unë. Vëllavi jem e ka ngre revolën për m'i frikësu që du me gju. Tash kur e ka ngre revolën i ka mshu atij maqedonit, ktij kondukterit. Po revolja i ka dalë prej dorës. Neve na rrethun ata krejt. Ishte problemi neve me na mbyttë krejt, se krejt ajo grupa e maqedonve neve na sulmoi. Po kur e panë armën, ata u shpërndanë.

Kjo ka qenë arsyeja që neve masnej na morën policia. Vëllavi, nuk e lajmërum vëllavin, ky shkoi në Kumanovë me lajmëru prindin tem sepse neve na ndodhi problemi. Mu edhe vëllavin tem [tjetër] na morën policia, na çunë atje. Për taksiratë na majtën deri në 3:00 masdite. Për taksiratë unë e mbajsha ni thikë me vete të vogël. Atë thikën e mbajsha gjithëherë se ka qenë ni lagje dikund banojshim, ka qenë shumë me terr edhe kisha frikë. Ka qenë e ngritshme ndonjëherë. Unë e mbajsha me vete. Kur ma panë thikën, "Pse ti ke thikë?" Thashë, "Jo, kta e mbaj për ndonjë ushqim, për ndonjë send", nejshe neve na lshunë.

Pastaj e dënunë vëllaun tem, përpos tjerave na kapën, e dënunë vëllaun tem dy vjet për këtë. Më dënunë mu gjashtë muj, po me kusht. Vëllavin tem [tjetër] e dënunë tre muj, se vëllavin tem s'e zunë aty. S'e dishin ata që vëllavi jem ka qenë, se s'e njëfshin. Veç neve dyve, domethënë vëllaun jem shpëtoi. Pastaj kur kam ra në burg unë, paramendo e kom pasë edhe këtë veprën tjetër ktu që unë kam qenë edhe ka qenë shumë problematike në atë kohë. Po ka qenë ni Jugosllavi në atë kohë edhe ka qenë

veç... tana vëllavi jem tani osht', probleme tjera i kanë dalë plus. Në Televizion të Prishtinës e patën përjashtu prej Televizionit të Prishtinës e qashtu ka qenë ajo krejt një pjesë tjetër. Po...

Sa i përket Teutës, Teutës normale që e kam ditë që kanë me arrestu Teutën, se Teutën e kanë arrestu të njejtën ditë me mu. Të njejtën ditë me mu e kanë arrestu Teutën. Teutën e kanë arrestu në Gjakovë, mu më kanë arrestu në Kumanovë. Të njejtën ditë edhe unë e kam ditë se Teuta kur kam shku unë, s'e kam ditë unë që po e bijnë Teutën po unë kur kam mrri në burg Teuta ka ardhë mas meje dhe Teuta m'i ka njoftë mu këpucat. E Teuta ka qenë, ni dhomë kemi qenë ngjitë me ni dhomë. Domethënë, dy dhoma të burgut kanë qenë njëna pas tjetrës. Ajo ka qenë atje, unë këtu. Teuta m'i ka pa mu këpucat edhe e ka ditë edhe ajo. Tani ajo më ka dhanë shenjë. Qaty jemi kuptu që edhe ajo edhe unë jemi arrestu. Se as Teuta s'e ka ditë që unë jom arrestu, as unë s'e ka ditë që Teuta është arrestu. E kështu e kemi kuptu në Burg të Mitrovicës që jemi të arrestume te dyjat.

**Anita Susuri:** A keni pasë pastaj komunikim me njëra-tjetrën mrena në burg?

**Teuta Bekteshi:** Me shumë kujdes. Na s'kena pranu me komuniku për këto gjanat. Veç ndonjë send që është dashtë që nuk din, s'ka aty. Ndonjë send që mos me shku ma anej, se s'kanë informacione. Dhe e ka ditë Teuta se gjatë hetimeve, ti e din çfarë informacione kanë ata, se ne kemi qenë që kemi vepru shumë gjatë bashkë, por ata s'kanë pasë informacione për Teutën prej meje. Edhe Teuta ka qëndru në atë kuptim, s'ka dhanë kurgjo, edhe na kemi shpëtu me nga një vjet në fakt në atë kohë.

## Pjesa e Pestë

**Anita Susuri:** Në atë kohë për shkak të ktyne aktiviteteve po edhe kur ka ndodhë ndonjë ekces shpesh herë janë hakmarrë se janë pa si persona jo të përshtatshëm për shtetin edhe shumicës iu është ndalu edhe shkollimi edhe puna, që e përmendet vëllaut. Po qysh ka ndodhë për juve? A e keni vazhdu fakultetin qysh?

**Teuta Bekteshi:** Teuta ka punu në atë kohë dhe Teuta nuk e ka pasë problem, se Gjakova është pak më ndryshe se i mbron diqysh e ka ndaj, ndaj vet gjakovarëve. Por unë kam qenë absolvente e mjekësisë, fati im ka qenë që unë kam qenë absolvente. Shokëve tjerë dhe shoqeve që kanë, që nuk kanë qenë absolventë, domethënë që kanë qenë në vit të katërt atyne iu është ndërpre krejtësisht shkollimi. Po mu më kanë ndihmu që kam qenë absolvent. Domethënë, me vite e kam krye dhe kjo më ka ndihmu mu që mu të mos më ndërprehet krejtësisht fakulteti. Por, ka qenë ni problem serioz se mu më është dashtë, më është dashtë një fakultet i tanë, sikur me kry për me kry një vit të vitit të pestë. Domethënë, m'u kanë deshtë pesë vjet, katër vjet, për me kry unë ni vit, viti i pestë. Për shkak të pengesave që i kom pasë pastaj.

**Anita Susuri:** Prej profesorave apo?

**Teuta Bekteshi:** Jo prej profesorëve. Profesorët nuk kanë mujtë me të... profesorët asnjëherë, ti s'ke mujtë se ti ke qenë e ndjekur vazhdimisht. Mundësia për të shku në Prishtinë, ti vazhdimisht ke qenë e ndjekur. Pastaj unë edhe u martova, pastaj menjëherë e bëm martesën, pastaj fëmijtë. Provimet e mjekësisë janë shumë...

**Anita Susuri:** Në cilin vit keni diplomu pastaj?

**Teuta Bekteshi:** Unë në '90-ën.

**Anita Susuri:** Në '90-ën.

**Teuta Bekteshi:** Po, në '90-ën. Domethënë, m'u ka deshtë bajagi domethënë '82, ndal, '85-shen kam dalë nga burgu, domethënë m'kanë mbajten... '82 jom arrestu, domethënë '85 kam dalë, në nëntor të '85-tes prej burgut. Domethënë, m'u kanë deshtë qaq vjet plus, unë derisa derisa e kam kry. Edhe e kam kry para se me u mbyllë Universiteti i Prishtinës. Po më kanë ndihmu shumë shoktë atje, profesorët atje, se unë e kam pasë shumë vështirë lëvizjen me fëmi. I kam bajtë fëmijtë, më kanë ndihmu me i çu fëmijtë, me i mbajtë në krah. Djalin e madh e kom pasë, po të voglin masanena.

Më kanë ndihmu shumë njerëzit. Prishtinës unë, nuk di, m'duket në çdo derë të Prishtinës kam hy si në shpi time. Më kanë ndihmu sidomos Pllashnikët, familja Pllashniku, Adem Pllashniku, këta janë te Lagjja e Muhaxherëve. Lagjja e Muhaxherëve, dikur konviktet e shkollave të mesme kanë qenë përpara. Ajo ka qenë baza, ka qenë plot baza që kam pasë në Prishtinë, s'ka pasë familje m'doket që s'e kisha gjetë po kta kanë qenë ata që më kanë përmbajtë mue gjatë tanë kohës. Domethënë, kam hy aty natën e kam hy ditën. Po më kanë ndihmu edhe pastaj për fëmijtë edhe për të gjitha.

Po edhe shoktë e mi, po edhe profesori, profesor Ramizi muj me thanë më ka ndihmu, në krejta aspektet më ka ndihmu. Unë në nifarë mënyre e kom pa, e kom kry se ka qenë shumë, shumë e vështirë. Dhe ajo ka vazhdu masanej si person i rrezikshëm edhe si person i papërshtatshëm që unë kam pasë probleme tjera masanej. S'jam pranë në punë, kam pritë me vite për punë. Kur ka fillu privatizimi kom fillu edhe unë të punoj. Edhe sot prej atëherë punoj vetëm. Domethënë, udhëheqi vet.

**Anita Susuri:** Është edhe ni fenomen tjetër që më doket shumë interesant, kur kanë ra nëpër burgje burrat, gratë e tyne ose të fejuarat ose të dashurat i kanë pritë me vite...

**Teuta Bekteshi:** Po.

**Anita Susuri:** Po edhe ju...

**Teuta Bekteshi:** Po edhe mu më ka pritë (qeshë). Është interesant Teuta thotë, shpesh herë Teuta e përmend ku jemi dikund thotë, “Of thoni që s’e kanë pritë”, thotë, “edhe me pritë qysh duhet”, thotë, “qe bre ku e keni”, edhe ne qeshim, “Qe bre ku është Rexhepi”, se burri im e ka emrin Rexhep. “Qe bre ku është Rexhepi, e keni shembullin për pritje”. Ne kemi qenë shumë të lidhur, shumë herët. Bile të ta tregoj një gjë që është interesante, ai është marrë me futboll dhe ka qenë futbollist profesional. Ka lujtë, në atë kohë ka qenë në “Trepçë”. Kur jom arrestu unë në Suharekë, ai ka qenë në “Trepçë”.

Tortura ka qenë shumë edhe për të. Edhe atë e kanë përcjellë. Ka qenë shumë e rrezikshme. Bile kanë ditë edhe ku p’e kërkojnë, në “Liri” të Prizrenit e të gjithë. Gjithë më kanë pytë, shumë më kanë mundu për burrin tim, por te unë ka qenë ajo, blloku ka qenë se në asni mënyrë. Kur s’kanë pasë informacione dhe burri im është detyru për shkak të këtij presioni që vazhdimisht i kanë shku në klub, e kanë përcjellë pastaj u largu prej Mitrovicës edhe u kthy në Kumanovë përsëri. U kthy në Kumanovë me lujtë ktu për Kumanovën.

Në atë kohë, kur jam arrestu unë, qat’ natë... është prishë pak [i referohet drites së studios] qat’ natë që jom arrestu, merre me mend, burri jem erdhi në Prishtinë m’u taku na. Unë u nisa, s’i tregova hiç. Erdhi m’u taku në banesën time me vëllaun, unë shkova për Suharekë. Nuk e ka ditë që jom për Suharekë. Të nesërmen kur kanë ardhë me lajmëru, kanë ardhë në shpi tonë edhe e kanë lajmëru dhe bastisja ka fillu... kur kanë bastisë kanë ardhën, sigurisht i kanë thanë, “Është arrestu”, dikush që na ka njoftë prej shokve tonë që, “është e arrestume në Suharekë edhe është në burg”. Se s’e ka ditë as ai që unë jam në burg, ai në Mitrovicë në “Trepçë”, unë në burg.

E deshta me thanë që tani baba im, po ta them edhe ni gja që ka ndodhë reale. Për shkak se vjehri im e ka pasë ni djalë edhe pesë motra i ka burri im edhe dasma u shty e u vonu. Vjehri im, si ni djalë qysh don e edhe nuk dihet a po dalë prej burgut, na nuk e kemi ditë. Bile unë i pata çu, i pata dërgu një letër msheftas që është i lirë nga ana ime, se nuk dihet jeta ime ma a do të dalë a s’do të dalë 15 vite a. Do të thotë, do të jetë i lirë nga ana ime, ai të zgjedhi për jetën e tij. I pata shkru. Ishte shumë e randë se ti njeriun që e don, por megjithatë i pata shkru se po them se ka qenë prioritet kjo edhe ti i ke lanë krejt anash.

Baba im në atë kohë për shkak të rreziqeve të mëdha që ishin, nuk ka pranë askush të shkoj në shpi ta shofi, të më shofi për mu edhe s’kanë guxu njerëzit me shku. Po dikush ka shku me qëllime të caktume edhe babi im ka thanë, “Nuk më ka vdekë vajza edhe nuk ka nevojë kërkush me ardhë me më pa. E di unë vajza ime pse është në burg edhe për mua e din ajo ma së miri edhe s’ka nevojë kërkush me ardhë me më pa, se s’e kom të vdekun vajzën po e kom gjallë”.

Njerëzit kur kanë dalë kanë ardhë natën msheftas për me pa ata njerëz që kanë qenë atëdhetar natën kanë ardhë me pa se s’kanë guxu ditën për arsye se i arrestojshin. E i ka thënë, i ka thënë baba im ka thënë babës të burrit tim i ka thanë, “Shiko, vajza ime, situata po dihet. Nuk dihet kur do të dali,

si do të dali, si do të jetë e ardhmja e saj nuk e dijmë edhe krejt neve. Por”, thotë, “ti je i lirë me djalin vazhdoni, keni të lirë nuk keni kurnifarë...”

**Anita Susuri:** Obligimi.

**Teuta Bekteshi:** “Obligimi ndaj nesh edhe ndaj vajzës time për shkak të...” edhe i ka thanë baba i vet, ish kthy edhe i ka thanë, ma tregoi edhe vjehri im pastaj, se burri s’më ka tregu po vjehri. Edhe u kthy edhe i ka thanë, “O bir”, ka thanë qishtu qishtu. Po vjehri im ka qenë shumë i mirë edhe shumë ka thanë, “Qishtu bre më thanë, çka po bëjmë? Qishtu më tha baba”, edhe ky ia ka përgjigjë i ka thanë, “Babë, nuk është, nuk ka çka diskutohet kjo çashtje. Jo tre, jo pesë, jo dhjetë, ka përfundu kjo. Unë atë e pres”. Edhe nuk është puna veç me të pritë, po puna forma qysh të pret. Se tashti, po ka qenë vërtetë... dhe unë e falënderoj shumë dhe e kam një mbështetje kam pasë gjithmonë n’jetë.

Ai gjithmonë më ka shty edhe ka qenë... gjithmonë më ka shty, “Këtë munësh me bo ti, ec se ti e din kur duhesh me ba edhe kur s’duhesh me ba”. Tash sot e atë ditë unë e kam këtë mbështetje. Kjo më ka ndihmu shumë. Unë masanej qaj shumë se kejta senet është dashtë m’i bo vet. Me probleme se ktu jam rreziku vazhdimisht, me probleme të hapjes, me probleme të lëvizjes. Lëvizje që unë katër ditë s’kam hy në shpi, po e kam pasë gjithmonë mbështetjen edhe të familjes të burrit tim edhe vjehrrës time që është kujdesë për fëmijtë. Por, unë, nuk jam ndalë asniherë dhe kjo ka qenë... se të kesh një mbështetje sidomos prej bashkëshortit është gjëja e domosdoshme për të lëvizë femra.

**Anita Susuri:** E ju sa keni qenë në burg nuk keni pasë vizita po më duket? Nuk është leju?

**Teuta Bekteshi:** Jo, jo, nuk është leju. Është leju në Mitrovicë njëherë edhe atë s’e kom pa, nuk kemi mujtë me u pa. Në Burg të Lipjanit ke të drejtë, jo, veç familja e ngushtë. Me të ardhë ty i fejumi, kam qenë e fejume në atë kohë, nuk ka mujtë me të vizitu. Po është dashtë m’u martu ti në burg për me ardhë me pasë të drejtën ai me ardhë. Për shembull, Drita Kuqi, ni shoqe jonë, u pat’ martu në burg edhe na e bonëm bile ni lloj dasme i bonëm asaj, e veshëm, e ndreqëm pak, a din, ni fustan të shkurtë se po shkon, po martohet po bëhet në burg që për të pasë mundësi pastaj m’u taku me, me burrin e saj. Po unë nuk e kam pranë atë, nuk kam dashtë, jo.

**Anita Susuri:** Pastaj kur jeni dalë prej burgut jeni martu?

**Teuta Bekteshi:** Pastaj kur kam dalë prej burgut, domethënë kjo i bjen hera e tretë kur kam dalë. Bile, ai s’ka qenë këtu, ka qenë në Zvicërr në atë kohë. U dalë pak me punu, pak me... edhe pas një muji jam, jena martu. Bile motra ime, është shumë interesant me motrën time të madhen se gjithë vijke dasma edhe u arrestosha, gjithë vike dasma edhe... kurqysh m’u martu kjo motra e saj. Edhe tha, “Shiko motra ime”, tha, “veç sonte bre m’u konë, veç sonte të mos marrin. A din, ni natë ta kapërcejsh te burri. Veç sonte. Martohesh edhe sonte”, tha, “e nesër”, tha, “edhe të marrshin”, tha, “nashtë bre

se... po veç sonte mos të marrin”, tha, “edhe kur çohesh në mëngjes motër t’kam veç qita lajmërom që je aty, që s’të kanë arrestu sonte”.

Unë në mëngjes në 5:00 në telefon, “Oj motra ime”, thashë, “këtu jom, se sonte kapërceva” (qeshë), “nuk më arrestunë”. E sot qeshi motra ime, “Veç sonte”, thojke, “mos të marrin”. Dhe kjo, kjo është, është jeta në përgjithësi. Është jeta e të gjitha, që them, femrës, femrës që janë aq me numër të madh. Secila e ka atë historinë e vet, historinë. Po megjithatë në gjithë atë historinë e trishtë, historitë të dhimbshme ka shumë sende, ka jashtëzakonisht sende të mira që i kujton njeriu me kënaqësi. Ne kemi kujtu gjithmonë me kënaqësi. Ne kujtimeve gjithmonë i kemi dhanë ni konotacion pak ma pozitiv e ma qesharak gjanave. Pikërisht për të gjetë atë forcën, se ka qenë e vështirë ndryshe t’i tejkalosh, t’i tejkaloj të gjitha ato situata të randa që...

Ke pasë grevat e urisë që s’ke mujtë dy-tre ditë as ujë as kurgjo, as bukë, as... ma ke qenë për toke. Do të thotë që kanë qenë shumë të vështira për t’i kalu. Po unë mendoj që bindja e njeriut edhe ajo, ajo dashuria e madhe për çka, ajo dëshira e madhe për të arritë edhe është ajo që e mban njeriun edhe i jep forcë, se ti ke pasë momente për shembull, kur je hamend. Atëherë ka qenë tabu çashtja e Kosovës Republikë, tabu ka qenë bashkimi, tabu. Njerëzit thonin revolucionin ndodhë çdo 30 vjet, por revolucionet e mëdha. Dhe thojshim na, 30 vjet, por thojshim megjithatë, 30, 30. Na po punojmë kur të vijë, do të vijë ni ditë ajo.

Dhe ka pasë situata të randa kur t’i ke menu, je nalë edhe ke menu, e ke bindë vetën ndonjëherë ka ndodhë që ti e ke bindë vetën me zor, a po kupton, se kjo ka për të ndodhë patjetër. Edhe pse ni anë e jotja ka thanë, si ka me ndodhë? Se është e vështirë me ndodhë kjo me ni pushtet të atillë, me ni pushtet të atillë që ka qenë qaq të organizum, ti ta tronditësh ni shtet të atillë, siç ka qenë në atë kohë ka qenë shumë shumë e vështirë për ta, për ta besu që mund të ndodhë, seriozisht po them. Njerëzit i janë frikësu shumë asaj. Po ne kemi pasë, unë kam pasë bindjen gjithmonë se ajo ka për të ndodhë, ka për të ndodhë, patjetër ka për të ndodhë.

**Anita Susuri:** Po pas që keni dalë ju prej burgut, pas disa viteve domethënë ka fillu tjetër periudhë e demonstratave, viti ‘89...

**Teuta Bekteshi:** Po, po.

**Anita Susuri:** Pastaj ‘88-ën kanë qenë marshet, t’u fillu prej minatorëve, greva e minatorëve, ju gjithmonë keni qenë...

**Teuta Bekteshi:** Po, kam qenë, se unë kam qenë, provime kom pasë edhe unë e kom pasë shumë... bile, bile çka ka ndodhë shumë interesant, në demonstrata e kom pasë provimin e gjinekologjisë. Dhe ‘89-shën kur ndodhën, na u kthym, unë u ktheva për Shkup edhe nuk hina në provim se abstenova se ishim, shkova në demonstrata edhe e lashë provimin. U ktheva edhe na ndalën policia në Shkup, në Han



të Elezit, kordoni policor me na kontrollu. “Ku po vini? Ku keni qenë?” Studentëve, na të Maqedonisë. Atëherë ishte e përbashkët, nuk ishte e Maqedonisë se ishte një, një, një shtet. Unë thashë, “Kam qenë në provim, po kthehna prej provimit, s’muja me hi në provim po kthehna”, jo, thashë, “Rashë në provim edhe po kthehna prej provimit”, qashtu kalova domethanë. Po kemi qenë në rrjedha vazhdimisht.

**Anita Susuri:** Ka qenë edhe greva e minatorëve po më duket, si e keni dhanë përkrahjen nifarë mënyre?

**Teuta Bekteshi:** Grevën e minatorëve, bile, bile, bile në atë kohë edhe për grevën, patën ardhë minatorë, shumë mirë më kujtohet. Bile, bile edhe për minatorë ka qenë në hallë sportive në atë kohë mbështetje. Bile ka qenë krejt halla përplot me studenta, përplot me... bile në tokë u patëm ulë krejt. Se si ka qenë ajo halla e sporteve poshtë, krejt u patëm ulë aty. Në atë kohë kam qenë edhe... jemi mundu me qenë në, në rrjedha. Masanej, në pajtim të gjaqeve jemi bashkangjitë. Masanej prej ‘94-shës ma s’kam pasë të drejtë lëvizjeje. Unë ma kam qenë krejtësisht e bllokume këtu, as në Kosovë, as kërkund. Deri 2001-shin unë nuk kam qenë as në Kosovë. Domethonë, prej ‘94-tes deri 2001-ten unë nuk kam mujtë në Kosovë me lëvizë ma.

**Anita Susuri:** Po flasim për vitet, para viteve pak para viteve të ‘90-ta, vitin ‘88-‘89 që ishin t’u folë për marshet, t’u fillu prej në nëntor ka fillu marshi i minatorëve ku kanë ardhë në kamë prej Stantërgut deri në Prishtinë. A ju kujtohet juve qajo periudhë? Qysh ju kujtohet?

**Teuta Bekteshi:** Unë muj me ta folë ma shumë këtë anën e ktyne pjesëve, hallës sportit ku kam qenë ma aktive. Për arsye se unë nuk kam qenë atëherë, nuk kam banu në Prishtinë. Unë kam qenë atë kohë edhe e martume kam qenë edhe me fëmi dhe nuk kam mujtë me qenë unë për çdo ditë, për çdo ngjarje. Domethanë, kam qenë në ngjarjet ma vitale. Për shembull, në hallë të sporteve për atë të minatorëve ardhjen ma tepër unë nuk kam marrë pjesë në atë pjesë dhe nuk muj me thanë diçka që nuk kam qenë në atë pjesë. Po sa i përket protestave dhe në hallë të sporteve aty kam qenë vet, se e di që aty kam qenë edhe për atë muj me folë qysh ka qenë atmosfera, si ka qenë gjendja në atë kohë.

Se masanej ‘89-shin, ‘90-shin, pastaj ‘90-shin domethënë kam lindë edhe fëminë tjetër masanej edhe të voglin. ‘91-shin për shkak të situatës së randume këtu në Maqedoni, jo, kam marrë pjesë në pajtimet e gjaqeve, kam pasë edhe në Kosovë kam ardhë me fëmi. Me vëllaun tem kemi ardhë në Kosovë në pajtim të gjaqeve. Në Drenicë kemi pasë shku, e pat’ bo nifarë logu... bash në Drenicë ka qenë po nuk e di tash cili vend, kur kemi shku na. Menzi se u kthym na prej policisë, menzi se u kthym na, me dy fëmi unë me veti, paramendo ti. Në pajtim të gjaqeve po shkoj unë me dy fëmi të vegjël, pajtimi i gjaqeve në Kosovë. Pastaj tek ktu i kemi vazhdu pajtimet e gjaqeve. Edhe ktu kam shku me fëmi në pajtimin e gjaqeve.

**Anita Susuri:** Çfarë përvoje keni prej kësaj periudhe?

**Teuta Bekteshi:** Unë e kam pasën djalin e madh e kom pasë tre vjet, a të voglin katër muj, kur jam caktu unë në grupin e pajtimit me qenë unë aty, ka qenë shumë problem te ne për shkak të mentalitetit e sene me dy fëmi. Unë, po është kërkim prej Prishtinës që do të jem, duhet të jem edhe unë kam pranë. Me dy fëmi kam shku në pajtim të gjaqeve. Domethënë, djalin e madh me vete ku kam hy. Djalin e vogël e kanë majtë gratë në dhoma. Shpesh më thojshin, ai ka qenë shumë i bukur, i bardhë, thojshin, “More prit ta ndrojmë ta shohim a osht’ djalë a osht’ vajzë”. Më thojshin ato shokët, “Hajde t’ia ndrojmë emrin, t’ia vnojmë Pajtim se ky Astrit e po ia vnojmë Pajtim”. Se për shkak të pajtimit të gjaqeve.

Përvoja është një përvojë e jashtëzakonshme e pajtimit të gjaqeve te ne. Një fshat Sllupçan i thojnë ktu, keni dëgju ndoshta, ni fshat, aty ku deshta me thanë që kemi jetu edhe na edhe babi im thonte gjithmonë, “Kur hysh në Sllupçan veç drejt shiko, as këtej, as këtej”. Domethënë, qasi fanatizëm. Domethënë as këtej, as këtej, veç drejt. Kur u bo që më kishin caktu, në fakt u deshte këtu me bo pajtim. Kishin ni familje të afërt, domethënë kusheri, ni vrasje 15 vjet në gjak. Familjarë, domethënë kusheri domethënë të familjes. 15 vite. Ishin pasë vra për tokë, për mexhë si përpara ma qysh ka ndodhë. Me shku me pajtu te kta.

Këta e kanë pasë ni profesor, anëtar të tyne profesor në Prishtinë, diku ka punu me ni shkollë. Ne na thanë me shku këtu. E para herë na po shkojmë për pajtimin në këtë vend, domethënë në këtë familje me tre gjaqe. Unë kisha... baba im më kish mësu gjithmonë që në Sllupçan kur hyn, “Të kesh shumë kujdes se shumë fanatik dhe duhet të shikosh veç përpara, as majtas, as djathtas”. Ish pak problematike për mu ni punë që baba im gjithmonë ma kishte theksu edhe si do të gjindem tashti unë ktu me ni vend ku ma së vështiri është.

Po ishte një gja, një përparësi e imja, se baba im kish qenë mësu atje dhe atje kishin dëgju që kisha qenë e burgosur politike edhe kjo ka qëndru qështu. Atë rastin e Shkupit që ka qëndru qishtu kjo. Ka gjujtë me revole, njerëzit i kanë hiperbolizu senet. S’kishin qenë krejt asisoj, po njerëzit a din qysh nganjëherë i ngrisin njerëzit edhe pa bo veprime. Njerëzit kanë pasë njëfarë respekti ndaj meje, nifarë mendimi, opnioni të mirë për mu si osht’ femër kjo që mund me hy edhe te burrat. Se ndryshe gratë s’mujnë me hi te burrat po kjo munet me hi me kuvend me burra. Aty ka qenë ajo që unë jam pranë me nifarë mënyre me hy aty.

Por, nuk kishte problemi aty për me hy, por me dy fëmi, se s’mujsha me lonë. Këtë të voglin e kisha në qumësht edhe isha t’u i dhanë gjë edhe nuk kishe ti si e len. Duheshe me marrë me vete, se tanë ditën ishim në teren. E majshin familjet. Hypëm lart po ish ni, kurrë nuk e harroj, edhe e kam përshkruar në të gjitha rastet se ka qenë ni moment që nuk muj me asgja me krahasu. Dhe hypëm lart na, më ulën mu në kry të dhomën, ni dhomë e vogël por më ulën mu në krye. Diqysh në Sllupçan me të ulë, ti femër, në krye të dhomës ka qenë e pakapshme. Unë u ngushtosha, thjeshtë kisha ni, jo që kisha pse

burra janë se për mua edhe njiqind me qenë ishte krejt njejtë, po ishte vendi ku e kisha atë ndjenjën jo të mirë që e kisha.

Edhe djali im afër... edhe me hoxhë e të gjithë i thirrën. U çunë në kamë krejt njerëzit e tjerë se s'i zike dhoma, disa të ulun, krejt në kamë të tjerët, dhoma ngushtë. Po bisedohet për pajtimin e gjaqeve në Kosovë, për nevojën e pajtimit të gjaqeve, "Nesër ni luftë e mundshme, ne nuk duhet të jemi të përçarë, duhet të jemi bashkë. Nesër, për shembull, ai vrasësi edhe ai që ka të vramë është me një vend, aty do të ndodhë ni konflikt tjetër. Kështu që, do të na, do të jetë problem serioz për një luftë tonë të ardhshme". U bisedu rreth kësaj çashtje, foli profesori, fol profesori, foli profesori Doktor Ramiz Avdyli foli krejt. Unë po dëgjoj.

Thashë, nuk ma jepin mu fjalën se po folin krejt kta tjerë edhe s'më shkoi mendja që më thirrin mu krejt në fund, s'ma mori mendja. Të fundit mu po më thirrin m'u çu me folë unë. Kurrë në jetë nuk kam qenë ma randë. As nuk di çka kom thanë, nuk kam ide çka kom thanë, hiç s'mbaj mend asgja. Veç jam çu midis dhomës, kah me ia nisë? Për ni moment, kah t'ia nisi, çka të tham une? Baba im t'u më folë, a din qysh ish puna. Ku me prekë unë që këta, që m'u bo kjo. S'kisha as unë... edhe unë nuk di çka kom folë. Kom folë, kom folë, kom folë, nuk di çka kom folë hiç. Sigurisht që kam folë, s'kam folë diçka po nuk e mbaj mend çka kom thanë qaq e emocionume.

Kur e kom përfundu unë fjalën, ka qenë afër ktu ai ma i vjetri i familjes, afër meje ka qenë në kambë {bën me dorë tek krahu i majtë}. Ai qitu edhe ai ia ka nisë njeriu me qajtë, i kanë shku lotët edhe tha, "Kofshin falë gjaqet". Unë ia kom nisë me qajtë qaq shumë sa nuk di në jetë a jam ndodhë, m'u përzi mu. Thojsha, qysh falet more? Njeriu vritet, a din si ishte? Edhe për mu ishte shumë e randë, ta vret njeriun edhe ti, ishte shumë e randë për ta menu. S'kisha përjetu, por ishte e randë për ta menu. Unë mbeta. Kemi mbajtë tani na kanë thirrë ata edhe kemi shku poshtë te ato gratë, m'kanë thirrë te djali. Tani kemi shku te familja kemi lajmëru se u pajtun.

Masanej kemi vazhdu ma në krejta fshatrat. Por me fëmi, me të dy fëmitë kam shku në të gjitha. Por ka qenë momenti sa është madhështia e njeriut. Unë aty kom pa se njeriu sa është shpirt i madh me falë. Them s'kam provu kurrë edhe nuk e di. Por, domethënë diçka madhore që është, që është çashtje e interesit të popullit, çashtje e lirisë të popullit, njerëzit kanë falë, njerëzit kanë falë. Ata që ma të dhimbshmën që kanë mujtë, që kanë hup njerëz që fatkeqësisht ka qenë shumë e pranishme te ne. Mos të ndodhë kurrë, kurrë përndryshe nuk mund t'i bashkosh njerëzit.

**Anita Susuri:** Ngado që jeni shku, a janë falë gjithmonë gjaqet apo ka ndodhë ndonjëherë që jo?

**Teuta Bekteshi:** Në rrethin këtu, sa i përket rrethit të Kumanovës po flas unë edhe ato ngatërresat janë falë, se ka pasë edhe ngatërresa që kanë mujtë me çu në problem ma serioz për një vrasje të mundshme. Në ni fshat Llojan, qitu është afër Kumanovës, aty janë vra mësusit në shkollë. Janë, kanë pasë mosmarrëveshje dhe u çu domethënë mësusi e ka vra kolegun...

**Anita Susuri:** Kolegun.

**Teuta Bekteshi:** Po, për në atë kohë arsye të ndryshme. Në atë kohë kish pasë me ndodhë me babën tim i njejt problem, po fati që s'ka ndodhë deri aty, ka ndodhë tek ata. Po familja e atyne, tek ata kemi qenë tre ditë rresht. Domethënë, kemi bisedu me krejt anëtarët e familjes të mundshme edhe ata familje arsimdashëse nuk kanë qenë familje... por ka qenë një, domethënë një vëllai i të vramit ai kish pasë dalë jashtë, ni kohë s'është sjellë këtu. Por, ai gjithmonë kish pasë thënë, "Unë nuk e fali gjakin", a din, "unë ka me marrë hak", ky vëllai i atij të vramit. Na e morëm atë, bisedum me të dhe tre ditë kemi shku rresht në të njejtin vend. Atëherit ai tha, "Unë nuk muj me falë", tha, "nuk muj me falë", tha, "por hak nuk marrë", tha, "me falë nuk e falë, s'muj. Ama, hak nuk marrë". Ajo ishte gjë e mirë, domethënë mos me ardhë deri te ni vrasje tjetër, domethënë ka ndodhë edhe kjo.

Po raste tjera nuk kanë, nuk kemi pasë rast që ka ndodhë që nuk është falë. Nuk ka pasë shumë vrasje knej kah ne. Domethënë, në këtë rrethinë se s'po them që s'ka pasë, po nuk ka qenë prezente vrasja sikur që ka qenë, që ka qenë në Kosovë. Jo, ma pak ka qenë, ma pak në numër. Më pak, se ka qenë shtypje e madhe këtu. Ka qenë këtu ni pushtet i egër, qaq i egër sa njerëzit kanë bajnë me ni pushtet që nesër çka ndodhë. Njerëzit i kanë...

**Anita Susuri:** S'kanë bo za shumë.

**Teuta Bekteshi:** Nuk kanë shku deri në atë, deri në atë, atë deri në atë... se kanë pasë ni shtypje hala ma të madhe dhe ndoshta njerëzit, po them, nuk kanë shku deri aty dhe nuk kanë pasë shumë raste. Po këto raste që kanë qenë... po ka qenë ni rast, ni rast tre m'i falë përnihërë ka qenë shumë, tre vrasje. Ka ndodhën. Ajo më kujtohet edhe them shpesh herë që gruaja bon bashkë me, me, femrat edhe meshkujt bëjnë shumë punë të mira bashkë. Po fjala e grusë është shumë me domethanje.

**Anita Susuri:** Ju thatë që në vitin '94 nuk keni lëvizë ma...

**Teuta Bekteshi:** Jo.

**Anita Susuri:** Pse ka ndodhë kjo? Për shkak të krijimit të post blloqeve apo?

**Teuta Bekteshi:** Jo, Maqedonia atëherë ka qenë ni shtet i pavarur, që u ndan dhe atëherë u deshtë shtetësi të kesh të Maqedonisë. Por mu për shkak që isha e burgosun politike, kisha një histori tjetër ata ma kanë vu, në atë nenin ni Nen 6 që e rrezikon shtetin. Çka është ma e keqja, nuk kam pasë veç unë, po as burri im as fëmijtë e mi s'kanë pasë shtetësi. Paramendo ti, edhe fëmijtë e vegjël nuk kanë pasë deri në 2001-tën. Me kërkesa tona, me krejt. Baba im, familja ime këtu krejt [e kanë pasur] shtetësinë, unë në asni mënyrë. Atëherë, mu m'u ka blloku lëvizja, s'kam mujtë me lëvizë kërkund se

bile s'kam ekzistu. Ma bojshin në Sekretariat ku është çashtja ku mirren dokumentacionet, "Nuk ekziston ti". "Ku jam thojsha unë?" "Kërkund s'je".

Ka qenë shumë serioze puna ime në atë kohë. Unë '93-ën fillunë te ne privatizimi, domethënë, ordinancat. Filloi e drejta e hapjes së ordinancave private me kontratë me fondin. Fillova edhe unë e njanin vit ma përpara unë shkova, dola ilegalisht në Zvicërr. Have Shala ma mundësoi me dalë ilegalisht se ishte situatë e randë. Në punë s'më pranojshin, kurgjo, edhe unë ishte ni gjendje shumë e randë edhe fëmitë e vegjël, ishte ni ngarkesë. Unë isha kundër [daljes] jashtë, gjithmonë kam qenë kundër me dal jashtë. Po ishte ni situatë shumë e randë dhe unë thashë jo do të ndodhë diçka me mu se u ndijsha keq dhe dola. Dhe mandej nuk ma dhanë, se e Maqedonisë, nuk ma dhanë Zvicrra nuk ma dha atë azilin.

Unë me privatizimet e para, më thanë që do të rrih ti do t'i marrim pastaj fëmitë, po unë nuk pranova edhe nuk u pajtosha. Nuk jam ndi mirë në Zvicërr asniherë, jam ndi shumë bosh përbrenda, shpirtërisht s'kam qenë edhe veç çka s'kam pritë m'u kthy. U kthym na. Po m'u kthy unë shtetësi s'un mirrsha. Dhe ma bonë këtë gjashçin, deri në atë kohë kam punu me kolegë, merre ti me mend, po ka qenë problemi i rrezikimit tim se më thojshin, "As me kolegë s'po munësh me punu, se ti s'ki të drejtë pune hiç". Ka qenë ni periudhë shumë, shumë, shumë e randë për mu në atë kohë. Se jo që s'ke mujtë me lëvizë, po ti s'ke mujtë me ekzistu në fakt. As s'ke mujtë me punu, as kurgjë. Edhe unë edhe familja ime krejt. Edhe vëllai im s'ka punu 12-13 vjet, ka pritë për punë. Kështu që, kemi qenë krejt gati.

**Anita Susuri:** Kur keni hapë ordinancën?

**Teuta Bekteshi:** Ordinancën e kom hapë në '97-ën edhe më ka ndihmu ni tjetër person për m'u bo ai themelues i ordinancës dhe që pastaj unë të punoj me letërnjoftim të përkohshëm domethënë. Më kanë dhanë atë të drejtë me punu, a po kupton? Në ordinancë si mjek. Unë atëherë me atë udhëheqës kam punu. Unë e kom udhëheq në fakt, po e kom pasë ni person tjetër, se unë s'kam mujtë për shkak të dokumentacioneve unë nuk kam mujtë. Tek 2001-shin masnej nuk kam pasë... bile ka qenë problematike edhe njohja e gjuhës. Domethënë, ti u dashtë me dhanë provim në gjuhën maqedone me të cilin ti e din maqedonishtën.

Paramendo ti, burri im kish lujtë futboll, e njipte maqedonishten ma mirë se këta që e dijnë gjuhën e vet e unë që e njifsha, kisha kry me shkolla me krejt në gjuhë. Domethënë, kam hy në provim në maqedonisht sa po e dijmë gjuhën maqedone. Ka qenë seriozisht shumë problem, shumë problem kam pasë, shumë problem. Po kanë kalu edhe ato tashti. E atëherë jam marrë me sektorin joqeveritar shumë. Atëherë kam punu në sektorin joqeveritar. Jam marrë me trajnime, jam marrë me Lidhjen e Grusë Shqiptare në Maqedoni dhe kam qenë shumë aktive, shumë, shumë.

Nëpërmes saj masnej unë jam... bile kanë kërk, të Suedisë Gruja për Grujen është ni organizatë që njihen, atëherë kemi pasë ne projekte me këtë organizatë edhe si rrjet në Shkup. Ata kanë kërk

dokumentacionet e mija i kanë pasë çu edhe në qendrat ku janë për shtetësi që kanë problematike që është puna po nuk kanë mujtë me bo, s'ke mujtë me bo në asni mënyrë. Se e ke pasë gjithë që e rrezikon, është person që rrezikon shtetin edhe nuk kanë mujtë as atëherë me më ndihmu. Po mu më ka ndihmu kjo anë... kom, kom lëvizë në drejtime tjera dhe jam trajnu për shumë sene tjera. Po jam marrë me grunë vazhdimisht. Po du të them që jam marrë vazhdimisht edhe sot mirrem.

## Pjesa e Gjashtë

**Anita Susuri:** Kjo periudhë ka qenë shumë e vështirë edhe në Kosovë, sidomos për shkak të krijimit të sistemit paralel...

**Teuta Bekteshi:** Po.

**Anita Susuri:** Spitalet, për shembull Nënë Tereza qysh ka qenë t'u punu vet. Sa keni, sa jeni angazhu edhe ju në këtë drejtim? Thatë që edhe në luftë keni qenë...

**Teuta Bekteshi:** Jo, në luftë nuk kam qenë. Jo, jo, në luftë nuk kam qenë, s'kam mujtë me qenë në luftë. Jo, jo. Unë të thashë, unë të thashë se luftën, sa i përket sektorit joqeveritar na jemi marrë me refugjatët në luftë, a po më kupton?

**Anita Susuri:** Po de, po. Okej.

**Teuta Bekteshi:** Po, me refugjatët po...

**Anita Susuri:** Po në periudhën e luftës.

**Teuta Bekteshi:** Në periudhën e luftës ne, na kemi ba edhe para periudhës të luftës. Bile, na kemi pasë mbledhë, na si Lidhje e Grusë, në atë kohë rroba për në Kosovë me dërgu. Kemi pasë mbledhë aq shumë na që kemi mbledhë prej familjeve për krejt. Krejt i patëm seleksionu, pantolla, krejt, seleksionim për fëmi e krejt për m'i dërgu në Kosovë. Në atë kohë kur, kjo është, kemi pasë organizu edhe [Protestat e Grave për Bukë në Drenicë](#), edhe atë kemi... se tash për atë periudhë nuk më ka ra shumë me folën. Ka qenë ni problem atëherë se ne e organizum me bo ni protestë, me ju bashkangjitë protestës së grave në Drenicë.

Ne në Kumanovë ishte shumë problematike m'u organizu. E bom me ni shkollë bisedë, ni shkollë këtu që është, "Naim Frashëri", me drejtorin e asaj shkolle edhe që ta organizojmë na, jo në rrugë se në rrugë nuk linte policia po ta bëjmë në kuadër të shkollës a po kupton? Që brenda në hapësirë të mbyllur ta bëjmë protestën. Çka ka ndodhë do të thotë? I kemi organizu krejt fshatrat, vajzat me recitime me sene me këto që kishim mbledhë që ta bëjmë me ato që kishim mbledhë na ni protestë të

tillë t'i bashkangjitemi. Por, ishte ni problem se mu në 11:00 të natës më janë lajmëru prej policisë edhe më thanë, "Ti ke organizu", domethanë ti e ke bo këtë organizim.

Po nuk ish problemi që na e kishim bo këtë organizim, po ata bonën presion te shkolla dhe shkolla në 12:00, 1:00 të natës me informacion drejtorja e shkollës si është anulë, pa na lajmëru neve fare, a po më kupton? Që është anulë protesta pa na pytë neve fare. Atëherë ka qenë ni tollovi e madhe, u patëm revoltu shumë. Na e bom, erdhën të fshatrave u mbledhën, po nuk bom ndonjë protestë të organizime po ishte kjo si sporadike, ni reagim ma shumë pjesë-pjesë, a po më kupton? Jo një organizim qysh e kishim planifiku na. Masanej këto që i mlodhëm që thashë nëpër ato kena organizu m'i çu në Kosovë.

Atëherë në Kosovë nuk e pranun, në kufi nuk na lejunë, nuk na lejunë, se na deshtëm me Bashkësinë Islame m'i çu përmes tyre si ndihma. Po na u kthy krejt kamioni, krejt. Çka ndodhi? Përsëri kthim në Bashkësinë Islame. Kur ndodhi lufta në Kosovë, kur u çvendos Kosova nëpërmes Bllacës edhe nëpërmes Llojanit e ktyne që kanë qenë kah Presheva se kanë qenë dy dalje te na. Në Bllacë atëherë na mjektë që kemi funksionu, jemi organizu meniherë, jemi marrë krejt mjektë jemi bo bashkë edhe kemi thanë, "Krejt pjesëtartë që na vijnë refugjatët, krejt ambulatat shqiptare me punu pa të holla, s'ka kurgjo", domethonë krejt m'i mbulu na edhe e kemi bo.

Unë kom punu në Orizoll atë kohë, ni fshat kom punu ordinancën time. Kemi organizu. Çka kemi bo tjetër send, kemi dalë kemi kërkun me dalë në Bllacë, na mjektë, ni pjesë e mjekëve. Disa ni ditë, do tjerë ni ditë se përditë nuk lejojshin. E atëherë krejt këto që i kemi mbledhë kto rroba na i kemi çu në Bllacë, i kanë çu ekipet tjera të Bashkësisë Islame se ka pasë, shi ka ra shi edhe u konë shumë ftoftë. E shi e njerëz të lagun e njerëz të rraskapitun, çka të thushë. Çfarë pamje ka pasë atëherë, veç ne që e kemi pa e dijmi. Në atë kohë, çka osh' koncidenca? Shumë interesante, në breg të asaj Bllace, kufini ka jeni ardhë ju ka Bllaca, ajo fusha poshtë ka qenë përplot te hekurudha, krejt aty ka qenë përplot. Çadra, shi, i kanë dathë njerëzit qysh kanë dalë, qysh kanë lëvizë prej trenave që i kanë zbritë aty.

Në atë breg e takoj a din tash atë njeriun që unë kisha pasë bazën aty. Me gjithë vajzën e vet edhe djalin që e kishin lshu Prishtinën. Po nuk i lejojshin me dalë se aty kontrolla të mëdha u bojshin, nuk mujshe ti m'i marrë se s'lejojshin. Po ata vendosën me dalë jashtë në atë kohë, jo në Maqedoni se kish disa që i çojshin jashtë. Varet qysh u gjindshin, qysh i gjejshin. Po njerëzit që kanë ardhë në Maqedoni, domethënë ne e kemi, i kemi mundësu nëpër fshatra gjithkund dhe kemi hapë ndihma, kemi hapë punkte të ndihmave dhe me Bashkësinë Europiane që kanë bo në atë kohë. Jemi mundu në çfarëdo aspekti me i mbulu.

Bile ka qenë ni fëmi, në Orizoll ku kom punu, ka qenë i Drenicës ni fëmi i vogël ka qenë tre vjet. Ai fmi, iu kishin pasë mërdhi kambët dhe kishin pasë amputu. Të dy kambët e amputume. Ai fmi e vendosën ni familje të pacientëve të mi që isha aty, "Kështu është ni fëmi i smutë", edhe unë shkova e vizitova atë. Çka bona unë me atë fëmi? Kom kontrollu, i kemi kontrollu... po them, ka qenë ajo diçka e pakapshme ajo gjendje si të them. Masanej e organizum me njo të Dibrës për me çu këtë fëmiun jashtë

që me u mujtë me u rehabilitu ai atje, të shofin ndonjë mundësi. Ata janë sot jashtë. Sot janë jashtë. Nuk di çfarë vendi se në Turqi nuk pranojnë të shkojnë edhe kta dibranët që ishin erdhën i morën edhe i rregullun dokumentat dhe sot ata janë jashtë, nuk di ku janë. Po du të them... po kemi pasë pastaj edhe rastet me kancer që iu identifikojsha, ka qenë tmerrshëm. Tmerrshëm, tmerrshëm, tmerrshëm, tmerr ka qenë, tmerr, tmerr tmerr. Po kanë qenë situata të atilla.

Pastaj edhe te ne ndodhi e njejtja gja. Pastaj përsëri jemi marrë me njerëzit tanë, me gratë tana, me, me... po deshta me thanë që... dhe që vazhdojmë të mirremi. Unë them që vazhdojmë të mirremi, që është, nganjëherë mendon se dikun ka çalu dhe nuk ka qenë si duhet. Shpesh i boj pyetje vetës, çka osht' deshtë të bojmë ma tepër që qita të mos ndodhin, qito, qito çalime në atë procesin tonë. Si në Kosovë, si tek ne, si në Shqipëri po është. S'mund të them që s'është bënë ndryshimi. Na shtetin sot e kemi bo, kish qenë shumë mrekulli me qenë ni shtet funksional, ni shtet që i përpinë të gjitha kategoritë e jo ndarje të mëdha të grupeve, si të them, klasore.

Shumë të pasun e shumë të varfun, të mos ketë një, një, një mes gjithë kësaj. Një mes i gjithë kësaj që ajo e bën atë më së miri, e bën atë stabilitetin. Se kjo është dy ekstreme, dy ekstreme që janë, janë asnjë nuk, nuk mund të barazpeshojnë. Jo veç në Kosovë po edhe te ne. Të mos flas për Shqipërinë se ata flasin vet, por po them për te ne. Si në Kosovë, si në Maqedoni, Maqedonia numër ma i vogël po në Kosovë janë anashkalu femrat tona që kanë dhanë shumë edhe që kishin mujtë me dhanë, që kanë potencial me dhanë, që kanë pasë potencial me dhanë shumë. Janë shkapërderdhur nëpër botë edhe ato që janë domethënë zani gjithë atyne aktivisteve që kanë qenë të jashtëzakonshme, thuhet në perioda ma të vështira, nuk i ke. Kjo, kjo më dhemb. Kjo më dhemb.

**Anita Susuri:** Po du m'u kthy edhe pak edhe me folë për luftën e Kosovës që ka ndodhë në '99-ën, se ju keni një perspektivë tjetër. Keni qenë në Maqedoni, ka pasë shumë që kanë ardhë në Maqedoni...

**Teuta Bekteshi:** E qartë.

**Anita Susuri:** A mundeni pak ma shumë me më tregu çka keni pa? Në çfarë gjendje kanë qenë kta njerëzit? E tregutë pak po...

**Teuta Bekteshi:** Unë po them, unë që i kom pa vet që thashë edhe atë lindjen në mal po s'pata kohë kur me tregu. Ajo ka qenën, ajo ka qenë tmerr, seriozisht tmerr. Ti ke pasë njerëz të lodhun, të dëshprum, të malltretum, të deshun, të zbrazun, të uritur, të smutë. Njerëz që kanë vdekë aty për aty. Nuk ki si, si, si, si, nuk di si, si ta përshkrujë atë gjendje. Ajo ka qenë aq e dhimbshme, aq e dhimbshme që nuk, nuk muj me përshkru. Me marrë me analizu edhe me bo një... shpesh herë unë tham është mirë me bo njeriu ndoshta atë pamje që ka pa me qenë një artist që bën një pikurë se me fjalë nuk mendoj që mund të shprehet, ndoshta. Se diçka ka me të mungu ndoshta diçka te fjala se s'un gjenë fjalë adekuate për, për një pamje të caktume.



Po me qenë artist, me qenë piktor, të kisha qenë piktor them po s'jom piktore e kisha bërë gjithë ato pjesë. Ajo kish folë ma mirë se gjithçka. Kjo është e jonja që është një dobësi e jona që ne as nuk flasim për këto ngjarje, se i kemi qit' në heshtje. Shumë pak flitet ose flitet në forma të ndryshme, por jo ajo faktikja, ajo e tmerrshmja. Gjithë i ikim të tmerrshmës me paraqitë. Gjithë i ikim të tmerrshmës. Ni shoqe imja, Have Shala thojke, "Gjermanët, hebrenjtë, hebrenjtë", thojke, "na duhet me ba na si hebrenjtë". Se hebrenjtë e kanë tregu bash tmerret që i kanë pësu. Na sikur, na duhet me ba të njejtën gja, na duhet me ba të njejtën gja.

Ti për shembull kur ta shifësh që e ke pa, për shembull, unë tregoj qartë si e kom pa dhe ti nuk mundësh mos me thanë ashtu siç ka qenë, se ti ke kalu nëpër ato. Po duhesh ta thush të vërtetën se duhet ta prezantosh, jo vetëm tek ne po edhe në botë. Domethënë, çka ka pësu, nëpër çka ka kalu...

**Anita Susuri:** Po, se je dëshmitare.

**Teuta Bekteshi:** Nëpër çka ka kalu. Për shembull, ti çashtja e Ukrainës qitash, luftës në Ukrainë pse po thu ti europianët kanë qenë short për ne. Mu më kanë thirrë OSBE-ja të më thirrin për me më marrë, "Pse ju Lidhja e Grusë jeni kundër, se nuk i quni terroristë njerëzit kur janë çu te ne?" I kam thanë, "Po ju", i pata thënë njerit, "ti oficer i çfarë pune ke bërë përpara?" Tha, "Oficer kam qenë françez", thashë, "Ti popullin tand si e kishe kualifiku popullin tand si oficer? A kishe mujtë ni popull që s'ka bo kurrë terror, s'ka bo kurrë gjenocid që s'ka bo, a kishe bo ti terrorist një popull të tillë ose një grup të tillë njerëzit? A e kishe bo ti?" Thashë, "Çka kishe pasë", thashë, "ti para popullit tënd?" Edhe hiç s'foli.

Tha, "Po çfarë beson ti? A do të formohet Kosova?" Ishta lufta ende në Kosovë dhe te na, te na krisi. Thashë, "Shiko, unë", thashë, "i besoj Shteteve të Bashkuara të Amerikës", thashë, "unë nuk i besoj Europës", thashë, "se Europa", thashë, "asniherë s'ka qenë. Gjithmonë na ka nda, na ka përça, na ka copëzu", thashë, "Europa. Nuk besoj kurrë te Europa. Besoj te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa njëfarë dore s'ka", në atë kuptimin do të detyrohet me reagu, me reagu. Shikoje tash në Ukrainë çka po ndodhë. Po se Europa nuk e dike që me shqiptartë ka ndodhë kjo? Po ju përsëritet tani. Po tani ju erdh rreziku aty vet. Po tashti bishtat, dhelpnës kur t'i kallet bishti thotë ha m'u kallë edhe mu krejt edhe unë tregoj. Kjo është ni problem serioz kjo punë, se sendet duhet të thuhet ashtu siç kanë qenë edhe ashtu siç i ke pa.

Njeriu i besueshëm është ai që e ka pa me sy. Fjala nuk është e besueshme aq sa është syni. Po fjala flet edhe për ata që sot nuk munësh me thanë, se është një kontekst tjetër kohor dhe ti e pret atë që ke kalu nëpër atë. Po unë, unë mendoj që, unë mendoj që duhet, duhet të punoj aq shumë në këtë drejtim dhe jeni ju gjeneratat e reja. Si ju tani që unë jam shumë, shumë e lumtur që ju kam afër ktu dhe po ju dëgjoj dhe po ju shoh dhe po ju njof në fakt. Domethanë, dua të angazhohen, dua të angazhohen. Se keni ju një luftë tjetër që duhet ta vazhdoni, bashkë me neve po që ne të ju ndihmojmë.

**Anita Susuri:** Po unë mendoj që kisha dashtë me ju pytë nëse doni edhe naj kujtim nëse keni për fund me shtu ose diçka që ndoshta nuk, nuk ju kom pytë unë, nuk kom mujtë me ju pytë unë, po doni me shtu.

**Teuta Bekteshi:** Ka shumë, është shumë, shumë kujtime. Ndoshta unë e kam shkruar me një vend se ka pak kam fillu të shkruaj ka pak. Sado momentin e vet se nuk munësh ti me... kur të munësh se edhe me u kthy ti po duhesh me u kthy mas edhe osht' ni përjetim tjetër. Nuk munësh ta shkruajsh pa emocione ni gja të tillë se, se je aty sikur tash po ndodhë. Ato e dojnë momentin e vet edhe nuk munësh ti, atë veç vetëm mund ta bësh. Nuk mund ta bësh me të tjerët. Se sikur prania e të tjerëve ta humb atë, atë brishtësi ose atë, atë çfarë magjinë ndoshta ndoshta të momentit. Ti nuk mund ta bësh po e kërkon ajo atë momentin e vet.

Unë kom aq shumë gjana për të, për të thanë. Po më kujtohet ni insert, dy inserte kisha dashtë t'i tregoj nga ky rast. Kur ni shoqe tonë e kanë mbajtur në vetmi, mas daljes time nga vetmia e pastaj atë, që tre ditë pa ujë, s'ka mujtë, domethënë ka qenë gati edhe sumnolencë, sumnolencë e gjendje të pavetëdijshme pak se jo bash e kfishellët. Ashtu i thojmë ne në aspektin profesional. Kur e kanë prunë, në Lipjan vonë, gruaja s'ka mujtë me përbi as ujë. Domethënë s'ka mujtë m'u çelë fyti, është tharë krejtësisht është ngjiturë. Atë kisha provu unë nga vetë vetmija ime që ka qenë në burg, por që e disha çfarë duhet.

Atëherë, na e patëm përdorë vetëm pak qumësht sa për ta lagë një pikë, sa për të depërtu ajo, se edhe gjanat e pshtymës nuk funksionojnë më se thahet. Se nuk depërton as ushqim, as ujë, sidomos ujë. Ushqimi përsëri po, uji është ai që jep problemin serioze, thahet. As gjëndra e pshtymës nuk tajan më. Kur e kanë prunë në dhomë edhe ne kemi mendu se po vdes. Kur pak ujë e një e dy kadal ngadale ditë të tana, janë kanë kalu derisa ajo, ajo Marie e ka pasë, ajo ka qenë për ni vepër tjetër. E patën, me vëllaun e vet pas vrasjes në Gjakovë. Pastaj u dënu kjo, si juriste ka qenë, Fakultetin Juridik, u dënu 15 vjet ajo 15 vëllau. I ka sulmu ai fëmijtë dhe kështu ka ndodhë ni përleshje, ni konvikt edhe ka ndodhë ni vrasje e tillë. U dënu atëherë. Momentin që kam qenë unë shumë keq.

Kisha dashtë me e thanë momentin kur ka lindë kjo gruaja në Llojan qitu është që kanë dalë nga Llojani disa kanë dalë ni pjesë nga Llojani ni pjesë nga Tabanovci, ne i thojmë asaj pjesës tjetër që janë dy hyrje për në Kumanovë që mujnë me depërtu. Tash është edhe një pjesë tjetër që është hapë edhe ni kufi tjetër edhe ajo domethënë tre pjesë, po atëherë s'ka ekzistuar anej, knej ma shumë. Një grup na thirri neve me hy na me i ndihmu. I kishin vendosë, ftoftë, po flas për luftën në Kosovë. Ftoftë, acar, gjendje e randë e grave. Po i kishin vendosë qysh janë ardhë këta refugjatët, qysh kanë mrrri deri aty ni pjesë e atyne krejt ishin pasë metë në atë bregun. Ai si breg tani ni lumë kështu.

Ajo gruaja... neve po mrrin në mramje, menzi se na lejunë me hye, se nuk lejojshin me hi, nuk na lejojshin neve prej Maqedonisë me hy në pjesën tjetër që ishte në kufi, kufi Serbi-Maqedoni aty i bjen, jo Kosovë po Serbi-Maqedoni i bjen. Me ni shoqen time gjinekologe, me Doktor Nurijen po shkojmë na

ni kerr na çunë neve. Shkum na aty, menzi që depërtum na aty gjinekologe edhe unë. Gratë po thojnë, “Po lindë, po lindë, po lindë”. Tash t’u i kontrollu kjo gratë. “Po lindë”. Paramendo ti, domethënë ajo ka qenë e rrethume vetëm, në të ftohtë, vetëm me paravan, kështu si ni çarçaf, si qebe e kishin pasë mbulu. Gruja lindi. Aty lindi, paramendo ti në fushë. Po tham, si ia vum emrin bre, Shpat, jo Breg po Shpat. A din si e rrpime pak në lëshim. Ia vumë emrin Shpat atij, djalë bile i lindi, djalë jo vajzë edhe ia vumë emrin Shpat.

Po du me thanë, deshta me thanë ku shkon vështirësia e femrës, ni femër të lindte midis fushës pa kushte, pa veshje, deshun, shi, ftohtë. Çfarë domethënë ku ballafaqohet organizmi i njeriut aq më tepër i ni femre që lindë edhe rreziqet që i, që janë pas gjithë asaj. Janë dy momente, ka plot tjera po që shpesh herë kthehna te ajo forca e femrës edhe thom o Zot, o Zot, çfarë ka njeriu, çfarë force e ka brenda. Si thotë ni fjalë tha, e kish pytën dikush gurin, e ka pytë gurin ka thanë, “Sa mund të durosh?” Domethënë, as guri, njeriu duron. “Jo”, ka thënë, “nuk jam njeri për me mujtë me duru, s’jam njeri”. Domethënë, e ke forcën ma të fortë se të gurit.

Domethënë, ke situata të atilla që ti ballafaqohesh me vështirësi por them që jeta është kjo dhe, dhe vazhdon jeta të jetë. Po mendoj që duhet t’i përkushtohemi jetës se është... unë, unë e du shumë jetën të them të drejtën. Çdo ditë marrë diçka nga jeta. Them, edhe pi jetës time që kam kalu edhe jam e kënaqun me një rrugëtim timin në jetë. Jam mundu. Po s’paku diçka ndihmoj situata të caktume të jetës time dhe vazhdoj të jem për njeriun, ta ofroj gjithë atë, si them, atë dashuri për njerëzit, atë, atë bashkëndjenjë me njerëzit në situata të caktume. Atë mbështetje që i duhet një situatë të caktume, të gjitha format e mundshme. Mendoj që, që ia vlen të jetosh.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë!

**Teuta Bekteshi:** Me nder qofsh! Me nder qofshi te dyjat dhe ju dëshiroj shumë suksese dhe vazhdoni mos u ndalni asnjëherë.

**Anita Susuri:** Faleminderit, gjithashtu suksese.

**Teuta Bekteshi:** Faleminderit!